



# FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

[www.qpz.gov.al](http://www.qpz.gov.al)

**Nr.166**

**27 dhjetor**

**2011**

## P Ë R M B A J T J A

	Faqe
Ligj nr.10 488 datë 5.12.2011	Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.8378, datë 22.7.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar..... 8373
Ligj nr.10 489 datë 15.12.2011	Për tregtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve joushqimore 8384
Ligj nr.10 490 datë 15.12.2011	Për përcaktimin e formës dhe të strukturës së formulës së privatizimit të shoqërisë “ALBPETROL”, sh.a., Patos..... 8409
Ligj nr.10 491 datë 15.12.2011	Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.7829, datë 1.6.1994 “Për noterinë”, të ndryshuar..... 8411
Ligj nr.10 492 datë 15.12.2011	Për një shtesë në ligjin nr.9981, datë 8.9.2008 “Për miratimin e niveleve të tarifës doganore”, të ndryshuar..... 8413
Ligj nr.10 493 datë 15.12.2011	Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar..... 8114
Vendim i Kuvendit nr.143, datë 15.12.2011	Për zgjedhjen e Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit..... 8415
Vendim i Kuvendit nr.144, datë 15.12.2011	Për zgjedhjen e zotit Adrian Civici anëtar të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë..... 8415
Vendim i Kuvendit nr.145, datë 15.12.2011	Për zgjatjen e afatit të veprimtarisë së komisionit hetimor të Kuvendit “Për hetimin e veprimtarisë së institucioneve shtetërore për zbulimin, identifikimin, përballimin, neutralizimin, pengimin dhe ndëshkimin e veprimit të organizuar kriminal për dhunimin e institucioneve dhe përmbysjen e rendit kushtetues në datën 21 janar 2011”, të ngritur me vendimin e Kuvendit nr.82, datë 23.1.2011..... 8416

Vendim i Kuvendit nr.146, datë 15.12.2011	Për një shtesë në vendimin e Kuvendit nr.3, datë 16.9.2009 “Për caktimin e përbërjes së komisioneve të përhershme të Kuvendit”, të ndryshuar.....	8416
Vendim i GJL nr.3, datë 24.1.2011	Akuzuar për kryerjen e veprës penale të “Trafikimit të narkotikëve mbetur në tentativë”, parashikuar nga nenet 283/a e 22 të Kodit Penal.....	8417

**LIGJ**  
**Nr.10 488, datë 5.12.2011**

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË LIGJIN NR.8378, DATË 22.7.1998**  
**“KODI RRUGOR I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 81 pika 2 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI**  
**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**VENDOSI:**

**Neni 1**

Kudo në ligjin nr.8378, datë 22.7.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, fjalët “Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve” zëvendësohen me fjalët “Autoriteti Rrugor Kombëtar”.

**Neni 2**

Në nenin 115, pika 11 ndryshohet si më poshtë:

“11. Cilido që, duke zotëruar materialisht një mjet, ia beson ose ia jep ta drejtojë një personi të papajisur me lejedrejtimi, ndëshkohet me masë administrative me gjobë nga njëzet e pesë mijë deri në njëqind mijë lekë dhe me pezullimin e lejedrejtimit për një vit. Kjo masë nuk zbatohet për zotëruesin material të mjetit kur ai ka bërë njoftim apo denoncim të administruar në organet e policisë për humbje, marrje (vjedhje) apo grabitje të mjetit.”.

**Neni 3**

Pas nenit 117, shtohet neni 117/1 me këtë përmbajtje:

“Neni 117/1

**Kufizime për drejtuesit e motomjeteve**

1. Zotëruesit e lejedrejttimeve vendase të grupit “A” për tre vitet e para pas marrjes së lejedrejtimit nuk u lejohet drejtimi i motomjeteve me fuqi prej 25kw specifike referuar ngarkesës, ose 0,16 kw/kg.

2. Në Rregulloren e Zbatimit të Kodit Rrugor përcaktohen modalitetet e shënimit në lejen e qarkullimit të kufizimeve të parashikuara në pikën 1 të këtij neni. Në mënyrë të njëjtë vendosen normat për mjetet në qarkullim nga data e hyrjes në fuqi e këtij Kodi.

3. Kufizimet për drejtimin e mjetit janë automatike dhe fillojnë nga data e kalimit të provimeve teorike dhe provave respektive për marrjen e lejedrejtimit, sipas nenit 119 të këtij Kodi.

4. Zotëruesi i lejedrejtimit shqiptar, i cili në tri vitet e para të marrjes së lejedrejtimit qarkullon duke i tejkaluar limitet e shpejtësisë së mjeteve të përcaktuara në këtë nen, është subjekt i sanksionit administrativ të veçantë me gjobë në vlerën nga një mijë deri në tre mijë lekë. Shkelja e mësipërme përveç masës administrative me gjobë ndëshkohet edhe me masën plotësuese të



pezullimit të lejedrejtimit nga dy deri në tetë muaj në zbatim edhe të kërkesave të nenit 140 të këtij Kodi.”.

#### Neni 4

Pas nenit 120 shtohet neni 120/1 me këtë përmbajtje:

#### “Neni 120/1 Lejedrejtimi me pikë

1. Me aktin e dhënies së lejedrejtimit jepet, gjithashtu, një sasi prej njëzet pikësh për çdo drejtues mjeti. Kjo sasi pikësh, e shënuar në regjistrin kombëtar të personave të aftësuar për drejtimin e mjeteve, të parashikuar në nenet 220 dhe 221 të këtij Kodi, më poshtë regjistri kombëtar, pëson shkurtime (zbritje), në masën e treguar në tabelën e pikëve, në bazë të njoftimeve për shkeljet e normave të sjelljes, për të cilat është parashikuar një sanksion administrativ plotësues i pezullimit të lejedrejtimit, parashikuar në kapitullin V të këtij Kodi. Tregimi i sasisë së pikëve është i lidhur me çdo shkelje dhe duhet të rezultojë nga procesverbali i konstatimit të shkeljes i agentëve verifikues.

2. Në rastin kur konstatohen njëkohësisht më shumë se një shkelje e normave të sjelljes, në zbatim të kërkesave të pikës 1 të këtij neni, mund të zbriten maksimumi deri 15 pikë. Dispozitat e kësaj pike nuk zbatohen në rastet, në të cilat është parashikuar pezullimi ose revokimi (heqja) e lejedrejtimit.

3. Organi nga i cili varet agjenti verifikues që ka konstatuar shkeljen, e cila sjell nga ana e saj humbjen e pikëve, brenda 30 ditëve dërgon njoftimin zyrtar për shkeljen e kryer në regjistrin kombëtar. Konstatimi quhet i plotë dhe përfundimtar kur është kryer pagesa për masën administrative me gjobë, ose kanë përfunduar procedurat e ankimimit administrativ dhe gjyqësor, ose në rast të mosankimimit kanë përfunduar afatet për këtë ankimim. Afati i mësipërm prej 30 ditësh mbaron me njoftimin që merr organi i policisë për pagesën e sanksionit, me skadimin e afateve të ankimimeve ose rekurseve, si dhe me përfundimin e rekurseve të mësipërme. Njoftimi duhet të kryhet në ngarkim të drejtuesit të mjetit përgjegjës për shkeljen e kryer. Në rastin e mosidentifikimit të këtyre të fundit, pronari i mjetit, si edhe personat e tjerë solidarë me të, në zbatim të kërkesave të nenit 194 të këtij Kodi, brenda 60 ditëve nga data e verifikimit të shkeljes, duhet t'i japin organit të policisë, që procedon me rastin, të dhënat personale dhe të lejedrejtimit të drejtuesit të mjetit të pranishëm në çastin e kryerjes së shkeljes. Nëse pronari i mjetit rezulton një person juridik, përfaqësuesi i tij ligjor ose persona të ngarkuar prej tij janë të detyruar t'i japin të dhënat e mësipërme brenda së njëjtës periudhë organit të policisë që procedon me rastin përkatës. Pronari i mjetit ose personat e tjerë solidarë me të, në zbatim të kërkesave të nenit 194 të këtij Kodi, qofshin këta persona fizikë ose juridikë, që nuk tregojnë pa justifikim dhe motiv të dokumentuar, të dhënat e kërkuara janë subjekt i sanksionit administrativ me masë me gjobë në vlerën nga dy mijë e pesëqind deri në shtatë mijë e pesëqind lekë. Komunikimi i të dhënave nëpërmjet organeve të policisë dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor kryhet nëpërmjet rrugëve telematike dhe komunikimit të zakonshëm zyrtar.

4. Çdo ndryshim i sasisë së pikëve u komunikohet të interesuarve nga ana e regjistrin kombëtar. Çdo drejtues mjeti mund të kontrollojë në kohë reale gjendjen e lejedrejtimit të tij, sipas modaliteteve të treguara dhe të përcaktuara nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor.

5. Përveç në rast të humbjes së plotë të pikëve, të parashikuar në pikën 6 të këtij neni, mungesa e shkeljes së një neni të normave të sjelljes, e cila mund të çojë në zbritje pikësh, për një periudhë prej dy vjetësh, përcakton dhënien e kompletit të plotë të pikëve fillestare prej njëzet pikësh. Për mbajtësit e lejedrejtimit me të paktën njëzet pikë, mungesa e shkeljes së një rregulli të sjelljes, e cila mund të çojë në zbritje pikësh, për një periudhë prej dy vjetësh, përcakton dhënien e një krediti prej dy pikësh deri në një maksimum prej dhjetë pikësh.

6. Me humbjen totale të pikëve, mbajtësi i lejedrejtimit duhet t'i nënshtrohet një provimi të kualifikimit teknik të përmendur në nenin 128 të këtij Kodi. Të njëjtit provim duhet t'i nënshtrohet mbajtësi i lejedrejtimit, i cili pas njoftimit të shkeljes së parë, që përfshin një humbje prej të paktën pesë pikësh, kryen edhe dy shkelje të tjera brenda dymbëdhjetë muajve nga data e shkeljes së parë, që kanë të bëjnë me shkurtrim të paktën prej pesë pikësh secila. Në rast se mbajtësi i lejedrejtimit nuk u nënshtrohet verifikimeve të rinovimit të lejedrejtimit, siç parashikohet nga regjistri kombëtar, brenda tridhjetë ditëve nga njoftimi i vendimit për ta rinovuar atë, leja e drejtimit pezullohet pa afat, me akt të veçantë të zyrës respektive të regjistrit kombëtar pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Transportit Rrugor. Urdhri për pezullimin e mbajtësit të lejedrejtimit i njoftohet organit të Policisë Rrugore, të parashikuar në nenin 12 të këtij Kodi, i cili procedon për tërheqjen dhe ruajtjen e dokumentit të lejedrejtimit.

7. Për shkeljet që përbëjnë vepër penale dhe për të cilat gjykata merr vendim, kjo e fundit, brenda 15 ditëve nga data e shpalljes së vendimit, i dërgon një kopje të vendimit organit verifikues. Organi verifikues, në rastet kur vendimi parashikon dhe ulje të pikëve të lejedrejtimit, brenda 30 ditëve nga marrja e njoftimit, e dërgon atë në regjistrin kombëtar. Tabela e pikëve, sipas këtij neni, miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave.”.

## Neni 5

Neni 121 ndryshohet si më poshtë:

### “Neni 121 Autoshkollat

1. Shkollat për edukimin rrugor, instruktimin dhe formimin e drejtuesve të mjeteve quhen autoshkolla dhe ushtrohen si aktivitet i lirë privat. Licencimi i tyre bëhet sipas ligjit nr.10 081, datë 23.2.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, duke respektuar kriteret teknike dhe profesionale. Rregullat dhe detyrimet për funksionimin e autoshkollës, kapacitetin minimal financiar të nevojshëm, kërkesat e përshtatshmërisë për mësuesit dhe instruktorët e autoshkollave për drejtues mjete, kushtet për lokalet dhe pajisjet didaktike që mundësojnë zhvillimin normal të provimeve dhe garantojnë kohëzgjatjen e kurseve, përcaktohen me akte nënligjore të nxjerra në zbatim të këtij Kodi nga ministri përgjegjës për transportin rrugor.

2. Mbikëqyrja administrative dhe teknike e veprimtarisë së autoshkollave ushtrohet nga strukturat e Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor, në bazë të akteve të nxjerra nga ministria që mbulon veprimtarinë.

3. Veprimtaria e autoshkollës pezullohet nga strukturat e Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor për një periudhë nga 1 deri në 3 muaj, kur:

a) veprimtaria nuk zhvillohet rregullisht;

b) titullari nuk merr masa për zëvendësimin e mësuesve dhe të instruktorëve, që janë vlerësuar të papërshtatshëm nga strukturat e Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor;



c) titullari nuk respekton urdhrat e dhënë nga strukturat e Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor, për të rregulluar funksionimin e autoshkollës;

ç) bëhet transferimi i mjediseve të autoshkollës pa lejen e strukturave të Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor.

4. Licenca anulohet nga organi që e ka lëshuar, pas kërkesës së Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor, kur:

a) mungon kapaciteti financiar dhe nuk plotësohen më kërkesat morale;

b) mungojnë pajisjet teknike dhe didaktike;

c) janë zbatuar 2 masa pezullimi të veprimtarisë brenda 2 vjetëve;

ç) veprimtaria nuk fillon brenda 60 ditëve kalendarike nga data e lëshimit të licencës.

5. Programet e provimeve për marrjen e lejedrejtimit hartohen nga organi që lëshon lejedrejtimin.

6. Trajnimi për dhënien e ndihmës së shpejtë mjekësore në rast aksidenti bëhet sipas udhëzimit të përbashkët të ministrit përgjegjës për transportin dhe ministrit përgjegjës për shëndetësinë.

7. Cilido, që administron një autoshkollë pa licencën përkatëse, sipas kategorive të lejeve të mjeteve përkatëse, ndëshkohet me masë administrative, me gjobë nga pesëdhjetë mijë deri në dyqind mijë lekë. Kjo shkelje mund të ndëshkohet edhe me masën administrative plotësuese të mbylljes së menjëhershme të autoshkollës dhe të pushimit të veprimtarisë.

8. Cilido, që jep mësimin e teorisë ose instrukton drejtimin e mjeteve të autoshkollës, pa qenë i pajisur me dëshminë e aftësisë, ndëshkohet me masë administrative, me gjobë nga dhjetë mijë deri në dyzet mijë lekë, si dhe me mbylljen e menjëhershme të autoshkollës dhe pushimin e veprimtarisë.”.

## Neni 6

Në nenin 127 bëhen ndryshimet si më poshtë:

1. Pika 3 ndryshohet si më poshtë:

“3. Lejedrejtimi pezullohet nga organi epror i agjentit të policisë që ka tërhequr lejedrejtimin dhe, për lejedrejtimet e lëshuara nga një shtet i huaj, nga Institucioni i Prefektit, në juridiksionin e të cilit është konstatuar shkelja, sipas pikës 1 të këtij neni. Prefekti, brenda 5 ditëve, njofton organin e Policisë Rrugore për vendimin e marrë, duke i dërguar atë së bashku me lejedrejtimin. Organi i Policisë Rrugore përgjigjet për administrimin e dokumentacionit dhe dërgimin e tyre, brenda 5 ditëve, në Drejtorinë Konsullore të Ministrisë së Jashtme.”.

2. Pika 4 shfuqizohet.

## Neni 7

Në nenin 140 bëhen ndryshimet si më poshtë:

1. Pika 7 ndryshohet si më poshtë:

“7. Cilido, që nuk respekton kufijtë minimalë të shpejtësisë ose kalon kufijtë maksimalë të shpejtësisë me jo më shumë se 10 km/orë, ndëshkohet me masë administrative, me gjobë nga një mijë deri në tre mijë lekë.”.

2. Pika 8 ndryshohet si më poshtë:

“8. Cilido, që tejkalon kufijtë e shpejtësisë me më shumë se 10 km/orë dhe jo me më shumë se 20 km/orë, ndëshkohet me masë administrative, me gjobë nga dy mijë deri në gjashtë mijë lekë.”.

3. Pika 9 ndryshohet si më poshtë:

“9. Cilido, që tejkalon kufijtë e shpejtësisë me më shumë se 20 km/orë, ndëshkohet me masë administrative, me gjobë nga pesë mijë deri në pesëmbëdhjetë mijë lekë. Si pasojë e kësaj shkeljeje merret masa administrative plotësuese me pezullimin e lejedrejtimit nga 1 deri në 3 muaj. Në qoftë se shkelja është kryer nga një drejtues mjete, që e zotëron lejedrejtimin prej më pak se 3 vjetësh, pezullimi i lejedrejtimit bëhet për 3 deri në 6 muaj.”.

4. Pika 10 ndryshohet si më poshtë:

“10. Cilido, që shkel dispozitat e pikës 4 të këtij neni, ndëshkohet me masë administrative, me gjobë nga pesëqind deri në një mijë e pesëqind lekë.”.

#### Neni 8

Në nenin 141 bëhen ndryshimet si më poshtë:

1. Në pikën 10, fjalia e parë ndryshohet si më poshtë:

“10. Cilido që qarkullon kundërvajtje në kthesat, në rakordimet konvekse ose në ndonjë rast tjetër me fushëpamje të kufizuar, ose që e përshkon karrexhatën kundërvajtje, kur rruga është e ndarë në disa karrexhata të veçanta, ndëshkohet me masë administrative me gjobë nga dy mijë deri në gjashtë mijë lekë.”.

2. Pika 11 ndryshohet si më poshtë:

“11. Cilido që shkel dispozitat e tjera të këtij neni, ndëshkohet me masë administrative, me gjobë nga një mijë deri në tre mijë lekë.”.

#### Neni 9

Në nenin 142, pika 4 ndryshohet si më poshtë:

“4. Cilido, që shkel dispozitat e këtij neni, ndëshkohet me masë administrative, me gjobë nga një mijë deri në tre mijë lekë.”.

#### Neni 10

Në nenin 143 bëhen ndryshimet si më poshtë:

1. Në pikën 2, në fund shtohen fjalët “ose në rrethrotullim, ku përparësia është e atij që lëviz në rrethrotullim”.

2. Pika 10 ndryshohet si më poshtë:

“10. Cilido, që shkel dispozitat e këtij neni, ndëshkohet me masë administrative, me gjobë nga një mijë deri në tre mijë lekë.”.

#### Neni 11

Në nenin 144, pika 2 ndryshohet si më poshtë:

“2. Cilido, që nuk sillet në mënyrën e treguar nga sinjalizimi rrugor ose sipas normave përkatëse të akteve në zbatim, si dhe sipas orientimit të policit të trafikut, ndëshkohet me masë administrative, me gjobë nga një mijë deri në tre mijë lekë. Janë përjashtuar masat e veçanta, të parashikuara në nenet 6 dhe 7 të këtij Kodi.”.

#### Neni 12

Në nenin 145, pika 5 ndryshohet si më poshtë:



“5. Cilido, që shkel dispozitat e këtij neni, ndëshkohet me masë administrative, me gjobë nga një mijë deri në tre mijë lekë.”.

#### Neni 13

Në nenin 146 bëhen ndryshimet si më poshtë:

1. Pika 15 ndryshohet si më poshtë:

“15. Cilido që kryen një parakalim pa zbatuar dispozitat e pikave 2, 3, 4, 5 e 8 të këtij neni, ndëshkohet me masë administrative, me gjobë nga një mijë deri në tre mijë lekë.”.

2. Fjalja e parë dhe e dytë e pikës 16 ndryshohen si më poshtë:

“16. Cilido që nuk zbaton ndalimet e parakalimit, sipas pikave 9, 10, 11, 12 dhe 13 të këtij neni ndëshkohet me masë administrative me gjobë nga një mijë deri në tre mijë lekë. Kur nuk zbatohen ndalimet e parakalimit, sipas pikës 14 të këtij neni, masa administrative është me gjobë nga dy mijë deri në gjashtë mijë lekë.”.

#### Neni 14

Në nenin 147, pika 4 ndryshohet si më poshtë:

“4. Cilido, që shkel dispozitat e këtij neni, ndëshkohet me masë administrative, me gjobë nga një mijë deri në tre mijë lekë.”.

#### Neni 15

Në nenin 150, pika 3 ndryshohet si më poshtë:

“3. Cilido, që shkel dispozitat e këtij neni, ndëshkohet me masë administrative, me gjobë nga një mijë deri në tre mijë lekë.”.

#### Neni 16

Në nenin 151, pika 11 ndryshohet si më poshtë:

“11. Cilido që shkel dispozitat e tjera të këtij neni ose përdor në mënyrë të gabuar sistemet e sinjalizimit me ndriçim, ndëshkohet me masë administrative, me gjobë nga një mijë deri në tre mijë lekë.”.

#### Neni 17

Në nenin 152, pika 7 ndryshohet si më poshtë:

“7. Cilido, që shkel dispozitat e këtij neni, ndëshkohet me masë administrative, me gjobë nga një mijë deri në tre mijë lekë.”.

#### Neni 18

Në nenin 156, pika 6 ndryshohet si më poshtë:

“6. Cilido, që shkel dispozitat e këtij neni, ndëshkohet me masë administrative, me gjobë nga një mijë deri në tre mijë lekë.”.



#### Neni 19

Në nenin 157 pika 1, pas shkronjës “d” shtohet shkronja “dh” me këtë përmbajtje:  
“dh) në të gjitha rastet e përmendura më lart në këtë nen, heqja e mjeteve bëhet vetëm kur ka tabelë sinjalizuese me shenjën përkatëse.”.

#### Neni 20

Në nenin 160, pika 5 ndryshohet si më poshtë:  
“5. Cilido, që shkel dispozitat e këtij neni, ndëshkohet me masë administrative, me gjobë nga një mijë deri në tre mijë lekë.”.

#### Neni 21

Në nenin 162, pika 8 ndryshohet si më poshtë:  
“8. Cilido që shkel dispozitat e pikave të mësipërme të këtij neni, ndëshkohet me masë administrative, me gjobë nga një mijë deri në tre mijë lekë.”.

#### Neni 22

Në nenin 163, pika 3 ndryshohet si më poshtë:  
“3. Cilido që shkel dispozitat e këtij neni ndëshkohet me masë administrative, me gjobë nga një mijë deri në tre mijë lekë.”.

#### Neni 23

Në nenin 167 bëhen këto ndryshime:  
1. Pika 7 ndryshohet si më poshtë:  
“7. Cilido, që drejton mjete ose trolejbusë të destinuar për transportin e njerëzve, duke përjashtuar autoveturat, që kanë një numër pasagjerësh dhe një ngarkesë të përgjithshme më të madhe se vlerat maksimale të treguara në lejeqarkullimet, si dhe që transportojnë një numër pasagjerësh më të madh nga ai i treguar në lejeqarkullimin, ndëshkohet me masë administrative, me gjobë nga dy mijë deri në gjashtë mijë lekë.”.  
2. Pika 9 ndryshohet si më poshtë:  
“9. Cilido, që shkel dispozitat e mësipërme, kur bëhet fjalë për autovetura, ndëshkohet me masë administrative, me gjobë nga dy mijë deri në gjashtë mijë lekë.”.  
3. Pika 10 ndryshohet si më poshtë:  
“10. Cilido, që shkel dispozitat e treguara në pikën 6 të këtij neni, ndëshkohet me masë administrative, me gjobë nga një mijë deri në tre mijë lekë.”.

#### Neni 24

Në nenin 169, pika 2 ndryshohet si më poshtë:  
“2. Cilido, që shkel dispozitat e këtij neni, ndëshkohet me masë administrative, me gjobë nga pesëqind deri në një mijë e pesëqind lekë. Kur shkeljen e kryen një pasagjer me moshë jomadhore, përgjegjësinë e mban drejtuesi i mjetit.”.



## Neni 25

Në nenin 170, pika 8 ndryshohet si më poshtë:

“8. Cilido, që nuk përdor rripat e sigurisë dhe sistemet e fiksimit, të parashikuara për pasagjerët deri në 12 vjeç, ndëshkohet me masë administrative, me gjobë nga pesëqind deri në një mijë e pesëqind lekë. Kur shkelja i takon një fëmije në moshë jomadhore, përgjegjësia bie mbi drejtuesin e mjetit ose, kur ndodhet në çastin e kryerjes së shkeljes, mbi atë që është ngarkuar me mbikëqyrjen e kësaj fëmije.”.

## Neni 26

Në nenin 171, pika 3 ndryshohet si më poshtë:

“3. Cilido, që shkel dispozitat e këtij neni, ndëshkohet me masë administrative, me gjobë nga pesëqind deri në një mijë e pesëqind lekë.”.

## Neni 27

Në nenin 177 bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Pikat 1, 2 e 3 ndryshohen si më poshtë:

“1. Mjetet duhet të qarkullojnë të pajisura me tahograf, në përputhje me përcaktimet e bëra në aktin nënligjor të Këshillit të Ministrave, për karakteristikat, për rastet dhe për mënyrat e përdorimit.

2. Cilido, që qarkullon me një mjet të papajisur me tahograf, në rastet kur është parashikuar pajisja me të apo kur është pajisur me një tahograf, që nuk i ka karakteristikat në përputhje me ato të përcaktuara në aktin nënligjor të Këshillit të Ministrave, apo kur tahografi nuk funksionon, ose kur nuk është futur letra e regjistrimit apo karta e tahografit të drejtuesit, ndëshkohet me masë administrative, me gjobë nga tridhjetë mijë deri në njëqind e njëzet mijë lekë. Masa ndëshkimore me gjobë dyfishohet, kur janë prekur vulat ose është ndryshuar tahografi.

3. Mbajtësi i licencës ose i autorizimit për transport mallrash apo personash, që vë në qarkullim një mjet të papajisur me tahograf ose pa fletët e tij të regjistrimit apo pa letër printeri ose pa kartën e tahografit të drejtuesit apo me tahograf të prekur ose që nuk funksionon, ndëshkohet me masë administrative me gjobë nga tridhjetë mijë deri në njëqind e njëzet mijë lekë.”.

2. Pas pikës 6 shtohet pika 6/1 me këtë përmbajtje:

“6/1. Kur ekzistojnë prova se tahografi është prekur apo ndryshuar ose në rastin kur ai është jashtë funksionit, organet e kontrollit, sipas nenit 12 të këtij Kodi, duke e shoqëruar automjetin ose duke e tërhequr, në kushte sigurie, pranë ofiçinës më të afërt të autorizuar për instalime apo riparime, urdhërojnë verifikimin e funksionimit të kësaj pajisjeje. Shpenzimet për verifikimin dhe rivendosjen e funksionimit të tahografit janë, në çdo rast, në ngarkim të pronarit të automjetit apo të mbajtësit të licencës ose të autorizimit për transport mallrash apo personash së bashku.”.

3. Fjalja e dytë e pikës 7 ndryshohet si më poshtë:

“Kur drejtuesi i mjetit dhe mbajtësi i lejes së transportit nuk janë i njëjti person, periudha e mësipërme, nga data e marrjes së shënimit në procesverbal, mund të zgjatet në përputhje me periudhën, që parashikohet në aktin nënligjor të Këshillit të Ministrave.”.

4. Pas pikës 10 shtohet pika 11 me këtë përmbajtje:

“11. Ofiçinat e tahografit e ushtrojnë veprimtarinë e tyre për instalimin, aktivizimin e kalibrimit, inspektimin dhe riparimin, në përputhje me udhëzimin e ministrit përgjegjës për transportin. Shkelja e dispozitave të përcaktuara për këtë veprimtari nga ofiçinat e tahografit dënohet me gjobë nga pesëmbëdhjetë mijë deri në njëqind mijë lekë.

Kur vërtetohen tri shkelje, sipas kësaj pike, brenda një viti, vlera e gjobës dyfishohet dhe, në rast përsëritjeje, ofiçinës i hiqet e drejta e ushtrimit të veprimtarisë, të paktën, për një vit.”.

#### Neni 28

Në nenin 178 bëhen ndryshimet si më poshtë:

1. Pika 1 ndryshohet si më poshtë:

“1. Për të qarkulluar me mjete me motor, drejtuesi i mjetit duhet të ketë me vete këto dokumente:

- a) lejeqarkullimin;
- b) lejedrejtimi të vlefshëm për kategorinë përkatëse të mjetit;
- c) autorizimin për ushtrimin e drejtimit të mjetit që i korrespondon kategorisë së mjetit për të cilin ushtrohet, sipas shkronjës “b” të kësaj pike, si dhe një dokument identifikimi;
- ç) dokumentin që vërteton kontrollin teknik për mjetet e transportit rrugor;
- d) certifikatën e sigurimit të detyruar;”.

2. Pika 3 ndryshohet si më poshtë:

“3. Drejtuesi i mjetit duhet të ketë me vete edhe autorizimin ose lejen e transportit, kur mjete shfrytëzohet në një nga përdorimet e parashikuara në nenet 81 deri 84 të këtij Kodi.”.

#### Neni 29

Neni 184 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 184

#### **Drejtimi i mjetit nën ndikimin e alkoolit**

1. Është i ndaluar drejtimi i mjeteve në gjendje të dehur, si pasojë e përdorimit të pijeve alkoolike.

2. Është i ndaluar drejtimi i mjeteve pas përdorimit të pijeve alkoolike dhe nën ndikimin e alkoolit.

3. Cilido që drejton një mjet nën ndikimin e alkoolit, ndëshkohet me gjobë nga pesë mijë deri në pesëmbëdhjetë mijë lekë. Pas verifikimit të shkeljes zbatohet masa administrative e pezullimit të lejedrejtimit nga gjashtë muaj deri në një vit dhe nga një vit deri në dy vjet, kur subjekti e përsërit shkeljen brenda një viti.

4. Kur shkelja e mësipërme, e kryer në përsëritje nga drejtuesi i një autobusi ose nga drejtuesi i një mjeti, masa komplet e ngarkesës së të cilit është më e madhe se 3,5 tonë (ose kompleks mjetesh), përveç masave të gjobës, për drejtuesit e mjeteve të sipërcituara zbatohet masa plotësuese e heqjes së lejedrejtimit sipas procedurave të parashikuara në nenin 215 të këtij Kodi.

5. Kur mjeti nuk mund të drejtohet nga një njeri tjetër i përshtatshëm, mund të tërhiqet deri në vendin e treguar nga i interesuari, ose në ofiçinën më të afërt dhe lihet nën kujdesin e pronarit ose të administratorit me garancitë normale për ruajtjen e mjetit.

6. Me qëllim kontrollin e drejtuesve të mjeteve të parashikuara në pikën 4 të këtij neni, organet e Policisë Rrugore, për të cilat flitet në nenin 12 pikat 1 dhe 2 të këtij Kodi, duke respektuar kushtet e privatësisë personale, i vendosin drejtuesit e mjeteve nën kontrollë kualifikuese nëpërmjet aparaturave alkooltestuese.

7. Kur nga verifikimet kualifikuese, në zbatim të pikës 6 të këtij neni, rezulton përfundim pozitiv, dhe në të gjitha rastet e aksidenteve rrugore, ose kur ekzistojnë motivet që drejtuesi i mjetit është në gjendje jonormale psikofizike, si rezultat i ndikimit të përdorimit të pijeve alkoolike,



organet e Policisë Rrugore, për të cilat flitet në nenin 12 pikat 1 dhe 2 të këtij Kodi, kanë të drejtë të kryejnë verifikimet përkatëse, duke bërë shoqërimin e drejtuesit të mjetit në zyrën ose komandën më të afërt.

8. Për drejtuesit e mjeteve të përfshira në aksidente rrugore, të dëmtuar dhe që u janë nënshtruar ndërhyrjeve mjekësore, verifikimi i nivelit alkoolik kryhet detyrimisht me kërkesë të organeve të Policisë Rrugore, në zbatim të kërkesave të nenit 12 pikat 1 dhe 2 të këtij Kodi, nga ana e strukturave shëndetësore ose atyre të akredituara për këtë qëllim. Strukturat shëndetësore u lëshojnë organeve të Policisë Rrugore ose të Policisë Gjyqësore, sipas rastit, certifikatën përkatëse, në zbatim të kushteve të privatësisë, për dëmtimet kryesore të verifikuara, për përdorimin ose jo të alkoolit, si dhe nivelin e alkoolit në gjak.

9. Kur nga verifikimet e parashikuara në pikat 6 dhe 7 të këtij neni rezulton një vlerë, që i korrespondon një niveli alkoolik më shumë se 0,5 gram për litër (g/l), drejtuesi i mjetit konsiderohet në gjendje të dehur dhe i nënshtrohet sanksioneve të parashikuara në pikat 2 dhe 4 të këtij neni.

10. Në rastet e refuzimeve të verifikimeve dhe kontrolleve të parashikuara në pikat 6, 7 dhe 8 të këtij neni, drejtuesi i mjetit ndëshkohet me sanksionet e parashikuara në pikën 2 të këtij neni, duke përjashtuar rastin kur fakti përbën vepër penale.

11. Kur nga verifikimet e parashikuara në pikat 6 dhe 7 të këtij neni rezulton një vlerë alkoolike më e lartë se 1,5 gram për litër (g/l), duke konsideruar zbatimin e sanksioneve të parashikuara në pikën 2 të këtij neni, organet e Policisë Rrugore mund të kërkojnë që drejtuesit e mjeteve t'u nënshtrohen vizitave mjekësore për qëllimet e nenit 117 të këtij Kodi dhe mund të vendosin pezullimin me afat të lejedrejtimit, pezullim i cili shtrihet derisa të rezultojnë pozitivisht kontrollet e mëtejshme mjekësore.”.

#### Neni 30

Në nenin 185, pika 4 ndryshohet si më poshtë:

“4. Ndaj përdoruesve të lëndëve narkotike droguese ose psikotrope zbatohen dispozitat e përcaktuara, sipas pikave 3, 5 e 10 të nenit 184 të këtij Kodi.”.

#### Neni 31

Në nenin 187 bëhen këto ndryshime:

1. Në pikën 1, fjalia e dytë shfuqizohet.

2. Pika 6 ndryshohet si më poshtë:

“6. Për cilindo që, në kushtet e treguara në pikën 1 të këtij neni, nuk zbaton detyrimin e ndalimit në rast aksidenti, vetëm me dëme materiale, zbatohet masa administrative, me gjobë, nga dy mijë deri në gjashtë mijë lekë dhe me pezullimin e lejedrejtimit nga 6 deri në 12 muaj.”.

3. Pika 10 ndryshohet si më poshtë:

“10. Cilido, që nuk zbaton dispozitat e pikave 2, 4 dhe 5 të këtij neni, ndëshkohet me masë administrative, me gjobë nga dy mijë deri në gjashtë mijë lekë.”.

#### Neni 32

Në nenin 198, pas pikës 4 shtohet pika 5 me këtë përmbajtje:

“5. Në rastet kur përcaktimi i shkeljes bëhet me pajisje elektronike dhe automatike dixhitale në akset rrugore ku janë vendosur tabela sinjalizuese, në procesverbalin e konstatimit të shkeljes pasqyrohet argumentimi i shkeljes. Në aktet në zbatim përcaktohet modeli i procesverbalit dhe

procedurat përkatëse të plotësimit. Për njoftimin e shkeljes në këto raste zbatohen dispozitat e nenit 199 të këtij Kodi.”.

#### Neni 33

Në nenin 203, pika 2 ndryshohet si më poshtë:

“2. Në të gjitha rastet e parashikuara me gjobë, nëse arkëtimi i vlerës së gjobës nga kundërvajtësi bëhet brenda 5 ditëve nga dita që vendimi ka marrë formë të prerë, gjoba ulet me 20 për qind të vlerës.”.

#### Neni 34

Neni 204 ndryshohet si më poshtë:

#### “Neni 204

#### **Parashkrimi**

Parashkrimi i së drejtës për vjeljen e shumave të detyruara nga masat administrative me gjobë, për shkeljet e parashikuara nga ky Kod, rregullohet me ligjin nr. 10 279 datë 20.5.2010 “Për kundërvajtjet administrative”.

#### Neni 35

Në nenin 209 bëhen ndryshimet si më poshtë:

1. Pika 2 ndryshohet si më poshtë:

“2. Organi i policisë, që vepron për sekuestrimin, bën lëvizjen e mjetit dhe e vendos atë në ruajtje pranë degëve të Rezervave Materiale të Shtetit. Për këtë bëhet shënimi në procesverbalin e ngarkimit të shkeljes.”.

2. Në pikën 4, pas fjalës “të shitet” shtohen fjalët “nga strukturat e Rezervave Materiale të Shtetit”.

#### Neni 36

Në nenin 210, pikat 1 dhe 7 ndryshohen si më poshtë:

“1. Në rastet kur ky Kod parashikon masën plotësuese të ndalimit administrativ të mjetit, të parashikuar në nenin 178 pika 1 shkronja “a”, nenin 203 dhe nenin 212 për tërheqjen e targës, të këtij Kodi, organi i policisë që verifikon shkeljen, merr masa për ta ndërprerë qarkullimin dhe për ta depozituar mjetin në vendin e caktuar të ruajtjes, sipas mënyrave të parashikuara nga aktet në zbatim të këtij Kodi. Për këtë bëhet shënimi në procesverbalin e ngarkimit të shkeljes.

7. Në të gjitha rastet e tjera, kur ky Kod parashikon masën plotësuese të ndalimit administrativ të mjetit, organi i policisë që verifikon shkeljen, tërheq lejen e qarkullimit dhe vepron sipas kritereve të përcaktuara në nenin 212 të këtij Kodi.”.

#### Neni 37

Në nenin 211 pika 4, pas fjalës “shkatërrohet” shtohen fjalët “nga strukturat e Rezervave Materiale të Shtetit”.



Neni 38  
**Dispozita kalimtare**

Neni 120/1 “Lejedrejtimi me pikë” i këtij Kodi hyn në fuqi 18 muaj pas hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Neni 39  
**Aktet nënligjore**

Ngarkohen Këshilli i Ministrave dhe ministri përgjegjës për transportin që, brenda 3 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të nxjerrin aktet nënligjore në zbatim të tij.

Neni 40

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.7190, datë 20.12.2011 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,  
Bamir Topi**

**LIGJ**  
**Nr.10 489, datë 15.12.2011**

**PËR TREGTIMIN DHE MBIKËQYRJEN E TREGUT TË PRODUKTEVE JOUSHQIMORE<sup>1</sup>**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI**  
**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**VENDOSI:**

**KREU I**  
**DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

Neni 1

Ky ligj përcakton:

1. Të drejtat dhe detyrimet e operatorëve ekonomikë, sipas rolit dhe përgjegjësisë së tyre në zinxhirin e furnizimit për vendosjen në treg të produkteve, në mënyrë që të garantojnë dhe të sigurojnë përputhshmërinë e tyre me kërkesat ligjore në lidhje me to.

<sup>1</sup> Ky ligj: Është përafëruar plotësisht me vendimin nr. 768/2008/KE të Parlamentit Europian dhe Këshillit, datë 9 korrik 2008 “Mbi kuadrin e përbashkët për tregtimin e produkteve, i cili shfuqizon vendimin e Këshillit 93/565/KEE”, Numri CELEX: 32008D0768, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Europian, Seria L, Nr. 218, datë 13.8.2008, faqe 82 – 128.

Është përafëruar pjesërisht me Rregulloren 765/2008/KE të Parlamentit Europian dhe Këshillit, datë 9 korrik 2008 “Mbi vendosjen e kërkesave për akreditimin dhe mbikëqyrjen e tregut, lidhur me tregtimin e produkteve, e cila shfuqizon Rregulloren 339/93/KEE” Numri CELEX: 32008R0765, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Europian, Seria L Nr.218, datë 13.8.2008, faqe 30 - 47.

2. Detyrimet e personave përgjegjës të disa produkteve, grup produktesh apo instalimesh kur ato janë vënë në shërbim.

3. Mënyrën e organizimit, të drejtat dhe kompetencat e strukturës përgjegjëse, si dhe parimet për kontrollin e produkteve të importuara, që hyjnë në territorin shqiptar, në bashkëpunim me autoritetet doganore.

## Neni 2

### Fusha e zbatimit

1. Ky ligj zbatohet për të gjitha produktet joushqimore, për të cilat nuk ekziston një kuadër i veçantë ligjor dhe institucional. Kërkesat apo parimet e përgjithshme të përcaktuara në këtë ligj shërbejnë si dispozita plotësuese të legjislacionit të veçantë, kur ky i fundit nuk i parashikon këto kërkesa apo parime.

2. Ky ligj nuk zbatohet për substancat kimike që janë objekt i regjistrimit dhe/ose autorizimit paraprak dhe produktet kozmetike.

3. Parimet e përgjithshme të këtij ligji mund të jepen me hollësi në mënyrë më specifike, në përputhje me nevojat sektoriale, siç është rasti për pajisjet mjekësore, materialet e ndërtimit dhe pajisjet detare.

## Neni 3

### Përkufizime

Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. “Produkt” është çdo send i ri apo i përdorur, i cili është prodhuar, nxjerrë ose përfutur, pavarësisht nga niveli i përpunimit, i destinuar për t’u vendosur në treg.

2. “Produkt kozmetik” është çdo substancë ose përzjerje për t’u vendosur në kontakt me pjesët e jashtme të trupit të njeriut ose me dhëmbët apo mukozën e gojës, me qëllim pastrimin, parfumimin, ndryshimin e pamjes dhe/ose përmirësimit të aromave të trupit dhe/ose kujdesin për mbajtjen e tyre në kushte të mira.

3. “Bërje e disponueshme e produktit në treg” është çdo furnizim i produktit në treg për shpërndarje, konsum ose përdorim të tij gjatë një veprimtarie tregtare, me ose pa pagesë.

4. “Vendosje në treg” është bërja e disponueshme për herë të parë e produktit në treg.

5. “Prodhues” është çdo person fizik ose juridik, i cili prodhon një produkt ose ka një produkt të disenjuar a të prodhuar dhe e tregton këtë produkt nën emrin apo markën e tij tregtare.

6. “Importues” është çdo person fizik ose juridik, i regjistruar në Shqipëri, i cili vendos në tregun shqiptar një produkt nga një vend tjetër.

7. “Përfaqësues i autorizuar” është çdo person fizik ose juridik, i regjistruar në Shqipëri, i cili ka një akt përfaqësues nga prodhuesi për të vepruar në emër të tij për detyra specifike, për detyrimet e prodhuesit që parashikohen në këtë ligj ose aktet nënligjore në zbatim të tij.

8. “Shpërndarës” është çdo person fizik ose juridik, i përfshirë në zinxhirin e furnizimit, përveç prodhuesit dhe importuesit, që bën të disponueshëm produktin në treg.

9. “Operator ekonomik” është prodhuesi, përfaqësuesi i tij i autorizuar, importuesi ose shpërndarësi.

10. “Specifikim teknik” është dokumenti, ku përshkruhen kërkesat teknike që duhet të përmbushen nga një produkt, proces ose shërbim.

11. “Vlerësim i konformitetit” është procesi që provon nëse janë përmbushur kërkesat e specifikuara për një produkt, proces, shërbim, sistem, person ose trup.

12. “Organ i vlerësimit të konformitetit” është çdo organ që kryen veprimtari të vlerësimit të konformitetit, përfshirë kalibrimin, testimin, certifikimin dhe inspektimin.



13. “Inspektim” është procesi i ekzaminimit të projektimit të një produkti, vetë produktit, procesit apo instalimit, dhe përcaktimi i përputhshmërisë së tij me kërkesat specifike ose, sipas gjykimit profesional, me kërkesat e përgjithshme.

14. “Organ i miratuar” është organi i vlerësimit të konformitetit, i miratuar nga ministri përgjegjës, për kryerjen e detyrave specifike të vlerësimit të konformitetit, në përputhje me dispozitat e këtij ligji.

15. “Organizëm europian i notifikuar” është organizmi i vlerësimit të konformitetit, i miratuar nga një shtet anëtar i Bashkimit Europian, i notifikuar prej këtij të fundit në Komisionin Europian (KE) dhe i regjistruar në faqen zyrtare të KE-së, si një trup kompetent për kryerjen e detyrave specifike të vlerësimit të konformitetit të produktit për vendosjen e markimit CE.

16. “Standard shqiptar” është një dokument vullnetar, i krijuar me konsensus dhe i miratuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Standardizimit, në përputhje me kërkesat e legjislacionit për standardizimin, që siguron, për përdorim të njëjtë dhe të vazhdueshëm, rregulla, udhëzime ose karakteristika për veprimtaritë ose rezultatet e tyre, për arritjen e një shkalle optimale të rregullsisë në një kontekst të dhënë. Standardet shqiptare shënohen me “SSH”.

17. “Standard i harmonizuar shqiptar” është një standard shqiptar, që transponon një standard të harmonizuar europian, në mbështetje të këtij ligji dhe të rregullave teknike, sipas listës së përcaktuar nga Këshilli i Ministrave, me propozimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Standardizimit e ministrisë së linjës, në bashkërendim me ministrinë përgjegjëse dhe/ose me autoritetet e tjera të administratës qendrore. Lista e standardeve të harmonizuara shqiptare ose çdo ndryshim i saj botohen në Fletoren Zyrtare.

18. “Akreditim” është dëshmia/certifikata e lëshuar nga organizmi kombëtar i akreditimit për organin e vlerësimit të konformitetit, që përmbush kërkesat e përcaktuara në standardet e harmonizuara dhe, sipas rastit, çdo kërkesë shtesë, përfshirë ato të vendosura në skemat përkatëse sektoriale, për kryerjen e një veprimtarie specifike të vlerësimit të konformitetit.

19. “Organizëm kombëtar i akreditimit” është organi sipas kuptimit të dhënë në legjislacionin në fuqi për akreditimin.

20. “Mbikëqyrje e tregut” janë veprimtaritë e kryera dhe masat e marra nga struktura përgjegjëse e mbikëqyrjes së tregut (më poshtë “Struktura përgjegjëse”) për të garantuar përputhshmërinë e produktit me kërkesat ligjore në lidhje me të, me qëllim që të mos rrezikohen shëndeti, siguria ose aspekte të tjera të mbrojtjes së interesit publik.

21. “Markim CE” është markimi, me të cilin prodhuesi tregon që produkti është në përputhje me kërkesat e legjislacionit të zbatueshëm, kur ky legjislacion parashikon fiksimin e këtij markimi.

22. “Kthim i produktit” është çdo masë për kthimin mbrapsht të produktit, që është bërë ndërkohë i disponueshëm te përdoruesi i fundit.

23. “Ndalim i tregtimit” është çdo masë për të parandaluar produktin, në zinxhirin e furnizimit, nga bërja e disponueshme e tij në treg.

24. “Personi përgjegjës i produktit/instalimit të vënë në shërbim për të tretët apo për publikun” është titullari i së drejtës së pronësisë mbi produktin/instalimin, personi që ka në gëzim të përkohshëm produktin/instalimin, nëse ky i fundit ka detyrimin e garantimit të përputhshmërisë së produktit/instalimit me kërkesat e detyrueshme të sigurisë, në bazë të një marrëveshje me pronarin apo një akti administrativ, punëdhënësi për produktin/instalimin e vendosur në vendin punës. Nëse produkti/instalimi është i vendosur në ndërtesat e përbashkëta të banimit, personi përgjegjës, gjatë periudhës së ndërtimit dhe për një periudhë 5 vjet nga regjistrimi i bashkëpronësisë në regjistrin e pasurive të paluajtshme, është sipërmarrësi që kryen ndërtimin.

25. “Ministria” është ministria që mbulon çështjet e tregtisë.



26. “Ministër” është ministri përgjegjës për çështjet e tregtisë.
27. “Ministri përgjegjës” është ministri përgjegjës për fushën përkatëse.

#### Neni 4

### Parime të përgjithshme

1. Produkti i vendosur në treg duhet të jetë në përputhje me të gjitha kërkesat ligjore në lidhje me të.
2. Operatorët ekonomikë, sipas rolit të tyre në zinxhirin e furnizimit, janë përgjegjës për përputhshmërinë e produkteve që ata vendosin në treg me të gjitha kërkesat ligjore të përcaktuara për to.
3. Operatorët ekonomikë janë përgjegjës për të siguruar që i gjithë informacioni që ata japin për produktet e tyre të jetë i plotë, i saktë dhe në përputhje me legjislacionin përkatës të zbatueshëm ndaj tyre.

#### Neni 5

### Niveli i mbrojtjes së jetës, shëndetit, mjedisit dhe interesave publikë

1. Për të siguruar një nivel të mjaftueshëm të mbrojtjes së jetës, shëndetit të njerëzve, mjedisit dhe interesit publik, legjislacioni sektorial për produktet, grupe produktesh apo instalimesh kufizohet në vendosjen e kërkesave thelbësore të sigurisë, të cilat përcaktojnë nivelin e një mbrojtjeje të tillë, si dhe procedurat e vlerësimit të konformitetit që mund të zgjidhen nga prodhuesi. Kërkesat thelbësore përcaktojnë rezultatet që duhen arritur, por nuk specifikojnë zgjidhjet teknike për arritjen e tyre.
2. Ngarkohet Këshilli i Ministrave për miratimin e rregullave teknike për produktet/ instalimet, ku përcaktohen:
  - a) kërkesat thelbësore të sigurisë;
  - b) procedurat e vlerësimit të konformitetit;
  - c) kërkesat për markimin, instruksionet e përdorimit dhe të mirëmbajtjes.
3. Kur për produkte apo grup produktesh nuk është e mundur ose e përshtatshme mbështetja në kërkesat thelbësore të sigurisë, hartohen specifikime të hollësishme për këto produkte, me qëllim sigurimin e një niveli të mjaftueshëm të mbrojtjes së konsumatorëve, shëndetit publik, mjedisit ose aspekteve të tjera të mbrojtjes së interesit publik.
4. Rregullat teknike për:
  - a) nivelin minimal të lejuar të sigurisë për çdo klasë, kategori ose tip produkti, përfshirë edhe paketimin;
  - b) kërkesat e detyrueshme për etiketimin e produkteve;
  - c) kërkesat e detyrueshme për projektimin;
  - ç) metodat e fabrikimit/prodhimit dhe/ose testimit, kontrollit të cilësisë, klasifikimit, paketimit, magazinimit, transportimit dhe impakti në mjedis përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.



## KREU II VLERËSIMI I KONFORMITETIT

### Neni 6 Prezumimi i konformitetit

1. Kur rregullat teknike përcaktojnë kërkesa thelbësore, produkti prezumohet se plotëson kërkesat thelbësore të rregullave teknike të zbatueshme ndaj tij, kur është në përputhje me të gjitha standardet e harmonizuara shqiptare përkatëse të botuara në Fletoren Zyrtare, që mbulojnë këto kërkesa thelbësore.

2. Një standard i harmonizuar shqiptar shfuqizohet plotësisht ose pjesërisht, kur ky standard apo pjesë e një standardi të tillë nuk mund të përmbushë më tej përputhjen me kërkesat thelbësore të cilat ai mbulon.

3. Kur provohet se, pavarësisht përputhshmërisë së produktit me kërkesat thelbësore të përcaktuara në rregullat teknike ose me specifikimet e hollësishme, të përmendura në pikën 3 të nenit 5 të këtij ligji, ky produkt paraqet rrezik për sigurinë e jetës, shëndetit, mjedisit dhe interesave të tjerë publikë, struktura përgjegjëse u kërkon operatorëve ekonomikë përgjegjës të marrin masat:

a) që brenda një periudhe të caktuar, në përputhje me natyrën e riskut, produkti të mos paraqesë më rrezik kur të vendoset në treg;

b) për të ndaluar tregtimin e tij;

c) për të kthyer produktin nga përdoruesi i fundit.

4. Në rastin e marrjes së masave të parashikuara në pikën 3 të këtij neni, ndryshimi për kërkesat thelbësore apo specifikimet teknike bëhet me vendim të Këshillit të Ministrave.

### Neni 7 Procedurat e vlerësimit të konformitetit

1. Kur rregullat teknike parashikojnë kryerjen e vlerësimit të konformitetit për një produkt/grup produktesh apo instalim të caktuar, procedurat që përdoren për vlerësimin e konformitetit përzgjidhen ndërmjet një ose disa moduleve të mëposhtme:

- a) A - Kontrolli i brendshëm i prodhimit;
- b) A1 - Kontrolli i brendshëm i prodhimit së bashku me testimet e mbikëqyrura të produktit;
- c) A2 - Kontrolli i brendshëm i prodhimit së bashku me kontrollet e mbikëqyrura të produkteve në intervale të rastësishme;
- ç) B - Shqyrtimi EC i tipit;
- d) C - Konformiteti me tipin mbështetur në kontrollin e brendshëm të prodhimit;
- dh) C1 - Konformiteti me tipin mbështetur në kontrollin e brendshëm të prodhimit së bashku me testimet e mbikëqyrura të produkteve;
- e) C2 - Konformiteti me tipin mbështetur në kontrollin e brendshëm të prodhimit së bashku me kontrollet e mbikëqyrura të produktit në intervale të rastësishme;
- ë) D - Konformiteti me tipin mbështetur në sigurimin e cilësisë së procesit të prodhimit;
- f) D1 - Sigurimi i cilësisë së procesit të prodhimit;
- g) E - Konformiteti me tipin mbështetur në sigurimin e cilësisë së produktit;
- gj) E1 - Sigurimi i cilësisë së testimit dhe inspektimit të produktit përfundimtar;
- h) F - Konformiteti me tipin mbështetur në verifikimin e produktit;

- i) F1 - Konformiteti bazuar në verifikimin e produktit;
- j) G - Konformiteti mbështetur në verifikimin e njësisë;
- k) H - Konformiteti mbështetur në sigurimin e plotë të cilësisë;
- l) H1 - Konformiteti mbështetur në sigurimin e plotë të cilësisë së bashku me shqyrtimin e projektimit/disenjos së produktit.

2. Përzgjedhja e procedurave të vlerësimit të konformitetit kryhet duke marrë parasysh elementet e mëposhtme:

- a) përshtatshmërinë e tipit të produktit me modulën përkatës;
- b) natyrën e riskut të trashëguar nga produkti dhe masën, në sajë të së cilës, vlerësimi i konformitetit korrespondon me tipin dhe shkallën e riskut;
- c) nevojën e prodhuesit për të zgjedhur ndërmjet sigurimit të cilësisë dhe moduleve të certifikimit të produktit, kur përfshirja e palës së tretë është e detyrueshme;
- ç) nevojën për shmangien e moduleve që mund të jenë të ekzagjeruara për rrezikun e mbuluar nga rregulli teknik.

3. Kur rregullat teknike parashikojnë vlerësimin e konformitetit, ato mund të parashikojnë kryerjen e këtij vlerësimi nga autoritete publike, vetë prodhuesit, organizma europianë të notifikuar ose degë të tyre të regjistruara në Shqipëri dhe të miratuara nga ministri përgjegjës, sipas kërkesave të këtij ligji.

4. Kur rregulli teknik parashikon kryerjen e vlerësimit të konformitetit nga autoritete publike, këto të fundit duhet të përmbushin të njëjtat kritere që parashikohen për organizmat europianë të notifikuar ose degët e tyre të regjistruara në Shqipëri dhe të miratuara.

5. Shpenzimet për veprimtaritë e organit të vlerësimit të konformitetit mbulohen nga subjekti që kërkon kryerjen e këtij vlerësimi.

6. Kur prodhuesi nuk bie dakord me vendimin e organit të miratuar, ai ka të drejtë të ankohet për këtë vendim te ministri përgjegjës, i cili ka lëshuar miratimin. Ministri përgjegjës ia përcjell për apelim organizmit kombëtar të akreditimit, i cili vlerëson ankesën, sipas procedurave të ankesave dhe apelimit.

## Neni 8

### Deklarata EC e konformitetit

1. Kur legjislacioni përkatës parashikon një deklaram nga prodhuesi se ai ka demonstruar përmbushjen e kërkesave për një produkt, prodhuesi harton një deklaratë të vetme EC të konformitetit për të gjitha aktet ligjore apo nënligjore të zbatueshme ndaj produktit, përfshirë dhe procedurën e vlerësimit të konformitetit, sipas moduleve përkatëse.

2. Deklarata EC e konformitetit hartohet/përkthehet në gjuhën shqipe dhe përmban elementet e mëposhtme:

- a) numrin e identifikimit unik të produktit;
- b) emrin dhe adresën e prodhuesit ose të përfaqësuesit të tij të autorizuar;
- c) objektin e deklaramit (identifikimin e produktit, që mundëson gjurmueshmërinë, kur është e përshtatshme mund të përfshijë edhe një fotografi), në përputhje me legjislacionin përkatës në lidhje me të;
- ç) referencën ndaj standardeve të harmonizuara përkatëse që janë zbatuar ose referencën ndaj specifikimeve teknike, në lidhje me të cilat është deklaruar përputhshmëria;
- d) kur është e aplikueshme, organizmin europian të notifikuar ose degën e tij të regjistruar në Shqipëri dhe të miratuar si organ i miratuar (emrin, numrin e identifikimit), duke treguar procedurën e vlerësimit të konformitetit dhe lëshimin e certifikatës;



dh) datën, vendin dhe nënshkrimin.

3. Kjo deklaratë konformiteti lëshohet nën përgjegjësinë e vetme të prodhuesit ose, sipas rastit, instaluesit.

4. Me hartimin e deklaratës EC të konformitetit, prodhuesi ose, sipas rastit, instaluesi merr përsipër përgjegjësinë për përputhshmërinë e produktit me kërkesat ligjore në lidhje me to.

#### Neni 9

### **Markimi CE i konformitetit**

1. Markimi CE i konformitetit vendoset vetëm nga prodhuesi ose përfaqësuesi i tij i autorizuar.

2. Markimi CE i konformitetit fiksohet në produkt përpara vendosjes së tij në treg. Ai mund të shoqërohet nga një piktogram ose ndonjë tregues për një përdorim ose rrezik të veçantë.

3. Markimi CE i konformitetit vendoset/fiksohet vetëm në produktet, për të cilat është parashikuar kjo vendosje/fiksim nga rregullat teknike të zbatueshme dhe nuk duhet të vendoset në produkte të tjera.

4. Markimi CE i konformitetit shoqërohet nga numri i identifikimit të organizmit evropian të notifikuar, kur ky organ është përfshirë në fazën e kontrollit të prodhimit. Numri i identifikimit të organizmit evropian të notifikuar vendoset/fiksohet nga vetë ai ose, sipas instruksioneve të tij, nga prodhuesi apo përfaqësuesi i tij i autorizuar.

Me vendosjen ose fiksimin e markimit CE të konformitetit, prodhuesi merr përgjegjësinë për përputhshmërinë e produktit me të gjitha kërkesat e zbatueshme, të përcaktuara në legjislacionin përkatës/rregullat teknike që parashikojnë vendosjen e tij.

5. Forma, kuptimi dhe simboli grafik i markimit të konformitetit përcaktohen në rregullat teknike përkatëse, referuar në nenin 5 të këtij ligji.

6. Ndalohet vendosja e markimit/markimeve, shenjave apo mbishkrimeve, të cilat mund të çorientojnë palët e treta për kuptimin, formën e markimit CE të konformitetit, të përcaktuar në rregullat teknike përkatëse. Çdo markim tjetër mund të vendoset në produkt, në mënyrë të tillë që të mos pengojë dukshmërinë, lexueshmërinë dhe kuptimin e markimit CE të konformitetit.

7. Markimi CE i konformitetit vendoset/fiksohet në mënyrë të dukshme, të lexueshme dhe të paheqshme në produkt ose në pllakën e tij të të dhënave. Kur kjo nuk është e mundur për shkak të natyrës së produktit, markimi vendoset në paketim ose në dokumentet shoqëruese, në qoftë se rregulli teknik përkatës parashikon dokumente të tilla.

8. Kur produkti mbulohet nga disa rregulla teknike, vendosja e markimit CE të konformitetit në produkt tregon se produkti i plotëson të gjitha kërkesat e përcaktuara në rregullat teknike përkatëse për këtë produkt.

#### KREU III

### **DETYRIMET E OPERATORËVE EKONOMIKË**

#### Neni 10

### **Detyrimet e prodhuesit**

1. Kur prodhuesi vendos produktin në treg, ai siguron se ky produkt është projektuar dhe prodhuar në përputhje me kërkesat e përcaktuara në legjislacionin përkatës për këtë lloj produkti.

2. Prodhuesi harton dokumentacionin teknik dhe kryen procedurat e vlerësimit të konformitetit, të zbatueshme ndaj këtij produkti. Kur nga këto procedura tregohet/demonstrohet

përputhshmëria e produktit me kërkesat e zbatueshme, prodhuesi harton deklaratën EC të konformitetit dhe vendos/fikson markimin e konformitetit.

3. Prodhuesi mban dokumentacionin teknik dhe deklaratën EC të konformitetit pas vendosjes së produktit në treg, sipas përcaktimit në rregullat teknike përkatëse.

4. Prodhuesi siguron se zbatohen procedurat që prodhimi në seri të mbetet në konformitet. Ndryshimet në projektimin ose karakteristikat e produktit dhe ndryshimet në standardet e harmonizuara ose në specifikimet teknike, sipas të cilave është deklaruar përputhshmëria e produktit, duhet të merren parasysh.

Në rastin kur prodhuesi dyshon se produkti që ai ka vendosur në treg mund të paraqesë risk, kryen teste të mostrave të produkteve të tregtuara, heton dhe, nëse është e nevojshme, mban një regjistër ankesash për produktet jo në konformitet dhe produktet e kthyera nga përdoruesi i fundit, si dhe mban të informuar shpërndarësin për çdo monitorim të tillë.

5. Prodhuesi siguron se produkti i tij mban një numër tipi, grupi apo serie ose elemente të tjera që lejojnë identifikimin e tij ose, kur madhësia apo natyra e produktit nuk e lejojnë diçka të tillë, informacioni i kërkuar jepet në paketimin ose në dokumentet shoqëruese të produktit.

6. Prodhuesi vendos në produkt emrin e tij, emrin tregtar ose markën tregtare të regjistruar dhe adresën ku mund të kontaktohet. Kur këto elemente nuk mund të vendosen në produkt, prodhuesi i vendos ato në paketimin ose në dokumentin shoqërues të produktit.

7. Prodhuesi siguron që produkti të shoqërohet nga udhëzimet për përdorimin dhe, sipas rastit, për mirëmbajtjen, si dhe nga informacioni për sigurinë në gjuhën shqipe, të cilat duhet të jenë lehtësisht të kuptueshme nga konsumatori ose përdoruesi i fundit.

8. Prodhuesi, i cili konsideron ose ka arsye për të besuar se produkti, të cilin ai e ka vendosur në treg, nuk është në përputhje me legjislacionin e zbatueshëm ndaj këtij produkti, duhet të marrë menjëherë masat e nevojshme korrigjuese për të sjellë produktin në përputhshmëri për kthimin e tij nga tregu ose për ndalimin e tregtimit të tij. Për më tepër, kur produkti paraqet një rrezik, prodhuesi informon menjëherë strukturën përgjegjëse të mbikëqyrjes së tregut, duke i dhënë hollësitë, në veçanti për mospërputhshmërinë dhe për çdo masë korrigjuese të marrë.

9. Me kërkesë të strukturës përgjegjëse, prodhuesi i siguron asaj të gjithë informacionin dhe dokumentacionin e nevojshëm, në një gjuhë lehtësisht të kuptueshme për këtë strukturë, për të demonstruar përputhshmërinë e produktit me kërkesat ligjore përkatëse. Prodhuesi bashkëpunon me strukturën përgjegjëse për çdo masë të marrë për eliminimin e rrezikut të shfaqur nga produktet e vendosura në treg prej tij.

## Neni 11

### Detyrimet e përfaqësuesit të autorizuar

1. Prodhuesi me një akt përfaqësimi mund të caktojë një përfaqësues të autorizuar. Detyrimet e përcaktuara në pikën 1 të nenit 10 të këtij ligji dhe përgatitja e dokumentacionit teknik nuk është pjesë e aktit të përfaqësimit, të lëshuar prej tij.

2. Përfaqësuesi i autorizuar kryen detyrat e përcaktuara në aktin e përfaqësimit të lëshuar nga prodhuesi. Akti i përfaqësimit duhet të lejojë përfaqësuesin e autorizuar të kryejë, të paktën, detyrimet si më poshtë:

a) të mbajë deklaratën EC të konformitetit dhe dokumentacionin teknik në dispozicion të strukturës përgjegjëse për një periudhë, sipas përcaktimit të bërë në rregullat teknike të zbatueshme ndaj produktit, në përputhje me ciklin e jetës së produktit dhe nivelin e rrezikut;

b) t'i sigurojë strukturës përgjegjëse, sipas një kërkesë nga ana e saj, të gjithë informacionin dhe dokumentacionin e nevojshëm për demonstrimin e përputhshmërisë së produktit;



c) të bashkëpunojë me strukturën përgjegjëse, sipas një kërkesë të bërë nga ana e saj, për marrjen e masave për eliminimin e rrezeve të shfaqura nga produkti, për të cilin i është lëshuar akti i përfaqësimit.

## Neni 12

### Detyrimet e importuesit

1. Importuesi vendos në tregun shqiptar vetëm produkte, në përputhje me legjislacionin e zbatueshëm ndaj tyre.

2. Përpara vendosjes së produktit në treg, importuesi siguron se:

a) prodhuesi i ka kryer procedurat e duhura të vlerësimit të konformitetit dhe ka përgatitur dokumentacionin teknik;

b) produkti mban markimin e konformitetit të kërkuar ose markime të tjera dhe shoqërohet nga dokumentacioni i kërkuar;

c) prodhuesi ka zbatuar kërkesat e përcaktuara në pikat 5 e 6 të nenit 10 të këtij ligji.

Kur importuesi vlerëson ose ka arsye për të besuar se produkti, të cilin ai importon, nuk është në përputhje me pjesë të legjislacionit përkatës, ai nuk duhet të vendosë produktin në treg deri në sjelljen e tij në përputhshmëri me kërkesat e legjislacionit të zbatueshëm ndaj tij. Kur produkti paraqet risk, importuesi informon prodhuesin dhe strukturën përgjegjëse.

3. Importuesi vendos në produkt emrin e tij, emrin tregtar ose markën tregtare të regjistruar dhe adresën ku mund të kontaktohet. Kur këto elemente nuk mund të vendosen në produkt, importuesi i vendos ato në paketimin ose në dokumentin shoqëruar të produktit.

4. Importuesi siguron që produkti të shoqërohet nga udhëzimet për përdorimin ose, sipas rastit, udhëzimet për mirëmbajtjen, si dhe nga informacioni për sigurinë në gjuhën shqipe, të cilat duhet të jenë lehtësisht të kuptueshme nga konsumatori ose përdoruesi i fundit.

5. Importuesi siguron se gjatë kohës që produkti është nën përgjegjësinë e tij, kushtet e magazinimit ose të transportit nuk rrezikojnë përputhshmërinë e produktit me kërkesat e përcaktuara në rregullat teknike përkatëse.

6. Në rastin kur importuesi dyshon se produkti që ai ka vendosur në treg mund të paraqesë risk, kryen teste të mostrave të produkteve të tregtuara, heton dhe, nëse është e nevojshme, mban një regjistër ankesash për produktet jo në konformitet dhe produktet e kthyer nga përdoruesi i fundit, si dhe mban të informuar shpërndarësin për çdo monitorim të tillë.

7. Importuesi, i cili konsideron ose ka arsye për të besuar se produkti, të cilin ai e ka vendosur në treg, nuk është në përputhje me legjislacionin e zbatueshëm ndaj produktit, duhet menjëherë të marrë masat e nevojshme korrigjuese për të sjellë produktin në përputhshmëri për ndalimin e tregtimit të tij ose për kthimin e tij nga tregu. Për më tepër, kur produkti shfaq një rrezik, importuesi informon menjëherë strukturën përgjegjëse, duke i dhënë hollësi, në veçanti për mospërputhshmërinë dhe për çdo masë korrigjuese të marrë.

8. Importuesi mban për një periudhë, sipas përcaktimit të bërë në rregullat përkatëse teknike, një kopje të deklaratës EC të konformitetit për t'ia vënë në dispozicion strukturës përgjegjëse dhe siguron se dokumentacioni teknik mund t'u vihet këtyre strukturave në dispozicion sipas kërkesës.

9. Me kërkesë të strukturës përgjegjëse, importuesi i siguron asaj të gjithë informacionin dhe dokumentacionin e nevojshëm në një gjuhë lehtësisht të kuptueshme nga kjo strukturë për të demonstruar përputhshmërinë e produktit. Importuesi bashkëpunon me strukturën përgjegjëse për çdo masë të marrë për eliminimin e rrezikut të shfaqur nga produkti i vendosur në treg prej tij.

### Neni 13

#### Detyrimet e shpërndarësve

1. Kur shpërndarësit bëjnë të disponueshëm produktin në treg, duhet të veprojnë me kujdesin e duhur për kërkesat e zbatueshme ndaj produktit.

2. Përpara bërjes së disponueshme të një produkti në treg, shpërndarësi verifikon që:

- a) produkti mban markimin e kërkuar të konformitetit;
- b) produkti është i shoqëruar me dokumentacionin e kërkuar dhe udhëzimet e informacionin për sigurinë në gjuhën shqipe, lehtësisht të kuptueshme nga konsumatori ose përdoruesi i fundit;
- c) prodhuesi dhe importuesi kanë plotësuar kërkesat, në përputhje me nenet 10 pikat 5 e 6 dhe 12 pika 3 të këtij ligji.

Kur një shpërndarës vlerëson ose ka arsye për të besuar se një produkt nuk është në përputhje me kërkesat e legjislacionit të zbatueshëm ndaj tij, nuk duhet ta bëjë produktin të disponueshëm në treg, derisa produkti të silltet në përputhshmëri me kërkesat e legjislacionit të zbatueshëm ndaj tij. Kur një produkt shfaq rrezik, shpërndarësi informon prodhuesin ose importuesin për rrezikun, si dhe strukturën përgjegjëse.

3. Shpërndarësi siguron se gjatë kohës kur produkti është nën përgjegjësinë e tij, kushtet e magazinimit apo të transportimit nuk rrezikojnë përputhshmërinë e tij me kërkesat e përcaktuara në të gjithë legjislacionin e zbatueshëm ndaj tij.

4. Shpërndarësi, i cili vlerëson ose ka arsye për të besuar se produkti, të cilin ai e ka bërë të disponueshëm në treg, nuk është në përputhje me kërkesat e legjislacionit të zbatueshëm ndaj tij, siguron, nëse është e nevojshme, marrjen e masave korrigjuese për sjelljen e produktit në përputhshmëri/konformitet me kërkesat e legjislacionit të zbatueshëm ndaj tij, si dhe ndalimin e tregtimit ose kthimin e tij nga përdoruesi i fundit.

5. Me kërkesë të strukturës përgjegjëse, shpërndarësi i siguron asaj të gjithë informacionin dhe dokumentacionin e nevojshëm për të demonstruar përputhshmërinë e produktit. Shpërndarësi bashkëpunon me strukturën përgjegjëse, sipas kërkesës së tij, për çdo masë të marrë për eliminimin e rrezikut të shfaqur nga produkti i bërë i disponueshëm në treg prej tij.

### Neni 14

#### Rastet në të cilat detyrimet e prodhuesit zbatohen për importuesin dhe shpërndarësin

Një importues ose shpërndarës konsiderohet prodhues, për qëllime të këtij ligji, dhe do të jetë subjekt i detyrimeve të prodhuesit, sipas nenit 10 të këtij ligji, kur ai vendos një produkt në treg nën emrin e tij a markën e tij tregtare ose modifikon një produkt, i cili është vendosur në treg, në mënyrë të tillë që produkti të mos jetë në përputhje me kërkesat e përcaktuara në legjislacionin e zbatueshëm ndaj tij.

### Neni 15

#### Identifikimi i operatorëve ekonomikë

Operatorët ekonomikë, sipas kërkesës së strukturës përgjegjëse, sipas përcaktimeve të bëra dhe në përputhje me ciklin e jetëgjatësisë së produktit dhe nivelin e rrezikut, identifikojnë çdo operator ekonomik:

- a) i cili ka furnizuar atë me produktin;
- b) të cilit ai i ka furnizuar produktin.



## KREU IV SIGURIA E PRODUKTIT TË VËNË NË SHËRBIM

### Neni 16

#### **Detyrimet e personit përgjegjës të produktit/instalimit në shërbim**

1. Personi përgjegjës i produktit/instalimit ka detyrimin të garantojë se produkti/instalimi i vënë në shërbim/në përdorim për të tretët apo publikun e gjerë vazhdon të jetë në përputhshmëri me kërkesat e sigurisë së produktit/instalimit të vënë në shërbim gjatë gjithë periudhës së tij të përdorimit.
2. Personi përgjegjës i produktit/instalimit është, gjithashtu, i detyruar të regjistrojë produktin/instalimin dhe t'ia nënshtrojë atë inspektimit të rregullt periodik të kryer nga organet e miratuara kompetente për këtë qëllim.
3. Regjistrimi kryhet pranë strukturës përgjegjëse, ndërsa inspektimi periodik kryhet nga organi i miratuar, në bazë të kërkesës së personit përgjegjës dhe me shpenzimet e tij.
4. Personi përgjegjës i produktit/instalimit i siguron organit të miratuar të gjithë informacionin dhe dokumentacionin e nevojshëm, si dhe krijon/lehtëson kushtet për kryerjen e inspektimit.
5. Struktura përgjegjëse ngarkohet për të detyruar zbatimin e përputhshmërisë së produktit/instalimit të vënë në shërbim nga personi përgjegjës.
6. Ngarkohet Këshilli i Ministrave për përcaktimin e rregullave dhe të kërkesave të sigurisë për produktet/instalimet në shërbim, përfshirë, sipas rastit, kërkesat specifike për rritjen e nivelit të sigurisë së produkteve/instalimeve të tilla, të cilat janë tashmë të vendosura në treg/në shërbim.

## KREU V ORGANET E MIRATUARA

### Neni 17

#### **Kërkesat për ministrin përgjegjës që vepron si autoritet miratimi**

1. Ministri përgjegjës, që vepron si autoritet miratimi, e kryen këtë detyrë në përputhje me ligjin nr.9367, datë 7.4.2005 "Për parandalimin e konfliktit të interesave", si dhe Kodin e Procedurave Administrative.
2. Ministri përgjegjës ia delegon strukturës administrative përgjegjëse për rregullat teknike dhe bashkërendimin e mbikëqyrjes së tregut në ministri, vlerësimin e përputhshmërisë së dokumentacionit të dorëzuar nga aplikanti me kërkesat e këtij ligji. Personat, që kontrollojnë përputhshmërinë e dokumentacionit të aplikantit me kërkesat e këtij ligji, nuk duhet të kenë kryer vlerësimin e tij.
3. Ministri dhe struktura referuar në pikën 2 të këtij neni nuk duhet të ofrojnë ose sigurojnë aktivitete që kryejnë organet e vlerësimit të konformitetit ose shërbime konsulence mbi baza konkurruese ose biznesi.
4. Ministri dhe struktura referuar në pikën 2 të këtij neni duhet të ruajnë konfidencialitetin e informacionit të marrë.

### Neni 18

#### **Organet e miratuara**

1. Organi i miratuar kryen veprimtaritë sipas objektit të përcaktuar në vendimin e miratimit, si dhe veçanërisht:



a) kryen objektivisht shqyrtimin/ekzaminimin teknik me profesionalitet dhe mban parasysh nivelin e shkencës dhe të teknologjisë në kohën e kryerjes së ekzaminimit;

b) lëshon certifikata ose harton raporte për testimet dhe vlerësimin e konformitetit, bazuar në ekzaminimin teknik, duke ndjekur procedurat e vlerësimit të konformitetit të përshkruara në rregullat teknike/rregullat e sigurisë në shërbim;

c) tërheq certifikatat ose dokumentet e tjera, referuar në shkronjën “b” të kësaj pike, në rast se produkti nuk është më në konformitet me kërkesat e përcaktuara në rregullat teknike për këto produkte;

ç) siguron kopje të certifikatave, raporteve të testeve dhe të vlerësimit të konformitetit, përfshirë dokumentet për to dhe informacionin për lëshimin, refuzimin ose tërheqjen e certifikatave ministrit përgjegjës, strukturës përgjegjëse dhe autoriteteve të tjera, sipas kërkesës;

d) informon ministrin përgjegjës pa vonesë për çdo rast, në të cilin ky organ është i paafët të sigurojë përmbushjen e kushteve të vendosura për ushtrimin e miratimit.

2. Organi i miratuar informon ministrin përgjegjës për:

a) çdo refuzim, kufizim, pezullim ose tërheqje certifikate;

b) çdo rrethanë që ndikon në objektin/qëllimin dhe kushtet për miratimin;

c) çdo kërkesë për informacion, të cilën ai ka marrë nga struktura përgjegjëse për veprimtarinë e vlerësimit të konformitetit;

ç) veprimtaritë e vlerësimit të konformitetit, të kryera sipas objektit të tij të miratimit dhe çdo veprimtari tjetër të kryer, përfshirë veprimtaritë nënkontraktuese.

3. Organi i miratuar duhet të përmbushë gjithmonë kërkesat e miratimit, të mbajë regjistra të të gjitha procedurave të vlerësimit të konformitetit, për të cilat ai është miratuar, dhe menjëherë të njoftojë ministrin përgjegjës për çdo ndryshim, që mund të ndikojë në kualifikimet e tij apo objektin e veprimtarive nga miratimi i lëshuar ose çdo ndryshim që mund të ndikojë në përmbushjen e kërkesave të miratimit.

4. Organi i miratuar mban regjistra të të gjitha detyrave të kryera të punës dhe rezultateve të tyre, për të paktën 10 vjet.

5. Me kërkesë të ministrit përgjegjës, organi i miratuar merr pjesë në testimet e kualifikimit ose krahasime të tjera të përcaktuara për organet e vlerësimit të konformitetit.

6. Organi i miratuar duhet të lejojë punonjësit zyrtarë, të pajisur me urdhër të ministrit përgjegjës, që të evidentojnë të gjitha të dhënat për përmbushjen e kërkesave të vlerësimit të konformitetit dhe të hyjnë në vendet/ndërmarrjet ku janë kryer detyrat e përfshira në objektin e vlerësimit të konformitetit, siç është përcaktuar në miratimin e lëshuar.

7. Organi i miratuar, për qëllime të inspektimit periodik të produkteve/instalimeve të vëna në shërbim, i dërgon strukturës përgjegjëse certifikata ose dëshmi të tjera të lëshuara, me kërkesë të kësaj strukture.

8. Në fund të çdo periudhe katërmujore, organi i miratuar i dërgon ministrit përgjegjës listën e inspektimeve ose certifikatave të lëshuara për periudhën në fjalë.

## Neni 19

### Kërkesat për organet e miratuara

1. Për çdo rregull teknik dhe rregullat për sigurinë e produkteve të vendosura në shërbim/në përdorim, ministri përgjegjës mund të miratojë një ose më shumë organe për kryerjen e procedurave specifike të vlerësimit të konformitetit, përfshirë inspektimin. Kur në rregullat teknike parashikohet përfshirja e organeve të vlerësimit të konformitetit si palë e tretë për vendosjen e markimit CE, ato mund të jenë vetëm organizma europiane të notifikuar ose degë të tyre të regjistruara në Shqipëri dhe të miratuara nga ministri përgjegjës.



2. Ministri përgjegjës miraton vetëm organet e akredituara të vlerësimit të konformitetit.
3. Për qëllim miratimi, aplikanti përgatit “Dosjen e kualifikimeve”, e cila përbëhet nga dy dokumente: “Raporti i kriterëve minimale”, i lëshuar nga një punonjës i strukturës administrative, sipas përcaktimit të pikës 2 të nenit 17 të këtij ligji, i zgjedhur nga ministri përgjegjës, dhe “Certifikata e akreditimit”, e cila lëshohet si më poshtë:
  - a) Në rastin e degëve të organizmave europianë të notifikuar, që duan të operojnë në Shqipëri, si organe të miratuara për vendosjen e markimit CE, kjo certifikatë duhet të jetë e lëshuar nga një organ akreditimi i një shteti anëtar të BE-së dhe anëtar i Organizatës Europiane të Akreditimit. Në këtë rast “Certifikata e akreditimit” duhet të mbulojë funksionimin/veprimtarinë e këtij organizmi në territorin shqiptar për fushën përkatëse.
  - b) Në rastin e organeve të vlerësimit të konformitetit, që duan të operojnë si organe të miratuara për qëllime të inspektimit të rregullt periodik të produkteve/instalimeve të vëna në shërbim, sipas përcaktimit të nenit 16 të këtij ligji, kjo certifikatë duhet të jetë e lëshuar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose nga ndonjë organizëm tjetër akreditimi që është nënshkruar i marrëveshjes shumëpalëshe me Organizatën Europiane për Akreditimin për fushën përkatëse. Në rastin e fundit, “Certifikata e akreditimit” duhet të mbulojë funksionimin/veprimtarinë e këtij organizmi në territorin shqiptar.
4. Për qëllime të “Raportit të kriterëve minimale”, të përgatitur nga punonjësi i strukturës administrative, sipas përcaktimit të pikës 2 të nenit 17 të këtij ligji, organi i vlerësimit të konformitetit duhet të provojë me certifikatat, deklaratimet dhe dëshmitë përkatëse të kualifikimeve përmbushjen e kërkesave të parashikuara nga pika 5 deri në 12 të këtij neni.
5. Një organ vlerësimi konformiteti, që aplikon për miratim, duhet të jetë i regjistruar në QKR.
6. Organi i vlerësimit të konformitetit është i pavarur nga fabrika/ndërmarrja e prodhuesit ose vetë produktit që vlerësohet.
7. Organi i vlerësimit të konformitetit, drejtuesi/it më i lartë administrativ/ë e teknik/ë dhe personeli përgjegjës për kryerjen e detyrave të vlerësimit të konformitetit nuk duhet të jenë disenjuesi/projektuesi, prodhuesi, shpërndarësi, instaluesi, blerësi, pronari, përdoruesi ose mirëmbajtësi i produktit që ky organ vlerëson dhe as përfaqësuesi i autorizuar i këtyre palëve. Kjo nuk pengon përdorimin e produktit të vlerësuar, i cili është i nevojshëm për funksionimin e organit të vlerësimit të konformitetit, ose përdorimin e produkteve të tilla për qëllime personale.
8. Organi i vlerësimit të konformitetit, drejtuesi/it më i lartë administrativ/ë e teknik/ë dhe personeli përgjegjës për kryerjen e detyrave të vlerësimit të konformitetit nuk duhet të jenë drejtpërdrejt të përfshirë në projektimin/disenjimin, prodhimin, ndërtimin, tregtimin, instalimin, përdorimin ose mirëmbajtjen e këtyre produkteve, ose të përfaqësojnë palët e përfshira në këto veprimtari. Ato nuk duhet të përfshihen në veprimtaritë që mund të krijojnë konflikt me pavarësinë/paanësinë e tyre të gjykimit ose integritetin për aktivitetet e vlerësimit të konformitetit, për të cilat ata janë miratuar. Ky parim zbatohet veçanërisht për shërbimet e konsulencës.
9. Organet e vlerësimit të konformitetit sigurojnë se veprimtaritë e degëve ose nënkontraktorëve të tyre nuk prekin/ndikojnë në konfidencialitetin, objektivitetin, paanësinë e veprimtarive të tyre të vlerësimit të konformitetit.
10. Organet e vlerësimit të konformitetit dhe personeli i tyre kryejnë veprimtaritë e vlerësimit të konformitetit me shkallën më të lartë të integritetit profesional dhe kompetencën teknike të nevojshme në fushën specifike dhe duhet të jenë të lirë nga çdo presion dhe nxitje/shtytje, veçanërisht financiare, që mund të influencojë në gjykimin e tyre ose rezultatin e veprimtarive të vlerësimit të konformitetit, veçanërisht për personat ose grup personash të interesuar për rezultatet e këtyre veprimtarive.

11. Organi i vlerësimit të konformitetit duhet të jetë i aftë të kryejë detyrat e vlerësimit të konformitetit që i janë caktuar nga pjesa përkatëse e legjislacionit dhe për të cilën ai është miratuar, qoftë kur këto detyra janë kryer nga vetë organi i vlerësimit të konformitetit, qoftë në emër të tij dhe nën përgjegjësinë e tij.

Në çdo kohë, për çdo procedurë vlerësimi konformiteti dhe çdo lloj ose çdo kategori produkti, sipas të cilit është miratuar, organi i vlerësimit të konformitetit duhet të ketë në dispozicion:

a) personelin me njohuri teknike dhe përvojën e mjaftueshme dhe të duhur për kryerjen e detyrave të vlerësimit të konformitetit;

b) përshkrimin e procedurave, në përputhje me të cilat kryhet vlerësimi i konformitetit, duke siguruar transparencën dhe aftësinë e riprodhimit të këtyre procedurave. Ai duhet të ketë politikat dhe procedurat e duhura, të cilat bëjnë dallimin ndërmjet detyrave të kryera si organ i miratuar dhe veprimtarive të tjera;

c) procedurat për kryerjen e veprimtarive, të cilat marrin parasysh madhësinë e ndërmarrjes, sektorin në të cilin ajo funksionon, strukturën e tij, shkallën e kompleksitetit të teknologjisë së produktit në fjalë dhe masën/sasinë ose natyrën e prodhimit në seri të procesit të prodhimit.

Organi i vlerësimit të konformitetit duhet të ketë mjetet e nevojshme për kryerjen e detyrave administrative dhe teknike të lidhura me veprimtaritë e vlerësimit të konformitetit në mënyrën e përshtatshme dhe të këtë mundësi të përdorë të gjitha pajisjet e nevojshme.

12. Personeli përgjegjës për kryerjen e veprimtarive të vlerësimit të konformitetit duhet të ketë:

a) aftësi të lartë teknike dhe trajnimi profesional që mbulon të gjitha veprimtaritë e vlerësimit të konformitetit, për të cilat organi i vlerësimit të konformitetit është miratuar;

b) njohuri të kënaqshme të kërkesave të vlerësimeve, të cilat ata kryejnë dhe kompetencën e përshtatshme për kryerjen e këtyre vlerësimeve;

c) njohuri të përshtatshme të kërkesave thelbësore, të standardeve të harmonizuara të zbatueshme dhe të dispozitave përkatëse të legjislacionit përkatës për produktet;

ç) aftësi të hartimit të certifikatave, të regjistrave dhe të raporteve që demonstrojnë kryerjen e vlerësimit të konformitetit.

13. Gjatë veprimtarisë së tyre organi i vlerësimit të konformitetit, drejtuesit më të lartë administrativë dhe teknikë dhe personeli i vlerësimit të konformitetit duhet të garantojnë paanshmëri.

14. Organi i vlerësimit të konformitetit pajiset me siguracionin për përgjegjësinë civile, me përjashtim të rastit kur përgjegjësia për vlerësimin e konformitetit është mbuluar nga shteti ose kur vetë shteti është përgjegjës për vlerësimin e përputhshmërisë.

15. Personeli i organit të vlerësimit të konformitetit duhet të ruajë sekretin profesional për të gjithë informacionin e marrë gjatë kryerjes së detyrave të tij nën legjislacionin përkatës, që ndikon ndaj subjektit të vlerësuar, me përjashtim të autoriteteve kompetente shtetërore.

16. Organi i vlerësimit të konformitetit merr pjesë ose siguron që personeli i tij i vlerësimit është i informuar për veprimtaritë përkatëse të standardizimit dhe ato të grupit koordinativ të organeve të miratuara, kur ky grup ekziston, dhe zbaton, si udhëzim të përgjithshëm, vendimet administrative dhe dokumentet e prodhuara si rezultat i punës së këtij grupi.

17. Rregullat teknike dhe/ose rregullat e sigurisë së produkteve/instalimeve të vendosura në shërbim/në përdorim mund të përfshijnë edhe kritere specifike të tjera.



## Neni 20

### **Procedurat e miratimit të organeve të vlerësimit të konformitetit të akredituara nga organi kombëtar i akreditimit**

1. Organi i vlerësimit të konformitetit, që dëshiron të funksionojë, sipas këtij ligji, si organ i miratuar për qëllime të inspektimit të rregullt periodik të produkteve/instalimeve të vëna në shërbim, duhet të ndjekë procedurat e përshkruara më poshtë.

2. Procedurat për miratimin e organit të vlerësimit të konformitetit (më poshtë aplikant) fillojnë me dorëzimin e aplikimit me shkrim pranë ministrit përgjegjës.

3. Aplikimi duhet të jetë i mbyllur dhe duhet të përmbajë të dhënat dhe dokumentet e mëposhtme:

a) të dhëna të përgjithshme, përfshirë emrin ose firmën, adresën, statusin ligjor, strukturën organizative, shoqëruar me një përshkrim të marrëdhënieve ndërmjet sektorëve/njësive të veçanta, si dhe të dhëna për veprimtaritë që mund të ndikojnë në paanshmërinë e punës;

b) dokumentin e regjistrimit nga QKR-ja;

c) të dhëna për kapacitetin teknik të stafit dhe kompetencat, si dhe vendin e kryerjes së detyrave të vlerësimit të konformitetit;

ç) bazën ligjore, në bazë të së cilës kryhen detyrat e vlerësimit të konformitetit;

d) dosjen e kualifikimeve, sipas përcaktimit të bërë në pikën 3 të nenit 19 të këtij ligji;

dh) dokumentin, nëpërmjet të cilit garantohej se polica e sigurimit për përgjegjësinë mbulon veprimtarinë/funksionimin në Shqipëri;

e) të dhënat e personit të kontaktit.

4. Shpenzimet e sigurimit të të dhënave për kualifikimet dhe kompetencat mbulohen nga aplikanti.

## Neni 21

### **Procedurat e miratimit të organizmave europianë të notifikuar**

1. Organizmi europian i notifikuar, që dëshiron të ushtrojë veprimtarinë e tij në Shqipëri, përveç dokumenteve të listuara në pikën 3 të nenit 20 të këtij ligji, duhet që:

a) të jetë i notifikuar për këtë qëllim nga një shtet anëtar i Bashkimit Europian ku është regjistruar zyra qendrore e këtij organizmi, si dhe të sigurojë evidencë të notifikimit të tij;

b) certifikata e tij e akreditimit të mbulojë funksionimin/veprimtarinë e tij në territorin shqiptar.

2. Ministri përgjegjës mbështetet nga organizmi kombëtar i akreditimit dhe nga një punonjës i strukturës administrative, sipas përcaktimit të bërë në pikën 2 të nenit 17 të këtij ligji, për vlerësimin e dokumentacionit të paraqitur nga aplikanti si organizëm i notifikuar europian.

3. Organizmi kombëtar i akreditimit dhe punonjësi i strukturës administrative, sipas përcaktimit të bërë në pikën 2 të nenit 17 të këtij ligji, i zgjedhur nga ministri përgjegjës, paraqesin një opinion për përmbushjen e kërkesave të sipërpërmendura.

4. Ministri përgjegjës vendos për kualifikimet dhe kompetencat e aplikantit në bazë të opinionit, referuar në pikën 3 të këtij neni.

5. Ministri përgjegjës konsideron se organizmi i notifikuar europian është kompetent, kur ka evidenca se aplikanti përmbush të gjitha kërkesat e zbatueshme ndaj tij. Në këtë rast, ministri përgjegjës lëshon për aplikantin vendimin e miratimit për kryerjen e detyrave të veçanta në procedurat e vlerësimit të konformitetit, sipas këtij ligji. Organizmi i notifikuar europian dhe i miratuar nga ministri përgjegjës ka të njëjtat të drejta dhe detyrime si organet e vlerësimit të konformitetit të miratuara në Shqipëri, të ngritura sipas këtij ligji.

6. Shpenzimet e sigurimit të evidencave për kualifikimet dhe kompetencat mbulohen nga organizmi i notifikuar europian.

7. Procedurat e miratimit për organizmat europianë të notifikuar janë të zbatueshme edhe në rastin e organizmave të huaj të vlerësimit të konformitetit, që ushtrojnë veprimtari të inspektiveve periodike për produktet/instalimet e vëna në shërbim kur ato janë të akredituara nga një organizëm akreditues, nënshkruer i marrëveshjes shumëpalëshe me Organizatën Europiane për Akreditimin në fushën përkatëse.

## Neni 22

### **Miratimi**

1. Ministri përgjegjës vendos për kualifikimet e aplikantit në bazë të dokumenteve të paraqitura nga aplikanti, në përputhje me pikën 3 të nenit 20 të këtij ligji. Pas shqyrtimit të aplikimit të paraqitur, ministri vlerëson nëse është e nevojshme kryerja e një vizite në zyrën qendrore të aplikantit ose në ndonjë qendër tjetër, ku kryhen veprimtaritë përkatëse për këtë procedurë, ose marrja e dëshmive të tjera. Kur aplikanti demonstroi kualifikimet e tij me dokumentet e referuara në pikën 3 të nenit 20 të këtij ligji, ministri përgjegjës shqyrton përputhshmërinë e objektit/qëllimit të detyrave përkatëse të aplikimit me objektin/qëllimin e detyrave, për të cilat aplikanti është akredituar ose me objektin/qëllimin e detyrave, referuar në raportin e kualifikimit.

2. Ministri përgjegjës, brenda 30 ditëve pune nga data e dorëzimit të aplikimit, vendos për miratimin e organit të vlerësimit të konformitetit, nëse aplikanti përmbush të gjitha kërkesat dhe kriteret e parashikuara nga ky ligj, ose refuzimin e miratimit me argumentet përkatëse.

## Neni 23

### **Vendimi i miratimit**

1. Miratimi i organit të vlerësimit të konformitetit duhet të përmbajë të paktën të dhënat e mëposhtme:

a) titullin e rregullit teknik përkatës dhe/ose rregullat e sigurisë së produkteve të vëna në shërbim;

b) një përshkrim të hollësishëm të objektit të punës, të përcaktuar në vendim, për të cilin ky organ ka kualifikimet dhe kompetencat e pranuar;

c) periudhën e vlefshmërisë së vendimit;

ç) numrin e identifikimit, të caktuar për organin e miratuar të vlerësimit të konformitetit;

d) emrin e nënshkruarit, të cilit i është dhënë e drejta të firmosë dokumentet e lëshuara nga organi i vlerësimit të konformitetit.

2. Miratimi i lëshohet aplikantit për një periudhë jo më shumë se periudha e tij e vlefshmërisë së certifikatës së akreditimit.

3. Miratimi i organit të vlerësimit të konformitetit mund të shtyhet pas datës së përfundimit të periudhës së tij të vlefshmërisë, vetëm në qoftë se aplikanti konfirmon vlefshmërinë e informacionit të referuar në pikën 3 të nenit 20 dhe në pikën 1 të nenit 21 të këtij ligji, nëpërmjet rinovimit të dëshmive dhe të dhënave përkatëse.

4. Referenca e çdo miratimi, përfshirë objektin e tij, si dhe anulimi i çdo miratimi publikohen në faqen zyrtare të internetit të ministrisë përgjegjëse.

5. Ministri përgjegjës anulon miratimin për organin e miratuar kur kjo kërkohet nga ky organ, ose në rast se organi i miratuar nuk arrin të përmbushë më një apo disa kritere a kërkesa të përcaktuara në rregullat teknike përkatëse apo në rregullat për sigurinë e produktit të vendosur në shërbim/në përdorim dhe kushtet e përcaktuara në vendimin e miratimit.



6. Anulimi i miratimit nuk ndikon në vlefshmërinë e certifikatave, raporteve të testimeve / provave ose të inspektimve të lëshuara nga organi përpara marrjes së këtij vendimi për anulim. Këto dokumente humbin vlefshmërinë e tyre dhe anulohen, vetëm nëse kjo masë është absolutisht e nevojshme dhe kështu është vendosur nga ministri përgjegjës.

#### Neni 24

#### **Mbikëqyrja e organeve të miratuara, të akredituara nga organizmi kombëtar i akreditimit**

1. Ministri përgjegjës ua delegon organizmit kombëtar të akreditimit dhe një punonjësi nga struktura e përcaktuar në pikën 2 të nenit 17 të këtij ligji detyrën e vlerësimit të vazhdueshmërisë së përmbushjes nga organi i miratuar të kriterëve të përcaktuara në miratim dhe në rregullin teknik përkatës, gjatë vizitave mbikëqyrëse nga ky organizëm.

2. Ministri përgjegjës mund të urdhërojë mbikëqyrje jashtë programit/të papritura ndaj organit të miratuar, në qoftë se ka dyshime për veprimtarinë ose për ndonjë ndryshim të këtij organi. Organizmi kombëtar i akreditimit mund të përfshihet në këto vizita.

3. Nëse nga mbikëqyrja referuar në pikën 2 të këtij neni rezulton se organi i miratuar nuk i përmbush më kërkesat e miratimit, grupi mbikëqyrës i posaçëm dhe/ose organizmi kombëtar i akreditimit mund t'i propozojë ministrit përgjegjës pezullimin e miratimit.

4. Ministri përgjegjës mund të lëshojë rekomandime, ku të përcaktohen masat dhe afatet për eliminimin e parregullsive.

5. Organi i vlerësimit të konformitetit është i detyruar të njoftojë ministrin përgjegjës për zbatimin e masave korrigjuese të përcaktuara në rekomandim. Organizmi kombëtar i akreditimit verifikon zbatimin efektiv të masave korrigjuese, sipas afatit të kërkuar dhe i raporton ministrit përgjegjës.

6. Nëse organi i vlerësimit të konformitetit dështon në eliminimin e parregullsive brenda afatit të caktuar, ministri përgjegjës lëshon një vendim për anulimin e miratimit dhe heqjen e emrit të organit të vlerësimit të konformitetit nga regjistri kombëtar i organeve të miratuara.

7. Ministri përgjegjës anulon miratimin në rast se organi i miratuar njofton se ai dëshiron të mos kryejë më detyrat e përcaktuara në vendim.

8. Në rast se një organ është angazhuar në veprimtari që shkelin kushtet e vendimit, miratimi i lëshuar anulohet.

9. Në rastet e parashikuara në pikat 7 e 8 të këtij neni, emri i organit hiqet nga regjistri kombëtar i organeve të miratuara.

#### Neni 25

#### **Mbikëqyrja e organizmave të notifikuar europianë të miratuar**

1. Organizmi i notifikuar europian i miratuar në Shqipëri është subjekt i mbikëqyrjeve të rregullta nga organizmi i tyre europian i akreditimit, si dhe autoriteti kombëtar i notifikimit të tyre.

2. Organi i notifikuar europian i miratuar në Shqipëri është i detyruar:

a) të informojë paraprakisht ministrin përgjegjës për çdo vizitë mbikëqyrjeje ose monitorimi;

b) t'i dorëzojë ministrit përgjegjës një kopje të raporteve të vizitës së monitorimit dhe mbikëqyrjes.

3. Organizmi i notifikuar europian i miratuar në Shqipëri është i detyruar të informojë ministrin përgjegjës për çdo ndryshim ose modifikim të objektit të tij të miratimit dhe notifikimit.

4. Organizmat e notifikuar europianë të miratuar në Shqipëri mund të jenë objekt i mbikëqyrjes jashtë programit/të papritura, të përmendura në pikën 2 të nenit 24 të këtij ligji dhe masave vijuese.

5. Ministri informon nënshkruesit, me të cilët Shqipëria ka nënshkruar një marrëveshje ndërkombëtare për zbatimin e procedurave të vlerësimit të konformitetit, për miratimin dhe anulimin e miratimit të organeve të vlerësimit të konformitetit që kryejnë procedurat, sipas rregullave teknike përkatëse, objekt i këtyre marrëveshjeve.

6. Procedurat e mbikëqyrjes, të parashikuara në këtë nen, janë të zbatueshme edhe në rastin e organizmave të huaj të vlerësimit të konformitetit, që ushtrojnë veprimtari të inspektimeve periodike për produktet/instalimet e vëna në shërbim, kur ato janë të akredituara nga një organizëm akreditues nënshkrues i marrëveshjes shumëpalëshe me Organizatën Europiane për Akreditimin në fushën përkatëse.

## KREU VI VLEFSHMËRIA E DOKUMENTEVE DHE E MARKIMEVE

### Neni 26

#### **Vlefshmëria e dokumenteve dhe e markimeve të konformitetit, të lëshuara jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë**

1. Certifikatat, raportet e testimit dhe të inspektimit, të lëshuara nga organizmat e notifikuar europianë, njihen nga Republika e Shqipërisë. Produktet e importuara, që janë objekt i rregullave teknike dhe mbajnë, sipas kërkesave të legjislacionit të harmonizuar europian, markimin CE ose markim tjetër europian të konformitetit, prezumohen në përputhje me kërkesat e këtij ligji dhe janë të lira të vendosen në tregun shqiptar.

2. Certifikatat, raportet e testimit dhe të inspektimit, të lëshuara nga organet e vlerësimit të konformitetit në vendet jashtë Bashkimit Europian, njihen dhe pranohen në Republikën e Shqipërisë, nëse këto organe janë të akredituara nga një organ akreditues, nënshkrues i marrëveshjeve shumëpalëshe me Organizatën Europiane për Akreditim, Organizatën Ndërkombëtare për Akreditimin e Laboratorëve ose Forumin Ndërkombëtar të Akreditimit, duke siguruar se detyrat e vlerësimit të konformitetit përfshihen në fushën e marrëveshjeve të njohjes, ku organi akreditues është edhe nënshkrues.

3. Certifikatat, raportet e testimit dhe të inspektimit, të lëshuara nga organet e vlerësimit të konformitetit, akreditimi i të cilave nuk është kryer nga organet akredituese, nënshkruese të marrëveshjeve shumëpalëshe me Organizatën Europiane për Akreditim, Organizatën Ndërkombëtare për Akreditimin e Laboratorëve ose Forumin Ndërkombëtar të Akreditimit, njihen nga Republika e Shqipërisë, bazuar në procedurat ekuivalente të akreditimit. Ekuivalenca vlerësohet nga organizmi kombëtar i akreditimit, sipas legjislacionit në fuqi në fushën e akreditimit në Republikën e Shqipërisë.

## KREU VII MBIKËQYRJA E TREGUT

### Neni 27

#### **Struktura përgjegjëse e mbikëqyrjes së tregut**

1. Mbikëqyrja e zbatimit të përputhshmërisë me kërkesat e këtij ligji kryhet nga rrjeti i strukturave përgjegjëse të mbikëqyrjes së tregut, sipas legjislacionit për sigurinë e përgjithshme të produkteve joushqimore.

2. Veprimtaritë e strukturave përgjegjëse mbështeten nga autoritetet doganore, sipas dispozitave të këtij ligji.



3. Strukturat përgjegjëse për produktet e mbuluara nga legjislacioni përkatës sigurojnë marrjen e masave për ndalimin e tregtimit ose ndalimin apo kufizimin e bërjes së disponueshme të tyre në treg kur:

- a) produktet nuk janë në përputhje me legjislacionin e zbatueshëm ndaj tyre; ose
- b) rrezikohet shëndeti apo siguria e përdoruesve, megjithëse këto produkte:
  - i) janë përdorur në kushte, të cilat mund të jenë të parashikueshme në mënyrë të arsyeshme;
  - ii) instalohen dhe mirëmbahen në mënyrë të përshtatshme, sipas parashikimit.

4. Mbikëqyrja e tregut mbulon edhe produktet e montuara ose të prodhuara për qëllime të përdorimit nga vetë prodhuesi, kur një gjë e tillë parashikohet në legjislacionin përkatës për këto produkte.

5. Struktura përgjegjëse, në bashkëpunim me ministrinë përgjegjëse, harton programet e mbikëqyrjes së tregut që mbulojnë sektorët ku ato kryejnë veprimtaritë e mbikëqyrjes së tregut dhe i paraqesin ato për mendim pranë Këshillit Bashkërendues për Mbrojtjen e Konsumatorëve, i krijuar sipas legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e konsumatorëve. Pas miratimit, programet e mbikëqyrjes së tregut bëhen publike në formë elektronike ose, kur është e përshtatshme, edhe me mjete të tjera.

6. Kompetencat dhe detyrimet e strukturës përgjegjëse, të përcaktuara në legjislacionin për sigurinë e përgjithshme të produkteve joushqimore, janë të zbatueshme edhe për zbatimin e këtij ligji.

## Neni 28

### **Përgjegjësitë e ministrisë**

1. Ministria përgjegjëse harton politikat e përgjithshme për mbikëqyrjen e tregut për zbatimin efektiv të këtij ligji.

2. Ministria koordinon me ministrinë përgjegjëse hartimin e rregullave teknike në zbatim të këtij ligji.

3. Përgjegjësitë kryesore të ministrisë përgjegjëse janë si më poshtë:

a) studimi dhe paraqitja e propozimeve për hartimin dhe zhvillimin e politikave për mbikëqyrjen e tregut;

b) përgatitja dhe analiza e masave ligjore për mbikëqyrjen e tregut;

c) marrja e masave koordinuese me strukturën përgjegjëse për zbatimin e dokumenteve strategjike në fushën e mbikëqyrjes së tregut;

ç) mbledhja dhe shkëmbimi i informacionit me ministrinë për produktet e pasigurta ose potencialisht të pasigurta nga ministrinë e linjës dhe strukturat përgjegjëse në varësi të tyre dhe ngritja e rrjetit të informacionit për produktet e rrezikshme/produktet e konsumatorit;

d) vlerësimi periodik i veprimtarive të mbikëqyrjes së tregut;

dh) krijimi, rifreskimi periodik dhe zbatimi i programeve sektoriale të mbikëqyrjes, sipas kategorive të produktit ose rreziqeve, si dhe monitorimi i veprimtarive mbikëqyrëse, rezultateve dhe gjetjeve;

e) rishikimi dhe vlerësimi periodik i funksionimit të veprimtarive të kontrollit dhe efektiviteti i tyre, si dhe, nëse është i nevojshëm, rishikimi i përjasjes së mbikëqyrjes dhe organizimit aktual.

4. Ministria përgjegjëse, gjatë kryerjes së funksioneve të parashikuara në pikën 2 të këtij neni, mbështetet nga Këshilli Bashkërendues për Mbrojtjen e Konsumatorëve.



## Neni 29

### Kompetencat dhe detyrimet e strukturës përgjegjëse

1. Struktura përgjegjëse kryen kontrole të përshtatshme për karakteristikat e produkteve në shkallën e duhur, me anë të:

- a) kontrollit të dokumentacionit;
- b) kontroleve fizike dhe laboratorike në bazë të mostrave, kur është e përshtatshme.

Marrja e këtyre masave bëhet mbështetur në parimet e vlerësimit të riskut, ankesat dhe informacione të tjera.

2. Për detyrimin e zbatimit të kërkesave të këtij ligji, strukturat përgjegjëse kanë të drejtë:

a) të kërkojnë vënien në dispozicion të të gjitha të dhënave dhe të dokumenteve të nevojshme nga operatorët ekonomikë;

b) të hyjnë në qendrat e punës të operatorëve ekonomikë dhe të marrin mostrat e nevojshme të produkteve, kur është e nevojshme dhe e justifikuar;

c) të organizojnë kontrole të përshtatshme për tiparet e sigurisë në një shkallë të mjaftueshme deri në fazën e fundit të përdorimit ose shërbimit;

ç) të marrin mostra të produkteve ose komponentëve dhe të kryejnë ose t'i dërgojnë ato për kontrole të sigurisë ose të përputhshmërisë me kërkesat ligjore të zbatueshme, kur është e nevojshme;

d) të shkatërrojnë ose ta bëjnë jofunksional produktin që paraqet një rrezik serioz, kur kjo është e nevojshme.

3. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të lejojnë hyrjen në qendrat e tyre të punës, të paraqesin informacionin dhe dokumentacionin e nevojshëm, si dhe të krijojnë kushte të përshtatshme për mbikëqyrjen nga punonjësit/inspektorët e strukturës përgjegjëse.

4. Struktura përgjegjëse urdhëron përmbushjen nga operatorët ekonomikë ose, sipas rastit, personin përgjegjës të produktit/instalimit të vënë në shërbim/përdorim, marrjen e masave të mëposhtme:

a) për çdo produkt të disponueshëm në treg apo produkt/instalim në shërbim, që mund të paraqesë risk në kushte të caktuara, vendosjen në të të paralajmërimeve të qarta, të përshtatshme dhe lehtësisht të kuptueshme në gjuhën shqipe për riskun që mund të paraqitet;

b) çdo masë tjetër të nevojshme për përmirësimin e sigurisë së produkteve/instalimeve në shërbim;

c) kur struktura përgjegjëse ka gjetur mangësi që mund të mënjanohen, mënjanimin e tyre, si parakusht për tregtimin e produkteve.

5. Struktura përgjegjëse ruan konfidencialitetin, kur është e nevojshme, për mbrojtjen e sekreteve tregtare ose të të dhënave personale, në bazë të legjislacionit në fuqi. Sipas këtij ligji, informacioni mund të bëhet publik vetëm në ato raste kur ka si qëllim mbrojtjen e interesave të përdoruesve të produktit/instalimit.

6. Strukturat përgjegjëse marrin masat e duhura për lajmërimin e përdoruesve brenda territorit të tyre, brenda një kohe të përshtatshme, për riskun që ata kanë identifikuar për çdo produkt, me qëllim reduktimin e riskut ndaj plagosjeve ose dëmtimeve të tjera.

7. Strukturat përgjegjëse bashkëpunojnë me operatorët ekonomikë apo, sipas rastit, me personin përgjegjës të produktit/instalimit për veprimet që mund të parandalojnë ose të reduktojnë rrezikun e shkaktuar nga produktet që bëhen të disponueshme në treg nga operatorët.

8. Strukturat përgjegjëse kryejnë detyrat në mënyrë të pavarur, të paanshme dhe pa paragjykime.

9. Gjatë ushtrimit të funksioneve, struktura përgjegjëse, sipas kërkesës së saj, mbështetet nga organet e Policisë së Shtetit.



## Neni 30

### Ndalimi i tregtimit

1. Struktura përgjegjëse mund të vendosë të ndalojë përkohësisht bërjen e disponueshme të produktit në treg në rastet kur:

a) ka dyshime se produkti nuk përmbush kërkesat thelbësore apo kërkesat e tjera të sigurisë së produkteve;

b) produkti nuk ka markimin e konformitetit ose është markuar në mënyrë të paligjshme me markimin e konformitetit dhe/ose nuk është shoqëruar me dokumentacionin e përcaktuar në legjislacionin e zbatueshëm ndaj këtij produkti/instalimi;

c) operatorët ekonomikë nuk kanë përmbushur masat e urdhëruara, sipas përcaktimit të bërë në pikën 4 të nenit 29 të këtij ligji, brenda afatit kohor të vendosur nga struktura përgjegjëse, dhe produkti mund të paraqesë rrezik për konsumatorin ose përdoruesin e fundit;

ç) tregtimi mund të jetë i rrezikshëm përpara plotësimit të kushteve paraprake;

d) autoritetet e mbikëqyrjes së tregut në vende të tjera të BE-së kanë njoftuar se produkti është i rrezikshëm dhe/ose jo në përputhje me kërkesat ligjore të përcaktuara për produktin.

2. Struktura përgjegjëse anulon vendimin për ndalimin e përkohshëm të tregtimit kur operatori ekonomik demonstron se ai e ka ndrequr situatën.

3. Vendimi i ndalimit të përkohshëm mund të shoqërohet, nëse është e nevojshme, me urdhërimin e operatorit ekonomik për lajmërimin e konsumatorit ose/dhe përdoruesit të fundit për riskun.

4. Në qoftë se testimet e mostrave të urdhëruara nga struktura përgjegjëse tregojnë se produkti nuk është në përputhje me kërkesat e sigurisë, të përcaktuara në legjislacionin përkatës, ose i pasigurt, shpenzimet e testeve të ngarkohen operatorit ekonomik/personit përgjegjës të produktit/instalimit të vënë në shërbim. Në rast të kundërt, shpenzimet mbulohen nga struktura përgjegjëse. Testimi kryhet në laboratorë të akredituar.

5. Struktura përgjegjëse urdhëron ndalimin e përhershëm të tregtimit, në qoftë se kontrollet apo testimet provojnë se produkti është i rrezikshëm, nuk është në përputhje me kërkesat përkatëse të sigurisë ose, pavarësisht përputhshmërisë, ai mund të rrezikojë sigurinë e jetës, shëndetit, mjedisit ose interesave të tjerë publikë.

6. Vendimi, referuar pikës 5 të këtij neni, mund të merret nga struktura përgjegjëse në qoftë se:

a) të njëjtat masa janë marrë nga të gjitha shtetet anëtare të BE-së, ku është tregtuar produkti;

b) prodhuesi, përfaqësuesi i autorizuar ose importuesi kanë njoftuar se produkti është i rrezikshëm ose nuk është në përputhje me legjislacionin përkatës.

7. Vendimi, referuar në pikën 5 të këtij neni, sipas rastit, shoqërohet me një apo disa nga masat e mëposhtme:

a) lajmërimin e konsumatorëve ose të përdoruesve të fundit, duke përdorur mjetet e përshtatshme të komunikimit publik për rrezikun që paraqet produkti/instalimi;

b) urdhërimin për ndalimin e menjëhershëm të tregtimit, në qoftë se produkti është tashmë në treg, ose kthimin mbrapsht të tij;

c) urdhërimin e bërjes jofunksional të produktit/instalimit në shërbim ose shkatërrimin e tij.

8. Lajmërimi i konsumatorëve dhe i përdoruesve të fundit, sipas pikës 7 të këtij neni, dhe kthimi i produkteve duhet të kryhen nga operatorët ekonomikë nën mbikëqyrjen e strukturës përgjegjëse. Në rast se masat e marra nga operatorët ekonomikë konsiderohen si të pamjaftueshme, veprimet e sipërpërmendura kryhen nga struktura përgjegjëse dhe shpenzimet mbulohen nga operatori ekonomik përgjegjës.

Kthimi i produkteve përfshin rimbursimin ose shkëmbimin me një produkt tjetër me të njëjtin çmim, nëse kështu pranohet nga konsumatori.

9. Shkatërrimi i produktit ose bërja jofunkionale kryhet nga struktura përgjegjëse dhe shpenzimet mbulohen nga operatori ekonomik përgjegjës.

10. Rregullat dhe procedurat e shkatërrimit përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

#### Neni 31

#### **Ndalimi i përdorimit të produkteve/instalimeve në shërbim**

1. Struktura përgjegjëse mund të vendosë të ndalojë përkohësisht funksionimin e mëtejshëm të produktit/instalimit në shërbim ose në përdorim në rastet kur:

a) produkti/instalimi në shërbim/përdorim është në funksionim dhe i paregjistruar, ose nuk i është nënshtruar inspektimeve periodike të detyrueshme, sipas parashikimeve të bëra në këtë ligj;

b) ka dyshime serioze se funksionimi i mëtejshëm i produktit/instalimit në shërbim/përdorim nuk është i sigurt, ndonëse përdoret sipas parashikimit;

c) personi përgjegjës i produktit/instalimit të vënë në shërbim nuk ka zbatuar masat e urdhëruara nga struktura përgjegjëse, brenda afatit kohor të lënë, përfshirë ato të përcaktuara në pikën 4 të nenit 29 të këtij ligji dhe, në këtë mënyrë, përdorimi në kushte të tilla nuk është i sigurt.

2. Në rastin e parashikuar në shkronjën “b” të pikës 1 të këtij neni, struktura përgjegjëse mund të urdhërojë kontrolle sigurie apo teste për produktin ose komponentët e tij në laboratorë të akredituar.

3. Në qoftë se testet provojnë papërputhshmërinë me kërkesat përkatëse ligjore, shpenzimet e tyre i ngarkohen personit përgjegjës të produktit/instalimit të vënë në shërbim.

4. Struktura përgjegjëse anulon pezullimin e përkohshëm, kur personi përgjegjës i produktit/instalimit të vënë në shërbim demonstroi se e ka ndrequr situatën.

5. Struktura përgjegjëse vendos ndalimin e funksionimit të mëtejshëm të produktit/instalimit në shërbim/përdorim, në qoftë se inspektimi ose kontrolli për sigurinë provon se vazhdueshmëria e përdorimit nuk është e sigurt. Në këtë rast, struktura përgjegjëse e kthen produktin në jofunksional.

#### Neni 32

#### **Produkti që paraqet risk serioz**

1. Struktura përgjegjëse siguron se produktet, që paraqesin risk serioz dhe kërkojnë ndërhyrje të menjëhershme, përfshirë riskun serioz, efektet e të cilit nuk janë të menjëhershme, kthehen mbrapsht dhe ndalohet tregtimi dhe bërja e tyre e disponueshme në treg. Në këtë rast informohet ministria përgjegjëse.

2. Vendimi për riskun serioz të produktit bazohet në vlerësimin e riskut, duke pasur parasysh natyrën dhe mundësinë e ndodhjes së tij, siç parashikohet në legjisllacionin për sigurinë e përgjithshme të produkteve joushqimore. Arritja e niveleve më të larta të sigurisë minimale të lejuar ose mundësia e produkteve të tjera, që paraqesin një shkallë më të ulët risku, nuk përbën bazë për të konsideruar se produkti paraqet një risk serioz.

#### Neni 33

#### **Masa kufizuese**

1. Struktura përgjegjëse siguron se çdo masë e marrë, sipas këtij ligji, për të ndaluar ose për të kufizuar bërjen e disponueshme të produktit në treg, për të ndaluar tregtimin ose kthimin e tij nga përdoruesi i fundit, bazohet në parimin e proporcionalitetit sipas parashikimit në dispozitat e këtij ligji.



2. Masa të tilla i komunikohen paraprakisht operatorit ekonomik përkatës brenda 5 ditëve nga data e përfundimit të kontrollit, i cili, sipas rastit, informohet për ndreqjet e mundshme, në përputhje me legjislacionin dhe afatin kohor brenda të cilit duhen kryer.

3. Përpara marrjes së masave, referuar në pikën 1 të këtij neni, operatorit ekonomik i jepet mundësia të dëgjohet brenda 10 ditëve dhe të paraqesë me shkrim argumentet e tij. Përfundim nga ky rregull bëhet në rastet kur:

a) urgjenca e masave të marra është justifikuar nga ruajtja e shëndetit dhe sigurisë së qytetarëve; ose

b) urgjenca e masave të marra është justifikuar nga interesat publike ose nga dispozita të tjera të legjislacionit përkatës.

Në qoftë se masat janë marrë pa u dëgjuar operatori ekonomik, atij i jepet mundësia të dëgjohet sa më shpejt të jetë e mundur dhe pas kësaj masat e marra rishikohen menjëherë.

4. Çdo masë referuar pikës 1 të këtij neni do të pezullohet/anulohet ose ndryshohet menjëherë me demonstrimin nga ana e operatorit ekonomik të marrjes së masave të duhura.

#### Neni 34

#### **Kontrolli i produkteve që hyjnë në territorin shqiptar**

1. Autoritetet doganore pezullojnë zhdoganimin e produktit për të qarkulluar lirisht në territorin e Republikës së Shqipërisë kur konstatohet ndonjë nga rastet e mëposhtme:

a) produkti paraqet në mënyrë të dukshme një risk serioz për shëndetin, sigurinë, mjedisin ose interesa të tjerë publike, referuar këtij ligji;

b) markimi CE i konformitetit është fiksuar në mënyrë të falsifikuar dhe jo sipas kërkesave të legjislacionit të zbatueshëm, që parashikon vendosjen e tij, ose është çorientues a mungon krejtësisht;

c) produkti nuk është shoqëruar nga dokumentacioni i kërkuar, sipas legjislacionit përkatës shqiptar, ose nuk është markuar në përputhje me këtë legjislacion apo atë të harmonizuar evropian;

ç) njoftohen nga ministria/ministritë përgjegjëse për pezullimin e zhdoganimit të produkteve të caktuara, në bazë të vendimeve të Komisionit Europian për ndalimin e tregtimit, tërheqjen nga tregu apo kthimin e produkteve ose nga njoftimet e sistemeve të shkëmbimit të shpejtë të informacionit të vendeve të BE-së për produktet e rrezikshme. Autoritetet doganore për çdo pezullim të tillë njoftojnë strukturën përgjegjëse brenda 24 orëve, nëpërmjet mjeteve të përshtatshme të komunikimit.

2. Struktura përgjegjëse heton më tej çështjen dhe, në qoftë se është e nevojshme, merr ndonjëherë nga masat e përcaktuara në nenet 29 e 30 të këtij ligji, si dhe njofton brenda 3 ditëve pune një nga vendimet e mëposhtme:

a) zhdoganimin e produktit, në qoftë se provohet se ky produkt nuk paraqet risk serioz për shëndetin dhe sigurinë dhe/ose është në përputhje me legjislacionin përkatës;

b) ndalimin e përkohshëm të zhdoganimit derisa të kryhen kontrollet e duhura;

c) ndalimin e zhdoganimit, nëse struktura përgjegjëse provon se produkti është i rrezikshëm.

3. Struktura përgjegjëse merr vendimin për ndalimin e zhdoganimit, në qoftë se, nga kontrollet apo testimet, provon se produkti është i rrezikshëm, nuk është në përputhje me kërkesat ligjore përkatëse ose, pavarësisht përputhshmërisë, mund të rrezikojë sigurinë e jetës, shëndetin, mjedisit ose interesave të tjerë publike.

4. Në rast se struktura përgjegjëse njofton për zhdoganimin/lirimin ose nuk njofton brenda afatit të caktuar, produkti zhdogonohet nga autoritetet doganore, duke siguruar se të gjitha kërkesat e tjera dhe formalitetet për këtë zhdoganim janë përmbushur.

5. Në bazë të përfundimit të kontroleve të parashikuara në shkronjën “b” të pikës 2 të këtij neni, struktura përgjegjëse njofton përkatësisht autoritetet doganore për:

a) zhdoganimin;

b) ndalimin e zhdoganimit, në qoftë se produkti është gjetur i pasigurt a nuk është në përputhje ose, pavarësisht përputhshmërisë, mund të rrezikojë sigurinë e jetës, shëndetit, mjedisit ose interesave të tjerë publikë.

6. Zhdoganimi mund të shoqërohet me urdhrin, nga struktura përgjegjëse, të një ose më shumë masave administrative të parashikuara në nenin 29 pika 4 dhe nenin 30 pika 1 shkronja “b” të këtij ligji.

7. Në qoftë se struktura përgjegjëse njofton/vendos ndalimin e zhdoganimit, autoritetet doganore përfshijnë në faturat tregtare, që shoqërojnë produktin dhe çdo dokumentacion tjetër shoqërues, ose kur përpunimi i të dhënave kryhet elektronikisht në vetë sistemin e përpunimit të të dhënave, nënshkrimin e mëposhtëm:

“Nuk autorizohet zhdoganimi për qarkullim të lirë në Republikën e Shqipërisë, sipas këtij ligji”.

Në këtë rast, struktura përgjegjëse mund të urdhërojë shkatërrimin e produktit ose kthimin e tij në vendin e origjinës, si dhe notifikon këtë masë pranë Autoritetit Kombëtar të Notifikimit në OBT, në përputhje me legjislacionin në fuqi për standardizimin.

## KREU VIII KUNDËRVAJTJET ADMINISTRATIVE

### Neni 35 Kundërvajtjet administrative

Shkeljet e dispozitave të këtij ligji nga operatorët ekonomikë, sipas rolit dhe përgjegjësisë së tyre, kur nuk përbëjnë vepër penale, përbëjnë kundërvajtje administrative dhe dënohen si më poshtë:

1. Shkeljet e dispozitës së parashikuar në nenin 8 pika 2, në nenin 9 pikat 3, 4, 7 e 8, në nenin 10 pikat 3, 4, 5, 6 e 7, në nenin 12 pikat 3, 4 e 6, në nenin 13 pikat 2 e 4, në nenin 16 pika 4, në nenin 18 pika 2 e 7, me gjobë 100 000 lekë.

2. Shkeljet e dispozitës së parashikuar në nenin 4 pikat 2 e 3, në nenin 8 pika 1, në nenin 9 pika 1, në nenin 10 pikat 1, 2, 8 e 9, në nenin 11 pika 2, në nenin 12 pikat 1, 2, 5, 7, 8 e 9, në nenin 13 pikat 3 e 5, në nenin 15, në nenin 16 pikat 1 e 2, në nenin 18 pikat 6 e 8, në nenin 25 pikat 2 e 3, si dhe në nenin 29 pika 3, me gjobë 200 000 lekë.

3. Moszbatimi i masave të lëna nga struktura përgjegjëse, sipas nenit 30 pika 1 shkronja “c” dhe pika 7/b, me gjobë 3 për qind të xhiros vjetore të vitit financiar paraardhës, por jo më pak se 200 000 lekë.

4. Shkeljet e kërkesave të parashikuara në nenin 5 pika 2 shkronjat “a” dhe “b” dhe pika 4 shkronja “a” të këtij ligji, me gjobë 3 për qind të xhiros vjetore të vitit financiar paraardhës, por jo më pak se 200 000 lekë.

5. Shkeljet e kërkesave të parashikuara në nenin 5 pika 2 shkronja “c” dhe pika 4 shkronjat “b” e “c” të këtij ligji, me gjobë 200 000 lekë.

### Neni 36

Shkeljet me karakter administrativ verifikohen dhe dënohen nga struktura përgjegjëse.



#### Neni 37

##### **Hartimi dhe njoftimi i procesverbalit**

1. Në përfundim të kontrollit/inspektimit, inspektori/rët harton/jnë dhe firmos/in procesverbalin, në të cilin shënohen identiteti i kundërvajtësit dhe lista e gjetjeve faktike, lloji i kundërvajtjes, si dhe mënyra/lloji i kontrollit/inspektimit, si dhe masat apo dënimin e mundshëm, në bazë të gjetjeve faktike. Procesverballi hartohet edhe në rastin kur nuk ka kundërvajtje

2. Një kopje e procesverbalit i dorëzohet operatorit ekonomik përkatës brenda 5 ditëve pune nga data e përfundimit të kontrollit. Operatori ekonomik, brenda 10 ditëve pune pas marrjes së procesverbalit, ka të drejtën të paraqesë komentet e tij për konstatimet e dhëna në këtë procesverbal, me përjashtim të rasteve urgjente, referuar në nenin 32 të këtij ligji.

#### Neni 38

Personi përgjegjës, që ka kryer kontrollin, merr vendim brenda 30 ditëve pune nga data e njoftimit të procesverbalit operatorit ekonomik që ka kryer shkeljen.

#### Neni 39

##### **Ankimi**

1. Ankimi administrativ kundër vendimit për shkeljen administrative paraqitet dhe shqyrtohet sipas parashikimeve të Kodit të Procedurave Administrative.

2. Ankimi administrativ kundër vendimit që parashikon dënim me gjobë, si dhe masa të tjera shoqëruese, të parashikuara në nenet 29, 30, 31 dhe 32 të këtij ligji, nuk pezullojnë zbatimin e vendimit për masat shoqëruese.

3. Ankimi administrativ shqyrtohet nga Komisioni i Shqyrtimit të Vendimit për Shkeljen Administrative, i krijuar brenda strukturës përgjegjëse, i cili ka në përbërje nëpunës të pavarur nga ata të përfshirë në marrjen e vendimit të ankimuar.

4. Përbërja e Komisionit të Shqyrtimit të Vendimit për Shkeljen Administrative miratohet/përcaktohet me urdhër të ministrit.

5. Ngarkohet Këshilli i Ministrave për nxjerrjen e rregullores për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Shqyrtimit të Vendimit për Shkeljen Administrative.

6. Kundër vendimit të dhënë nga Komisioni i Shqyrtimit të Vendimit për Shkeljen Administrative, operatori ekonomik mund të bëjë ankim në gjykatë brenda 30 ditëve.

#### Neni 40

##### **Ekzekutimi i vendimit**

1. Vendimi për kundërvajtjen administrative përbën titull ekzekutiv dhe ekzekutohet nga shërbimi përmbarimor.

2. Vendimi bëhet i ekzekutueshëm kur e drejta për ankim nuk është ushtruar brenda afateve kohore të parashikuara sipas këtij ligji ose në momentin e nxjerrjes së vendimit përfundimtar nga Komisioni i Shqyrtimit të Vendimit për Shkeljen Administrative.

#### Neni 41

Të ardhurat që burojnë nga vjelja e gjobave derdhen në Buxhetin e Shtetit.

**KREU IX  
DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT**

Neni 42

Ngarkohet Këshilli i Ministrave të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të këtij ligji.

Neni 43

1. Në ligjin nr.8734, datë 1.2.2001 “Për garantimin e sigurisë së punës të pajisjeve dhe instalimeve elektrike”, pika 4/a dhe pika 6 e nenit 2 shfuqizohen.

2. Aktet nënligjore, në zbatim të ligjit nr.9779, datë 16.7.2007 “Për sigurinë e përgjithshme, kërkesat thelbësore dhe vlerësimin e konformitetit të produkteve joushqimore”, kur nuk janë në kundërshtim me këtë ligj, shfuqizohen brenda 1 viti nga hyrja në fuqi e këtij ligji.

Neni 44

**Hyrja në fuqi**

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.7210, datë 23.12.2011 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,  
Bamir Topi**

**LIGJ**

**Nr.10 490, datë 15.12.2011**

**PËR PËRCAKTIMIN E FORMËS DHE TË STRUKTURËS SË FORMULËS SË  
PRIVATIZIMIT TË SHOQËRISË “ALBPETROL”, SHA, PATOS**

Në mbështetje të neneve 78 e 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Shoqëria “ALBPETROL”, sh.a., Patos i nënshtrohet privatizimit. Forma dhe struktura e formulës së privatizimit të shoqërisë “ALBPETROL”, sh.a., Patos përcaktohen nga ky ligj i veçantë, në zbatim të dispozitave të ligjit nr.8306, datë 14.3.1998 “Për strategjinë e privatizimit të sektorëve me rëndësi të veçantë”, të ndryshuar.

Neni 2

Forma e privatizimit të shoqërisë “ALBPETROL”, sh.a., Patos të jetë ajo e transferimit të së drejtës së pronësisë të aksioneve të kapitalit të shoqërisë tek investitorët strategjikë, sipas mënyrës së parashikuar në këtë ligj.



Investitorë strategjikë do të konsiderohen të gjithë personat juridikë që zotërojnë cilësitë e përcaktuara në përkufizimin e dhënë nga ligji nr.8306, datë 14.3.1998 “Për strategjinë e privatizimit të sektorëve me rëndësi të veçantë”, të ndryshuar.

#### Neni 3

Struktura e formulës së privatizimit të aksioneve të kapitalit të shoqërisë “ALBPETROL”, sh.a., Patos do të jenë si më poshtë:

100 për qind e aksioneve të kapitalit u ofrohen për transferim investitorëve strategjikë, të cilët janë shoqëri të specializuara në fushën e naftës dhe të gazit, nëpërmjet shitjes së aksioneve me procedurë të hapur, sipas ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar. PAGESA e kësaj pakete të aksioneve të bëhet me para.

#### Neni 4

Trajtimi i punonjësve që do të dalin të papunë nga procesi i ristrukturimit, në kuadër të privatizimit të shoqërisë “ALBPETROL”, sh.a., Patos të përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

#### Neni 5

1. Të ardhurat nga privatizimi i shoqërisë “ALBPETROL”, sh.a., Patos do të përdoren:
  - a) për mbulimin e shpenzimeve për organizimin e tenderit dhe për veprimtari të tjera, që nevojiten në procesin e privatizimit;
  - b) për mbulimin e fondeve për trajtimin e punonjësve;
  - c) pjesa që mbetet kalon në Buxhetin e Shtetit.
2. PAGESA e tarifës së suksesit ndaj shoqërisë së huaj konsulente bëhet nga ofertuesi fitues.
3. Masa e përdorimit të të ardhurave nga privatizimi i shoqërisë “ALBPETROL”, sh.a., Patos përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

#### Neni 6

Kriteret e përzgjedhjes së investitorëve strategjikë dhe kriteret e vlerësimit të ofertave për privatizimin e shoqërisë “ALBPETROL”, sh.a., Patos përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

#### Neni 7

Ngarkohet Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës që, me asistencën e shoqërisë konsulente, të ndjekë dhe të organizojë kryerjen e procedurave për privatizimin e shoqërisë “ALBPETROL”, sh.a., Patos, në zbatim të këtij ligji.

#### Neni 8

Ngarkohet Këshilli i Ministrave të nxjerrë aktet e nevojshme nënligjore në zbatim të neneve 4, 5 pika 3 dhe 6 të këtij ligji.



Neni 9

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.7211, datë 23.12.2011 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,  
Bamir Topi**

**LIGJ**

**Nr.10 491, datë 15.12.2011**

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR.7829, DATË 1.6.1994  
“PËR NOTERINË”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI  
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**VENDOSI:**

Në ligjin nr.7829, datë 1.6.1994 “Për noterinë”, të ndryshuar, bëhen shtesat dhe ndryshimet e mëposhtme:

**Neni 1**

Në nenin 13 fjalët “ka të drejtë” zëvendësohen me fjalët “duhet të ketë”.

**Neni 2**

Në nenin 23 bëhen këto shtesa:

1. Pas paragrafit të tretë shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

“Të regjistrojë, të ruajë, të shfrytëzojë, të përdorë dhe të transmetojë të dhënat personale të palëve në përputhje me kërkesat dhe kriteret e përcaktuara në legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale.”.

2. Pas paragrafit të fundit shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

“Të paraqesë për regjistrim, me pëlqimin e palëve, aktin noterial për tjetërsimin e pasurisë së paluajtshme pranë zyrës së regjistrimit të pasurive të paluajtshme që administron regjistrin elektronik ku ndodhet pasuria e paluajtshme, brenda afatit të përcaktuar me ligj.”.

**Neni 3**

Në nenin 26, në fjalinë e parë, pas fjalëve “veprimeve noteriale” shtohen fjalët “si dhe për shërbimin noterial të regjistrimit të akteve për tjetërsimin e pasurisë së paluajtshme pranë zyrës së regjistrimit të pasurive të paluajtshme”.



#### Neni 4

Në nenin 49 bëhen këto ndryshime:

1. Në fund të shkronjës “dh” shtohet një fjali me këtë përmbajtje:

“Në rastet e tjetërsimit të pasurisë së paluajtshme tregohet deklarimi i noterit se ka verifikuar pronësinë e palës në regjistrin elektronik të pasurive të paluajtshme.”.

2. Fjalja e dytë e shkronjës “ë” ndryshohet si më poshtë:

“Në rastet e tjetërsimit të pasurive të paluajtshme, akti duhet të tregojë edhe mënyrën e derdhjes së çmimit të tjetërsimit në llogarinë bankare të noterit. Procedura teknike për derdhjen e pagesës përcaktohet me udhëzim të përbashkët të Ministrit të Drejtësisë dhe Ministrit të Financave. Aktet noteriale të tjera, kur është rasti, duhet të përmbajnë edhe numrin e pagimin e ndonjë sasi parash të kryer në prani të noterit.”.

#### Neni 5

Neni 54 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 54

#### **Procedurat për tjetërsimin e pasurisë së paluajtshme**

Akti noterial për tjetërsimin ose njohjen e pronësisë mbi sendet e paluajtshme, ose të një të drejte reale mbi to, kryhet nga noteri, pasi të ketë verifikuar pronësinë e palës mbi sendin e paluajtshëm. Për këtë qëllim pala i paraqet noterit dokumentet e pronësisë dhe noteri, me pëlqimin e saj, verifikon gjendjen juridike të pronësisë në regjistrin elektronik të pasurive të paluajtshme.

Noteri duhet të shënojë në aktin noterial për tjetërsimin e pasurisë së paluajtshme verifikimin e bërë dhe t'i bashkëlidhë rezultatin e verifikimit.”.

#### Neni 6

Në nenin 71 shtohet paragrafi i dytë me këtë përmbajtje:

“Këshilli i Ministrave, me vendim, krijon bazën e të dhënave shtetërore noteriale”.

#### Neni 7

Pas nenit 72 shtohet neni 72/1 me këtë përmbajtje:

“Neni 72/1

#### **Dispozitë kalimtare**

Dispozitat e këtij ligji janë të zbatueshme për zyrat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme ku funksionon regjistri elektronik i pasurive të paluajtshme.

Deri në krijimin dhe funksionimin e regjistrit elektronik, tjetërsimi i pasurive të paluajtshme kryhet sipas procedurave ligjore të mëparshme.

Ngarkohet Këshilli i Ministrave të nxjerrë vendimin në zbatim të nenit 71 paragrafi i dytë brenda gjashtë muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji.

Neni 8  
**Hyrja në fuqi**

Ky ligj hyn më fuqi më 1 mars 2012.

**Shpallur me dekretin nr.7212, datë 23.12.2011 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,  
Bamir Topi**

**LIGJ**  
**Nr.10 492, datë 15.12.2011**

**PËR NJË SHITESË NË LIGJIN NR.9981, DATË 8.9.2008 “PËR MIRATIMIN E NIVELEVE  
TË TARIFËS DOGANORE”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI**  
**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**VENDOSI:**

Në ligjin nr.9981, datë 8.9.2008 “Për miratimin e niveleve të tarifës doganore”, të ndryshuar, bëhet ndryshimi si më poshtë:

**Neni 1**

Në lidhjen nr.1, të ndryshuar, që i bashkëlidhet ligjit, në pjesën e dytë, seksioni II “Produktet vegjetale”, kapitulli 7 “Zarzatet e ngrënshme, rrënjët dhe tuberat përkatës”, Kodi tarifor 0703 10 11 100 “Për mbjellje”\* ka tarifë doganore 2 për qind.

**Neni 2**

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.7213, datë 23.12.2011 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,  
Bamir Topi**



**LIGJ**  
**Nr.10 493, datë 15.12.2011**

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR.9741, DATË 21.5.2007 “PËR  
ARSIMIN E LARTË NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 78 e 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e një deputeti,

**KUVENDI**  
**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**VENDOSI:**

Në ligjin nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

**Neni 1**

Në nenin 12 bëhen ndryshimet dhe shtesat e mëposhtme:

1. Në pikën 6 bëhet ky ndryshim:

Pas fjalëve “së paku, gradën shkencore “Doktor” dhe përvojë pune” shtohen fjalët “klinike dhe akademike”.

2. Në pikën 6/2, pas paragrafit të parë shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

“Kur në një lëndë/disiplinë ka më shumë se një shërbim, Bordi i Qendrës Spitalore Universitare përzgjedh një nga përgjegjësit e shërbimit me përvojën më të gjatë kliniko-akademike për titullar të njësisë bazë të fakultetit dhe ia paraqet për emërim rektorit të institucionit të arsimit të lartë. Ai është përgjegjës për drejtimin dhe koordinimin e veprimtarisë mësimore-kërkimore në fushën përkatëse. Mandati i tij është i njëjtë me atë të përgjegjësit të shërbimit.”.

**Neni 2**

Në nenin 23 pika 1 bëhet ky ndryshim:

Fjala e dytë riformulohet si më poshtë:

“Autoritetet drejtuese nuk mund të zgjidhen për më shumë se dy mandate radhazi në të njëjtin funksion.”.

**Neni 3**

**Hyrja në fuqi**

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.7214, datë 23.12.2011 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,  
Bamir Topi**

**VENDIM**  
**Nr.143, datë 15.12.2011**

**PËR ZGJEDHJEN E KRYETARIT TË KONTROLLIT TË LARTË TË SHETITIT**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 162 pika 2 të Kushtetutës, të nenit 111 të Rregullores së Kuvendit dhe të nenit 11 të ligjit nr.8270, datë 23.12.1997 “Për Kontrollin e Lartë të Shtetit”, të ndryshuar, si dhe bazuar në dekretin nr.7163, datë 17.11.2011 të Presidentit të Republikës “Për propozimin e Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit”,

**KUVENDI**  
**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**VENDOSI:**

- I. Zoti Bujar Leskaj zgjidhet Kryetar i Kontrollit të Lartë të Shtetit.
- II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARE**  
**Jozefina Topalli (Çoba)**

**VENDIM**  
**Nr.144, datë 15.12.2011**

**PËR ZGJEDHJEN E ZOTIT ADRIAN CIVICI ANËTAR TË KËSHILLIT MBIKËQYRËS  
TË BANKËS SË SHQIPËRISË**

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës, të nenit 44 pikat 2 dhe 3 të ligjit nr.8269, datë 23.12.1997 “Për Bankën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të nenit 111 të Rregullores së Kuvendit, si dhe bazuar në shkresën nr.10108 prot., datë 5.12.2011 të Guvernatorit të Bankës së Shqipërisë për propozimin e zotit Adrian Civici anëtar të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë,

**KUVENDI**  
**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**VENDOSI:**

- I. Zoti Adrian Civici zgjidhet anëtar i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.
- II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARE**  
**Jozefina Topalli (Çoba)**



**VENDIM**  
**Nr.145, datë 15.12.2011**

**PËR ZGJATJEN E AFATIT TË VEPRIMTARISË SË KOMISIONIT HETIMOR TË KUVENDIT “PËR HETIMIN E VEPRIMTARISË SË INSTITUCIONEVE SHETËRORE PËR ZBULIMIN, IDENTIFIKIMIN, PËRBALLIMIN, NEUTRALIZIMIN, PENGIMIN DHE NDËSHKIMIN E VEPRIMIT TË ORGANIZUAR KRIMINAL PËR DHUNIMIN E INSTITUCIONEVE DHE PËRMBYSJEN E RENDIT KUSHTETUES NË DATËN 21 JANAR 2011”, TË NGRITUR ME VENDIMIN E KUVENDIT NR.82, DATË 23.1.2011**

Në mbështetje të neneve 77 dhe 78 të Kushtetutës, të neneve 8 dhe 9 të ligjit nr.8891, datë 2.5.2002 “Për organizimin dhe funksionimin e komisioneve hetimore të Kuvendit”, si dhe të nenit 25 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e komisionit hetimor të Kuvendit,

**KUVENDI**  
**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**VENDOSI:**

I. Afati i veprimtarisë së komisionit hetimor të Kuvendit “Për hetimin e veprimtarisë së institucioneve shetërore për zbulimin, identifikimin, përballimin, neutralizimin, pengimin dhe ndëshkimin e veprimit të organizuar kriminal për dhunimin e institucioneve dhe përmbysjen e rendit kushtetues në datën 21 janar 2011”, të ngritur me vendimin e Kuvendit nr.82, datë 23.1.2011, zgjatet për një periudhë 12-mujore, duke filluar nga data e miratimit të këtij vendimi.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARE**  
**Jozefina Topalli (Çoba)**

**VENDIM**  
**Nr.146, datë 15.12.2011**

**PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN E KUVENDIT NR.3, DATË 16.9.2009 “PËR CAKTIMIN E PËRBËRJES SË KOMISIONEVE TË PËRHERSHME TË KUVENDIT”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 78 pika 1 të Kushtetutës, të neneve 55 pika 1 dhe 21 pika 1 dhe 2, të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Konferencës së Kryetarëve, pas marrëveshjes së Kryetares së Kuvendit me Kryetarin e Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste,

**KUVENDI**  
**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**VENDOSI:**

Në vendimin e Kuvendit nr.3, datë 16.9.2009 “Për caktimin e përbërjes së komisioneve të përherëshme të Kuvendit”, të ndryshuar, bëhet kjo shtesë:

I. Deputeti Anduel Xhindi caktohet anëtar në Komisionin për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE  
Jozefina Topalli (Çoba)

**VENDIM**  
**Nr.3, datë 24.1.2011**

**NË EMËR TË REPUBLIKËS**

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, të përbëra nga:

Shpresa Beçaj	Kryesuese
Ardian Dvorani	anëtar
Gani Dizdari	anëtar
Besnik Imeraj	anëtar
Fatos Lulo	anëtar
Ardian Nuni	anëtar
Aleksandër Muskaj	anëtar
Andi Çeliku	anëtar
Arjana Fullani	anëtare
Evelina Qirjako	anëtare
Guxim Zenelaj	anëtar
Majlinda Andrea	anëtare
Mirela Fana	anëtare
Medi Bici	anëtar,

në seancën gjyqësore të datës 17.1.2011 dhe 24.1.2011 morën në shqyrtim çështjen penale nr.8 akti, që u përket:

**I PANDEHUR:** Shezai Gega, i biri i Musait dhe Sybasë, datëlindja 18.2.1970, lindur dhe banues në fshatin Pobrat të qarkut Berat, i padënuar, i martuar me dy fëmijë, hetuar dhe gjykuar me masë sigurimi “arrest në burg”.

**AKUZUAR:** Për kryerjen e veprës penale të “Trafikimit të narkotikëve mbetur në tentativë”, parashikuar nga nenet 283/a e 22 të Kodit Penal.

**Gjykata për Krimet e Rënda Tiranë, me vendimin nr.10, datë 11.2.2009, ka vendosur:**

*Deklarimin fajtor të të pandehurit Shezai Gega, për veprën penale të “Trafikimit të narkotikëve”, veprë kjo e parashikuar nga neni 283/a i Kodit Penal dhe dënimin e tij me 9 (nëntë) vjet burgim.*

*Në aplikim të nenit 406, dënimin e tij përfundimisht me 6 (gjashtë) vjet burgim.*

*Vuajtja e dënimit të të pandehurit Shezai Gega fillon nga dita e arrestimit të tij datë 1.2.2008, vuajtje e cila do të kryhet në një burg të sigurisë së zakonshme.*

*Konfiskimin e sendeve të sekuestruara, si më poshtë:*

*Një aparat celular model “Samsung” tipi SGH E 700, me numër imei 35312900072696/8, së bashku me kartën AMC me numër serie 1070125085535.*

*Një aparat celular model “Samsung” tipi SGH E 700, me numër imei 353254301415369/9, së bashku me kartën Vodafon me numër serie 863550200002170703013 – kartë Vodafon, me numër serie 89355020000218707618014.*



*Një aparat celular tip "NOKIA", me numër imei 352746010635847 me kartën AMC, me numër serie 89355010604203688923.*

*Automjeti tip kamion i markës "VOLVO", me targë BR 1852 B, me kabinë me ngjyrë të zezë me rimorkio me mushama me ngjyrë të verdhë.*

*Kthimin e sendeve të sekuestruara, si më poshtë:*

*Dëshmi aftësie nr.931453 në emër të Shezai Gegës.*

*Një fletore shkrimi e grisur në anësore në formë të çrregullt me emra telefoni.*

*Një faturë llogarie e një lokali.*

*Një copë fletë, ku ka të shënuar një numër telefoni 0692820348.*

*Një copë fletë me ngjyrë të verdhë, ku është shënuar CEKU 24x4=96 dhe poshtë saj emri*

*Gori.*

*Një sasi prej 20 000 lekësh të reja të prerjeve 3x5000 dhe 5x1000.*

*Sasia prej 60 eurosh, me prerje 2x20 dhe 2x10, sasia prej 2500 lekësh të reja, me prerje 1x1000 dhe 3x500.*

*Leje qarkullimi me nr.BR 0001221 për automjetin me targa BR 1852 B në emër të shtetasit Shezai Gega.*

*Leje qarkullimi ndërkombëtare me nr.0092681 në emër të shtetasit Shezai Gega.*

*Taksë vjetore e qarkullimit rrugor, lëshuar më datë 3.10.2007.*

*Taksë e regjistrimit të përvitshëm të mjeteve të transportit rrugor lëshuar më datë 3.10.2007.*

*Katër mandate arkëtimi në emër të shtetasit Shezai Gega të DPSHTR (dy me ngjyrë të verdhë dhe dy me ngjyrë blu).*

*Certifikatë me numër 221, datë 11.11.2005 "Për transport mallrash brenda vendit për llogari të vet", lëshuar nga komuna Kutalli në emër të shtetasit Shezai Gega.*

*Tri mandate peshimi me numër serie 0078171 dhe 0047791.*

*Dokument në gjuhën greke për automjetin me targë BR 1852 B me nr.1101.*

*Policë sigurimi e detyrueshme e mjeteve motorike me nr.serie 0354780 dhe nr.976, datë 3.10.2007.*

*Certifikatë ndërkombëtare e sigurimit motorik me nr.AL 020000942976.*

*Asgjësimi i lëndës narkotike të llojit cannabis sativa në peshë 160 kilogram.*

**Gjykata e Apelit për Krimet e Rënda Tiranë, me vendimin nr.19, datë 25.3.2009, ka vendosur:**

*Ndryshimin e vendimit nr.10, datë 11.2.2009 të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë, si më poshtë:*

*Deklarimin fajtor të të pandehurit Shezai Gega për veprën penale parashikuar nga neni 283/a paragrafi i parë i Kodit Penal dhe dënimin e tij me 8 (tetë) vjet burgim.*

*Në zbatim të nenit 406 të Kodit të Procedurës Penale, dënimin e tij me 5 (pesë) vjet e 4 (katër) muaj burgim.*

*Lënien në fuqi të vendimit për pjesët e tjera të tij.*

Kundër vendimit të Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda Tiranë ka ushtruar rekurs i pandehuri Shezai Gega nëpërmjet përfaqësuesit të tij, avokatit Qazim Gjonaj, i cili kërkon ndryshimin e vendimit të Gjykatës së Apelit për Krimet e Rënda Tiranë, duke u deklaruar fajtor për veprën penale të parashikuar nga neni 283/a/1 e 22 i Kodit Penal. Në thelb, në rekurs parashitrohen këto shkaqe:

- Kundërshtoj vendimin e mësipërm të Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda, vetëm për sa i përket cilësimit ligjor të veprës penale. Gjykatat kanë gabuar në lidhje me cilësimin ligjor të veprës sipas nenit 283/a/1 të Kodit Penal, në një kohë që i pandehuri Gega është akuzuar për veprën penale



të trafikimit të lëndës narkotike të mbetur në tentativë 283/a/1 e 22 të Kodit Penal. Ai nuk mund të përgjigjet për veprën penale të kryer, pasi nuk ka kaluar kufirin.

- Pronësia e kamionit është vërtetuar që është e të pandehurit, por pronësia e lëndës narkotike nuk është zbuluar akoma.

- Kamioni në fjalë i është dorëzuar shoferit Agron Rrushi, për të cilin është vendosur mosfillimi i procedimit penal. Dorëzimi është bërë prej datës 30.1.2008 dhe nga ajo kohë i pandehuri Gega nuk ka pasur kontakt me shoferin. Edhe para marrjes në dorëzim të kamionit nga shoferi Agron Rrushi ka qenë në pikë ruajtje në qytetin e Sarandës.

- Në një nga pakot që janë gjetur në makinë kanë dalë gjurmë të një personi që i pandehuri nuk e ka njohur më parë dhe është dërguar për gjykim në gjykatën e rrethit për veprën penale të mbajtjes së lëndës narkotike.

**Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin e datës 27.10.2010, ka vendosur:**

*Kalimin e çështjes në Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë me qëllim njësimin e praktikës gjyqësore, lidhur me fazën e tentativës në veprën penale të parashikuar nga neni 283/a të Kodit Penal.*

Me këtë vendim Kolegji Penal shtron për diskutim çështjet, si më poshtë:

1. Nëse lënda narkotike e ardhur nga një shtet dhe e destinuar për një shtet tjetër i kapet autorit brenda territorit të shtetit shqiptar, a do e bëjë veprën të kualifikuar si trafikim të kryer apo të mbetur në fazën e tentativës?

2. Nisur nga përmbajtja e dispozitës së nenit 283/a të Kodit Penal, sipas të cilit forma të kryerjes së kësaj vepre janë : “ importimi, eksportimi, transitimi dhe tregtimi në kundërshtim me ligjin të substancave narkotike e ...”, cila do të jetë faza e tentativës në kryerjen e kësaj vepre penale në rastin e transitimit, ndërkohë që vepra penale konsiderohet e kryer edhe vetëm duke e importuar, eksportuar apo tregtuar?

**KOLEGJET E BASHKUARA TË GJYKATËS SË LARTË,**

pasi dëgjuan relatimin e çështjes nga gjyqtarët Ardian Dvorani dhe Aleksandër Muskaj; prokurorin Bujar Sheshi, i cili për zbatim të drejtë të ligjit kërkoi të pranohet rekursi i të gjykuarit dhe mbrojtësit, duke ndryshuar vendimet e dhëna nga të dyja gjykatat, duke e cilësuar veprën penale të kryer nga i pandehuri Gega të mbetur në fazën e tentativës sipas neneve 283/a, paragrafi i parë e 22 të Kodit Penal, duke e lënë në fuqi vendimin e gjykatës së apelit për pjesët e tjera; dhe pasi shqyrtuan dhe analizuan në tërësi çështjen,

**VËREJNË:**

**I. Rrethanat e faktit**

1. Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, nga aktet e dosjes gjyqësore dhe vendimet e dhëna nga dy gjykatat më të ulëta, u rezultojnë të pranuarat prej tyre rrethanat, si vijon:

Prokurori për Krime të Rënda Tiranë ka filluar procedimin penal në ngarkim të të pandehurit Shezai Gega, duke e akuzuar për veprën penale të “Trafikimit të narkotikëve”, e mbetur në tentativë, vepër kjo e parashikuar nga nenet 283/a e 22 të Kodit Penal.

Më datë 31.1.2008, rreth orës 07:30 të mëngjesit, në pikën kufitare të Kakavijës, gjatë një kontrolli të ushtruar në kamionin tip “Volvo” me targë BR 1852 B, janë gjetur dhe sekuestruar me cilësinë e provës materiale 131 pako të mbështjella me natriban, në brendësi të të cilave dyshohej se kishte lëndë narkotike. Në kushtet e mësipërme është bërë arrestimi në flagrancë i drejtuesit të automjetit, shtetasit Agron Rrushi, si dhe kanë filluar kërkimet për pronarin e kamionit me targë BR 1852 B, pra për shtetasin Shezai Gega.



Është filluar procedimi penal për të dy shtetasit e mësipërm, por për shtetasin Agron Rrushi (shofer i kamionit) është vendosur pushimi i procedimit penal, pasi nuk është provuar që ky të jetë marrë me transportimin e kësaj ngarkese.

Procedimi ka filluar për pronarin e automjetit, Shezai Gega, pasi ky dyshohet që është autori i kryerjes së veprës penale të mësipërme, të mbetur në tentativë.

2. Çështja është gjykuar me procedurën e gjykimit të shkurtuar dhe rrethanat e kryerjes së veprës pranohen njësoj si nga organi i akuzës, ashtu edhe nga gjykatat.

Por, ndërsa i pandehuri është dërguar për gjykim me akuzën e veprës penale të parashikuar nga nenet 283/a dhe 22 të Kodit Penal, pra vepra e mbetur në fazën e tentativës, Gjykata për Krimet e Rënda Tiranë, me vendimin nr.10, datë 11.2.2009, ka vendosur deklarinim fajtor të të pandehurit Shezai Gega, për veprën penale të “Trafikimit të narkotikëve”, vepër kjo e parashikuar nga neni 283/a i Kodit Penal, duke e konsideruar atë të kryer plotësisht dhe duke u dënuar për veprën penale të parashikuar nga neni 283/a/1 i Kodit Penal.

3. E vënë në lëvizje mbi ankimin e të gjykuarit Gega, Gjykata e Apelit për Krime të Rënda ka mbajtur të njëjtin qëndrim lidhur me kryerjen e veprës penale, duke e ndryshuar vendimin e gjykatës së shkallës së parë vetëm për sa i përket masës së dënimit të dhënë ndaj të pandehurit Shezai Gega.

4. Kundër vendimit të Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda Tiranë ka ushtruar rekurs i pandehuri Shezai Gega, i cili kërkon ndryshimin e vendimit të Gjykatës së Apelit për Krimet e Rënda Tiranë, duke u deklaruar fajtor për veprën penale të mbetur në fazën e tentativës, sikurse parashikohet nga nenet 283/a, paragrafi i parë dhe 22 të Kodit Penal.

5. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin e datës 27.10.2010, ka vendosur të kalojë çështjen në Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, për njësimin dhe unifikimin e praktikës gjyqësore. Në mënyrë të përmbledhur, Kolegji Penal ka marrë këtë vendim dhe ka parashtruar për diskutim çështjet për unifikim duke pasur parasysh se, ndonëse çështja është gjykuar me procedurën e gjykimit të shkurtuar dhe rrethanat e kryerjes së veprës pranohen njësoj si nga organi i akuzës, dhe gjykatat, i pandehuri është dërguar për gjykim me akuzën e veprës penale të parashikuar nga nenet 283/a dhe 22 të Kodit Penal, pra vepra e mbetur në fazën e tentativës, ndërsa prej të dyja gjykatave është konsideruar e kryer plotësisht, duke u dënuar për veprën penale të parashikuar nga neni 283/a/1 i Kodit Penal.

Në praktikën gjyqësore të gjykatave, por edhe të vetë Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë vërehen qëndrime të ndryshme, madje edhe të kundërta, për sa i përket cilësimit ligjor të veprës penale të trafikimit të lëndëve narkotike, veçanërisht rreth konsumimit apo mbetjes në tentativë të kësaj vepre penale. Këto qëndrime e kanë sjellë Kolegjin Penal në përfundimin se çështja duhet të kalojë për shqyrtim në Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, me qëllim njësimin e praktikës gjyqësore, duke i parashtruar dy çështjet e sipërpërmendura për unifikim.

## II. Arsytimi i Kolegjeve të Bashkuara

6. Kolegjet e Bashkuara, nga shqyrtimi i rekursit të paraqitur nga i pandehuri Shezai Gega dhe mbrojtësi i tij, vërejnë se, në thelb, përveç pretendimeve të tjera për vlerësim të gabuar nga gjykatat të provave lidhur me rrethanat e çështjes, parashtrohet se gjykatat më të ulëta kanë zbatuar gabim ligjin penal material vetëm për sa i përket cilësimit ligjor të veprës penale sipas nenit 283/a, paragrafi i parë të Kodit Penal, për shkak se ai është akuzuar dhe duhet të përgjigjet, për veprën penale të trafikimit të lëndës narkotike të mbetur në tentativë 283/a, paragrafi i parë dhe 22 të Kodit Penal. Ai nuk mund të përgjigjet për veprën penale të kryer, pasi nuk ka kaluar kufirin.

7. Nga ana tjetër, përfaqësuesi i Prokurorisë së Përgjithshme, në thelb, parashtrroi përpara Kolegjeve të Bashkuara se të gjitha format e trafikimit të narkotikëve kanë fazën e tyre të tentativës. Për të përcaktuar nëse vepra është konsumuar apo ka mbetur në fazën e tentativës, ka shumë rëndësi

qëllimi i autorit apo i autorëve të veprës penale, si dhe momenti dhe vendi i kapjes së narkotikëve.

Nëse provohet se lënda narkotike nuk është prodhuar në vend për t'u eksportuar jashtë, apo nuk është importuar për t'u përdorur në tregun e brendshëm vepra cilësohet si transitim. Nëse lënda narkotike kapet në çastin e hyrjes në kufirin shtetëror, vepra cilësohet si e mbetur në tentativë. Nëse kapet në brendësi të territorit kemi të bëjmë me transitim të konsumuar plotësisht.

8. Nisur nga parashtrimi i mësipërm i rrethanave të faktit dhe i qëndrimeve të palëve në gjykim, për t'u dhënë përgjigje çështjeve të parashtruara për njësimin e praktikës gjyqësore, gjithmonë në funksion të zgjidhjes së çështjes objekt gjykimi dhe në përgjigje të pretendimeve të parashtruara në rekursin e të gjykuarit për zbatim të gabuar të ligjit penal material nga ana e gjykatave, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë vlerësojnë se duhet të mbahen parasysh kuptimi e zbatimi i dispozitave të Kodit Penal lidhur me tentativën (neni 22) dhe ajo mbi trafikimin e narkotikëve (neni 283/a).

9. Kështu, në dispozitën e nenit 22 parashikohet se:

*“Neni 22*

**Kuptimi i tentativës**

*Vepra penale quhet e mbetur në tentativë kur, megjithëse personi ndërmerr veprime të drejtpërdrejta për ta kryer atë, vepra ndërpritet e nuk përfundohet për rrethana të pavarura nga vullneti i tij.”*

Në interpretim të drejtë të kësaj dispozite, në thelb, në rastin e tentativës, megjithëse personi ndërmerr veprime të drejtpërdrejta për të kryer veprën penale, ajo ndërpritet dhe nuk përfundohet për rrethana të pavarura nga vullneti i tij.

Pra, në dallim nga përgatitja, e cila lidhet me krijimin e kushteve dhe mjeteve materiale për kryerjen e veprës penale, si fillim i materializimit të mendimit kriminal dhe vënies në lëvizje për kryerjen e veprimeve nga autori, në rastin e tentativës jemi përpara kryerjes së veprimeve nga ana e personit, të cilat, për vetë mjetet, mënyrat dhe kohën kur realizohen, synojnë dhe kontribuojnë drejtpërdrejt në drejtim të shkaktimit të pasojave të dëshiruara të veprës penale, pra duke e sjellë atë shumë afër ardhjes së pasojës kriminale të dëshiruar nga autori.

10. Nga ana tjetër, në dispozitën e nenit 283/a të Kodit Penal parashikohet se:

*“Neni 283/a*

**Trafikimi i narkotikëve**

*Importimi, eksportimi, transitimi dhe tregtimi, në kundërshtim me ligjin, i substancave narkotike ose psikotrope, si edhe i farërave të bimëve narkotike, dënohet me burgim nga shtatë gjer në pesëmbëdhjetë vjet.*

*Po kjo vepër, kur kryhet në bashkëpunim ose më shumë se një herë, dënohet me burgim nga dhjetë gjer në njëzet vjet.*

*Organizimi, drejtimi ose financimi i kësaj veprimtarie dënohen me burgim jo më pak se pesëmbëdhjetë vjet.”*

11. Kolegjet e Bashkuara, duke vërejtur se ka qëndrime të ndryshme, madje edhe të kundërta në praktikën tonë gjyqësore, për sa i përket figurës së veprës penale të trafikimit të narkotikëve, për rrjedhojë të kësaj edhe lidhur me përfundimin nëse vepra është kryer apo ka mbetur në tentativë, vlerësojnë të parashtrojnë disa aspekte të interpretimit të drejtë të dispozitës së nenit 283/a të Kodit Penal *“Trafikimi i narkotikëve”*.



Legjislacioni ynë penal, nëpërmjet kësaj vepre penale, synon mbrojtjen e posaçme të marrëdhënieve juridike të vendosura për të siguruar kontrollin dhe rendin në veprimtaritë e importimit, eksportimit, transitimit dhe tregtimit ndërkombëtar të narkotikëve, kundër veprimeve e mosveprimeve kriminale.

Po kështu, me anë të kësaj dispozite, në harmoni e plotësim reciprok me dispozita të tjera penale, ligjvënësi synon edhe mbrojtjen e marrëdhënieve juridike të vendosura për garantimin e jetës, shëndetit, familjes dhe të drejtave të tjera e objektivave sociale në një shoqëri demokratike. Kjo veprimtari kriminale, nëpërmjet nxitjes, sigurimit të burimeve dhe të rrjeteve të përhapjes së përdorimit të paligjshëm, abuziv, të lëndëve narkotike e psikotrope, si në nivel kombëtar edhe ndërkombëtar, ka një ndikim negativ vendimtar, veç të tjerave jo vetëm në dëmtimin e shëndetit dhe krijimin e varësisë së përdoruesve nga këto lëndë, por edhe në dëmtimin e shëndetit e të pasurisë, pra të cilësisë së jetës personale e familjare dhe zhvillimin normal të shoqërisë, veçanërisht të brezit të ri.

12. Kjo vepër penale kryhet me dashje, me anë të veprimeve a mosveprimeve të kundërligjshme. Sipas rastit, ajo kryhet për motive, apo edhe me qëllime nga më të ndryshmet, të fokusuara veçanërisht tek ato që lidhen me përfitimin material.

13. Në nenin 283/a të Kodit Penal, në mënyrë të shprehur qartë parashikohet se janë të dënueshme penalisht importimi, eksportimi, transitimi dhe tregtimi, në kundërshtim me ligjin, i substancave narkotike dhe lëndëve psikotrope.

Legjislacioni ynë përmban rregullime të posaçme për sa i përket çdo lloj veprimtarie që lidhet me substancat narkotike dhe lëndët psikotrope. Ndërmjet të tjerave, mund të evidentohen ligji nr.7975, datë 26.7.1995 “Për barnat narkotike dhe lëndët psikotrope” (i ndryshuar) dhe ligji nr.8874, datë 29.3.2002 “Për kontrollin e lëndëve që përdoren për fabrikimin e paligjshëm të lëndëve narkotike dhe psikotrope”.

Këto ligje, si dhe aktet nënligjore të nxjerra në bazë e për zbatim të tyre, parashikojnë rregulla të qarta për kushtet, kriteret dhe procedurat, teknike e ligjore, për lejimin, autorizimin dhe disiplinimin e veprimtarive për prodhimin, fabrikimin, tregtimin, shpërndarjen me shumicë dhe pakicë, transportimin, furnizimin, dhënien kundrejt pagesës ose falas, blerjen, importimin, eksportimin, kalimin transit, vënien në përdorim e mbajtjen për qëllime mjekësore, studimore e shkencore ose për qëllime të tjera industriale apo në të tjera veprimtari, të atyre substancave narkotike dhe lëndëve psikotrope që nuk janë të ndaluara për t’u qarkulluar. Këto veprimtari mund të ushtrohen vetëm nga subjekte të autorizuara posaçërisht për këtë qëllim sipas ligjit nga autoritetet kompetente.

14. Veprimtaria kriminale e trafikimit të narkotikëve sipas nenit 283/a të Kodit Penal synon pikërisht të realizojë përfitime, duke vënë në qarkullim e tregtim ndërkombëtar lëndë narkotike e psikotrope, qarkullimi i të cilave është i ndaluar me ligj apo duke tregtuar pa autorizim të posaçëm lëndë të tilla edhe pse ato lejohen të qarkullohen apo duke shkelur me dashje kushtet e autorizimit dhe rregullat e vënies në qarkullim e tregtim të këtyre lëndëve narkotike e psikotrope.

Prandaj, në kuptim të nenit 283/a, ashtu sikurse në rastin e nenit 283 të Kodit Penal, me shprehjen “në kundërshtim me ligjin”, përfshihet pikësepari kryerja e veprimeve a veprimtarive me substanca narkotike e psikotrope nga ato që janë të ndaluara me ligj për t’u vënë në qarkullim. Së dyti, kryerja e veprimeve e veprimtarive me substanca të tilla të lejueshme për qarkullim, por për qëllime jashtë atyre të parashikuara e të lejuara nga ligji. Së treti, kryerja e veprimtarive me substanca të tilla të lejueshme për qarkullim, por pa qenë i pajisur me autorizimet përkatëse apo në shkelje e kapërcim të kushteve të parashikuara në autorizim, të cilat kualifikohen si veprime a mosveprime të atilla që përbëjnë vepër penale e jo më shkelje administrative.

15. Nisur nga parashtrimi i mësipërm, subjekt i krimeve të parashikuara nga nenet 283 dhe 283/a të Kodit Penal mund të jetë çdo person fizik a juridik. Pra, subjekt mund të jetë çdo person, i cili nuk është i pajisur me autorizim apo edhe nëse është i pajisur me autorizim, kur ai kryen veprime e veprimtari të kundërligjshme lidhur me substancat narkotike e psikotrope, substanca e veprime, të cilat, janë të ndaluara, të ndryshme apo në kapërcim të qëllimeve, kushteve e procedurave që parashikon ligji lidhur me to, si dhe të atyre që përmbahen në autorizimin e posaçëm të lëshuar nga organi kompetent.

16. Sikurse në rastin e nenit 283, ashtu edhe në nenin 283/a, kriter i përbashkët për kryerjen e veprës penale të trafikimit të narkotikëve, të konsumuar apo të mbetur në tentativë, pavarësisht nga mënyra e forma e kryerjes së veprës, është *kriteri i mbajtjes* së substancës narkotike e psikotrope, kriter ky që ka të bëjë me kontaktin e subjektit me këtë substancë apo kapacitetin e tij për të kryer, drejtpërdrejt apo në bashkëpunim me të tjerë, veprime nga më të ndryshmet në lidhje me këtë substancë deri edhe në disponimin e saj në raport me të tretët.

17. Por vepra penale e parashikuar nga neni 283/a, në të katër format bazë të kryerjes së saj, dallohet nga ajo e parashikuar nga neni 283 i Kodit Penal. Në thelb, veçanti e legjislacionit tonë penal, është se ky dallim lidhet pikërisht me natyrën transnacionale të kryerjes së veprës penale të trafikimit të narkotikëve sipas dispozitës së nenit 283/a të Kodit Penal.

18. Termi juridik i “trafikimit” njihet dhe përdoret tashmë gjerësisht nga akte të së drejtës ndërkombëtare dhe legjislacione të vendeve të ndryshme. Në mënyrë të përgjithshme, në fushën e së drejtës, me *trafikim* është kuptuar veprimtaria a tregtimi, kombëtar ose ndërkombëtar, i paligjshëm, i mallrave dhe shërbimeve.

Bazuar në traditën dhe përvojën e mëparshme, por edhe në dispozitat e Konventës së Palermos, si dhe të disa akteve të tjera ndërkombëtare, në legjislacionin tonë penal, janë parashikuar, ndryshuar e plotësuar një numër veprash penale lidhur me vënien në qarkullim e tregtimin e paligjshëm kombëtar e ndërkombëtar dhe, në tërësi, për veprimtaritë e paligjshme me persona, si dhe mallra e shërbime të caktuara, si në rastin kur kjo veprimtari kriminale synon apo realizohet vetëm në territorin shqiptar, ashtu edhe kur kjo veprimtari shtrihet apo intereson edhe shtete të tjera.

19. Kështu, ligjvënësi, për rastet kur vepra ka karakter transnacional, ka përdorur në Kodin tonë Penal termin e përgjithshëm “trafikim” për titullimin e veprës (nenet 110/a, 114/b, 128/b, 138/a, 141/a, 278/a, 282/a dhe 283/a).

Sipas legjislacionit tonë penal, pavarësisht nga personat e llojet e mallrave që trafikohen dhe origjinën e tyre, në thelb, trafikimi nënkupton rastet kur veprimtaria e kundërligjshme, duke përfshirë Shqipërinë e territorin e saj, kryhet në më shumë se një shtet, kryhet në një shtet, por është përgatitur, programuar, drejtuar e kontrolluar në një shtet tjetër, kryhet në një shtet, por ka efekte e pasoja thelbësore në një shtet tjetër.

Prandaj, Kolegjet e Bashkuara vijnë në përfundimin se ***kriter bazë për kuptimin e zbatimin e drejtë të veprave penale të “trafikimit” sipas Kodit tonë Penal është parimi i territorit, i prekjes e përdorimit të tij, me qëllimin e realizimit në rrugë kriminale të përfutimeve, përmes hyrjes ose daljes së paligjshme të personave apo sendeve nga territori shqiptar ose kalimit të paligjshëm të tyre nëpërmjet territorit shqiptar.***

Sikurse në përgjithësi, edhe për efekte të zbatimit të dispozitës së nenit 283/a të Kodit Penal, zonat e transitit në stacionet, portet dhe aeroportet ndërkombëtare të vendit, janë pjesë e territorit shqiptar.

20. Në këtë kuptim, edhe në rastin e mallrave e shërbimeve të lidhura me substancat narkotike e psikotrope, dispozitat penale bazë janë nenet 283 dhe 283/a të Kodit Penal.

Në thelb, neni 283 mbulon rastet kur kjo veprimtari e paligjshme synon, realizohet dhe intereson vetëm territorin shqiptar. Ndërsa neni 283/a mbulon rastet kur veprimtaria dhe pasojat e



saj kanë karakter transnacional. Pra, të gjitha situatat e mundshme të kryerjes së veprimtarisë kriminale me narkotikë e substanca psikotrope, në varësi të rrethanave të faktit që rezultojnë rast pas rasti, janë të mbuluara nga dispozitat e neneve 283, 283/a e vijuese të Kodit Penal.

21. Vepra penale e trafikimit të narkotikëve kryhet qoftë edhe në njërin nga mënyrat e parashikuara nga neni 283/a i Kodit Penal, pra në ato të importimit, eksportimit, transitimit apo të tregtimit.

22. Në kuptim të paragrafit të dytë të nenit 283/a, nëse është kryer nga dy ose më shumë persona dhe pavarësisht nga forma e bashkëpunimit, bashkëpunëtorët përgjigjen për veprën penale të trafikimit të narkotikëve. Por në vendimin e dënimit duhet të individualizohet për secilin bashkëpunëtor mënyra e kryerjes së veprës penale. Në varësi të rrethanave konkrete të çështjes, jo domosdoshmërisht të gjithë bashkëpunëtorët përgjigjen për të njëjtën mënyrë të kryerjes së kësaj vepre penale. Sjelljet e autorit apo të bashkëpunëtorëve në kryerjen e kësaj vepre në raport me substancën narkotike e psikotrope janë alternative dhe autonome.

23. Sikurse parashtrohet më sipër në këtë vendim, dispozita e nenit 283/a të Kodit Penal, ndonëse parashikon katër mënyra të kryerjes së veprës penale të trafikimit të narkotikëve, ajo në thelb është veprimtari, tregtim i paligjshëm ndërkombëtar i substancave narkotike e psikotrope.

24. Por, përcaktimi konkret i mënyrës së kryerjes së kësaj vepre penale, veç të tjerave, është thelbësor si për të vlerësuar e disponuar nëse jemi përpara veprës penale të kryer apo të mbetur në tentativë, ashtu edhe për individualizimin e dënimit për autorin apo secilin bashkëpunëtor.

Pra, duke zbërthyer në dispozitën e nenit 283/a mënyrat bazë (ana objektive) të kryerjes së kësaj vepre penale, ligjvënësi synon jo vetëm të qartësojë vullnetin e tij mbi nocionin juridik të kësaj veprimtarie kriminale, se për çfarë është e dënueshme penalisht, por edhe që t'i mundësojë subjekteve të procedimit penal që të ushtrojnë të drejtat e detyrimit e tyre në të gjitha fazat dhe aspektet e këtij procedimi, duke përfshirë edhe debatin e vendimmarrjen mbi quajtën të kryer apo të mbetur në tentativë të kësaj vepre penale.

25. Përpara se të parashtrohet kuptimin e secilës mënyrë bazë të veprës penale të trafikimit të narkotikëve sipas nenit 283/a (importimi, eksportimi, transitimi dhe tregtimi), duke qenë njëkohësisht mënyra të zakonshme e të njohura të veprimtarisë së tregtisë ndërkombëtare, Kolegjet e Bashkuara çmojnë që të evidentojnë më parë disa aspekte që lidhen me thelbin e kuptimit ekonomik e tregtar të këtyre veprimeve e veprimtarive.

26. Kështu, *tregtimi* është veprimtaria e vënies në qarkullim ekonomik e tregtar, nëpërmjet shitjes, blerjes, shkëmbimit, dhënies e marrjes, në çdo mënyrë e formë tjetër, të mallrave dhe shërbimeve për qëllime ekonomike e tregtare.

*Importimi* është veprimtaria e sjelljes së mallrave dhe shërbimeve nga një shtet tjetër, kryesisht për qëllime ekonomike dhe tregtare.

*Eksportimi* është veprimtaria e dërgimit të mallrave dhe shërbimeve në një shtet tjetër, kryesisht për qëllime ekonomike dhe tregtare.

Importimi dhe eksportimi janë edhe dy nga mënyrat e *tregtimit ndërkombëtar* të mallrave dhe shërbimeve.

27. Ndërsa, *transitimi* është veprimtaria e mbartjes, lëvizjes, shoqërimit dhe transportimit të qenieve të gjalla dhe sendeve (p.sh. mallrave) nga një vend në një vend tjetër, një mënyrë a segment i transportimit të tyre, me veçantinë se, gjatë transitimit, këto qenie e sende qëndrojnë përkohësisht apo kalojnë nëpërmjet vendeve të tjera të ndryshme nga ai i nisjes dhe mbërritjes së synuar.

Pra, transitimi është një mënyrë e kryerjes së veprimtarisë së transportimit a transportit nga pika e nisjes drejt destinacionit të synuar, që realizohet e shtrihet në një pjesë a segment të ndërmjetëm të kësaj veprimtarie.

28. Edhe dispozita e nenit 283/a të Kodit Penal, për sa i përket anës objektive të kryerjes së saj, parashikon dhe përfshin të gjitha veprimet e mosveprimeve për arritjen e qëllimit, rezultatit kriminal, pikërisht duke i përfshirë të gjitha mënyrat e realizimit të veprimeve dhe veprimtarive të njohura e të lidhura me tregtimin e qarkullimin ndërkombëtar të mallrave, posaçërisht të substancave narkotike, psikotrope dhe të farërave të bimëve narkotike. Kjo dispozitë eidenton si mënyra të posaçme *importimin, eksportimin e transitimin*, duke përfshirë në termin “*tregtim*” të gjitha mënyrat e tjera të mundshme të tregtimit e qarkullimit ndërkombëtar të mallrave, posaçërisht të narkotikëve.

Veprimin kriminal dhe mënyrat e kryerjes së tij, i lidh me zbatimin e nenit 283/a të Kodit Penal pikërisht realizimi i tyre nga subjektet e veprës penale duke vepruar, me dashje dhe *në kundërshtim me ligjin*, përderisa lëndët narkotike i nënshtrohen një regjimi juridik ndalimi apo kufizimesh për vënien në qarkullim të tyre, regjim i cili kufizon dhe disiplinon posaçërisht edhe rrethin e subjekteve që autorizohen për këtë qëllim.

29. Subjekti i veprës penale të parashikuar nga neni 283/a, me dashje, kryen veprime a mosveprime që janë të kundërligjshme, duke parashikuar ardhjen e pasojave të kësaj vepre penale. Pasoja e kësaj vepre penale lidhet me cenimin e marrëdhënieve juridiko-penale të posaçme të vendosura në drejtim të qarkullimit të lëndëve narkotike dhe, posaçërisht, të regjimit të qarkullimit të tyre: a) nga territori i shteteve të tjera me destinacion të fundit territorin shqiptar; ose b) nga territori shqiptar me destinacion territorin e një shteti tjetër; si edhe c) nëpërmjet zhvendosjes e transportimit të tyre nga territori i shteteve të tjera, nëpërmjet territorit shqiptar, drejt territorit të shteteve të tjera.

Prandaj, edhe pasoja të kësaj vepre penale të cilat sjellin përgjegjësi penale, vijnë pikërisht me kryerjen me dashje të veprimeve a mosveprimeve për hyrjen e lëndëve narkotike në territorin shqiptar ose daljen prej këtij territori, pavarësisht nëse kanë ardhur të gjitha pasojat e dëshiruara nga subjektet e veprës penale, nëse ata kanë realizuar apo jo të gjitha motivet dhe qëllimet për kryerjen e veprës, sikurse janë padyshim mbërritja e lëndës narkotike në destinacionin, te personat e synuar brenda apo jashtë vendit, pas kalimit të saj nëpërmjet kufirit tonë shtetëror.

30. Në vijim dhe bazuar në parashtrimin e mësipërm të elementeve thelbësore të lidhura me subjektin, anën subjektive, anën objektive dhe objektin e veprës penale të parashikuar nga dispozita e nenit 283/a të Kodit Penal, Kolegjet e Bashkuara vlerësojnë se është vendi për të parashtruar edhe thelbin e kuptimit të mënyrave të kryerjes së kësaj vepre penale.

31. *Importimi*, në kundërshtim me ligjin, i substancave narkotike ose psikotrope, si edhe i farërave të bimëve narkotike, është mënyrë e realizimit të veprimit kriminal të parashikuar nga neni 283/a i Kodit Penal, me të cilën, persona fizikë a juridikë, të pajisur ose jo me autorizim të posaçëm sipas ligjit nga autoritetet shqiptare, *në mënyrë të kundërligjshme dhe me dashje*, duke përdorur çfarëdo mjeti a forme veprimi a mosveprimi, i sjellin këto lëndë nga territori i një shteti tjetër në territorin shqiptar, me synimin për t'i vënë në qarkullim në territorin shqiptar.

Për kualifikimin e veprimit kriminal si “trafikim i narkotikëve” në mënyrën e importimit, sipas nenit 283/a të Kodit Penal, ka rëndësi të vërtetohet kryerja e veprimeve a mosveprimeve, konkrete, me dashje, të lidhura me arritjen e rezultatit të mendimit kriminal, pikërisht të *qëllimit për ta sjellë (importuar) lëndën narkotike, në mënyrë të kundërligjshme, nga një shtet tjetër në Shqipëri*, pavarësisht nëse kanë ardhur të gjitha pasojat, nëse është arritur rezultati kriminal. Po kështu, nuk ka rëndësi për kualifikimin e kësaj vepre penale se cili ishte synimi i mëtejshëm i autorëve të veprës pas hyrjes së lëndës narkotike në territorin shqiptar, pra forma e natyra e parashikuar prej tyre për të përfituar dhe gjithësesi për vënien në qarkullim të saj pas realizimit të importimit.

Nuk ka rëndësi për kualifikimin e veprës as natyra e veprimeve e mosveprimeve apo forma e pjesëmarrjes në kryerjen e veprimit kriminal të importimit të lëndës narkotike, përderisa këto elemente të anës objektive të kryerjes së kimit të trafikimit të narkotikëve (neni 283/a) janë alternative dhe autonome. Mjafton që veprimi kriminal dhe pjesëmarrja të jetë me dashje drejt



arritjes së qëllimit kriminal të importimit të lëndës narkotike nga një shtet tjetër në territorin shqiptar (si p.sh. krijimi i kushteve për kërkimin dhe gjetjen e lëndës narkotike, për marrjen, mbajtjen, ruajtjen dhe transportimin e saj nga territori i shtetit tjetër në territorin shqiptar, rekrutimi i bashkëpunëtorëve dhe në tërësi sigurimi dhe përdorimi i mjeteve financiare dhe teknike për lehtësimin dhe realizimin e këtij veprimi kriminal).

32. *Eksportimi*, në kundërshtim me ligjin, i substancave narkotike ose psikotrope, si edhe i farërave të bimëve narkotike, është mënyrë e realizimit të veprimit kriminal të parashikuar nga neni 283/a i Kodit Penal, me të cilën, persona fizikë a juridikë, të pajisur ose jo me autorizim të posaçëm sipas ligjit nga autoritetet shqiptare, në mënyrë të kundërligjshme dhe me dashje, duke përdorur çfarëdo mjeti e forme veprimi a mosveprimi, i dërgojnë këto lëndë nga territori shqiptar në territorin e shteteve të tjera, me synimin për t'i hedhur në qarkullim në territorin e atyre shteteve.

Për kualifikimin e veprimit kriminal si “trafikim i narkotikëve” në mënyrën e eksportimit, sipas nenit 283/a të Kodit Penal, ka rëndësi të vërtetohet kryerja e veprimeve a mosveprimeve, konkrete, me dashje, të lidhura me arritjen e rezultatit të mendimit kriminal, pikërisht të qëllimit për ta dërguar (eksportuar) lëndën narkotike, në mënyrë të kundërligjshme, nga territori i Republikës së Shqipërisë në territorin e një shteti tjetër, pavarësisht nëse kanë ardhur të gjitha pasojat, nëse është arritur rezultati kriminal. Po kështu, nuk ka rëndësi për kualifikimin e kësaj vepre penale se cili ishte synimi i mëtejshëm i autorëve të veprës pas hyrjes së lëndës narkotike në territorin e shtetit tjetër, pra forma e natyra e parashikuar prej tyre për të përfituar dhe gjithsesi për vënien në qarkullim të saj pas realizimit të eksportimit.

Nuk ka rëndësi për kualifikimin e veprës as natyra e veprimeve e mosveprimeve apo forma e pjesëmarrjes në kryerjen e veprimit kriminal të eksportimit të lëndës narkotike, përderisa këto elemente të anës objektive të kryerjes së krimit të trafikimit të narkotikëve (neni 283/a) janë alternative dhe autonome. Mjafton që veprimi kriminal dhe pjesëmarrja të jetë me dashje drejt arritjes së qëllimit kriminal të eksportimit të lëndës narkotike nga territori shqiptar në territorin e një shteti tjetër (si p.sh. krijimi i kushteve për kërkimin dhe gjetjen e lëndës narkotike, për marrjen, mbajtjen, ruajtjen dhe transportimin e saj nga territori i shqiptar në territorin e shtetit tjetër, rekrutimi i bashkëpunëtorëve dhe në tërësi sigurimi dhe përdorimi i mjeteve financiare dhe teknike për lehtësimin dhe realizimin e këtij veprimi kriminal).

33. *Tregtimi*, në kundërshtim me ligjin, i substancave narkotike ose psikotrope, si dhe i farërave të bimëve narkotike, është mënyrë e realizimit të veprimit kriminal të parashikuar nga neni 283/a i Kodit Penal, me të cilën, persona fizikë a juridikë, të pajisur ose jo me autorizim të posaçëm sipas ligjit nga autoritetet shqiptare, në mënyrë të kundërligjshme dhe me dashje, realizojnë çfarëdo transaksioni a veprimi tjetër financiar e tregtar, të ndryshëm nga ato të importimit dhe eksportimit, brenda apo jashtë territorit shqiptar, me qëllimin për të vënë lëndët narkotike në qarkullim ndërkombëtar ekonomik e tregtar, nëse këto veprimtari zhvillohen apo sjellin pasoja në territorin shqiptar, nëse kryhen në dëm të interesave të shtetit ose të shtetasve shqiptarë.

Për kualifikimin e veprimit kriminal si “trafikim i narkotikëve” në mënyrën e tregtimit, sipas kuptimit të posaçëm të tij në nenin 283/a të Kodit Penal, ka rëndësi të vërtetohet kryerja e veprimeve a mosveprimeve, konkrete, me dashje, të lidhura me arritjen e rezultatit të mendimit kriminal, pikërisht të qëllimit për të krijuar kushte dhe realizuar çfarëdo transaksioni a veprimi financiar e tregtar (të ndryshëm nga ai i importimit dhe eksportimit) për vënien e lëndëve narkotike, në mënyrë të kundërligjshme, në qarkullimin ekonomik e tregtar ndërkombëtar, pavarësisht nëse kanë ardhur të gjitha pasojat, nëse është arritur rezultati kriminal. Nuk ka rëndësi për kualifikimin e kësaj vepre penale se cila është forma e natyra e përfitimit e parashikuar nga autorët e saj si rezultat i krijimit të kushteve dhe vënies në qarkullim tregtar të lëndës narkotike.



Forma të ligjshme të ushtrimit të transaksioneve dhe veprimeve për tregtimin ndërkombëtar të lëndëve narkotike të lejueshme për qarkullim, të ndryshme nga ato të importimit dhe eksportimit, janë ato që parashikohen posaçërisht nga ligji, aktet nënligjore normative të nxjerra në bazë e zbatim të ligjit, si dhe nga kushtet e përmbajtura në autorizimin e lëshuar për këtë qëllim subjektit nga organi kompetent.

Nuk ka rëndësi për kualifikimin e veprës as edhe natyra e veprimeve e mosveprimeve apo forma e pjesëmarrjes në kryerjen e veprimit kriminal të tregtimit (ndërkombëtar) të lëndës narkotike, përderisa këto elemente të anës objektive të kryerjes së krimit të trafikimit të narkotikëve (neni 283/a) janë alternative dhe autonome. Mjafton që veprimi kriminal dhe pjesëmarrja të jetë me dashje drejt arritjes së qëllimit kriminal të tregtimit ndërkombëtar të lëndës narkotike (si p.sh. krijimi i kushteve dhe kryerja e çdo veprimtarie tjetër për realizimin e tregtimit ndërkombëtar të lëndës narkotike, të ndryshme nga ato për importimin e eksportimin, rekrutimi i bashkëpunëtorëve dhe në tërësi sigurimi dhe përdorimi i mjeteve financiare dhe teknike për lehtësimin dhe realizimin e këtij veprimi kriminal).

34. *Transitimi*, në kundërshtim me ligjin, i substancave narkotike ose psikotrope, si edhe i farërave të bimëve narkotike, është mënyrë e realizimit të veprimit kriminal të parashikuar nga neni 283/a i Kodit Penal, me të cilën, persona fizikë a juridikë, të pajisur ose jo me autorizim të posaçëm sipas ligjit nga autoritetet shqiptare, në mënyrë të kundërligjshme dhe me dashje, duke përdorur çfarëdo mjeti e forme veprimi a mosveprimi, i mbartin, ruajnë, shoqërojnë, lëvizin dhe transportojnë këto lëndë përgjatë territorit të Republikës së Shqipërisë, me synimin për t'i kaluar, nëpërmjet tij, nga territori i një shteti në territorin e një shteti tjetër.

Për kualifikimin e veprimit kriminal si “trafikim i narkotikëve” në mënyrën e transitimit, sipas nenit 283/a të Kodit Penal, ka rëndësi të vërtetohet kryerja e veprimeve a mosveprimeve, konkrete, me dashje, të lidhura me arritjen e rezultatit të mendimit kriminal, pikërisht të *qëllimit për ta mbartur, ruajtur, shoqëruar e transportuar (transituar) lëndën narkotike, në mënyrë të kundërligjshme, përgjatë territorit shqiptar, si një segment apo pjesë e segmenteve të ndërmjetme të transportimit nga shteti i nisjes drejt atij të destinuar për t'u vënë në qarkullim lënda narkotike e transituar*, pavarësisht nëse kanë ardhur të gjitha pasojat, nëse është arritur rezultati kriminal.

Nuk ka rëndësi për kualifikimin e kësaj vepre penale se cila është natyra e veprimeve a mosveprimeve apo forma e pjesëmarrjes në kryerjen e veprimit kriminal të transitimit të lëndës narkotike, përderisa këto elemente të anës objektive të kryerjes së krimit të trafikimit të narkotikëve (neni 283/a) janë alternative dhe autonome. Mjafton që veprimi kriminal dhe pjesëmarrja të jetë me dashje drejt arritjes së qëllimit kriminal të transitimit të lëndës narkotike nëpërmjet territorit shqiptar (si p.sh. krijimi i kushteve për marrjen në dorëzim, mbartjen, ruajtjen, shoqërimin, lëvizjen dhe transportimin e saj përgjatë territorit shqiptar, rekrutimi i bashkëpunëtorëve dhe në tërësi sigurimi dhe përdorimi i mjeteve financiare dhe teknike për lehtësimin dhe realizimin e këtij veprimi kriminal).

35. Bazuar në arsyetimet dhe parashtrimet e mësipërme lidhur me kuptimin dhe interpretimin e katër elementeve të figurës së veprës penale të trafikimit të narkotikëve (neni 283/a), ***Kolegjet e Bashkuara vlerësojnë se ka vend për të ardhur në përfundimin se ky krim, pavarësisht nga mënyra se si kryhet, mund të mbetet në fazën e tij paraprake të tentativës së kryerjes së veprës penale.***

Në këtë drejtim Kodi ynë Penal, përfshirë edhe dispozitën e nenit 283/a të tij, janë në harmoni me detyrimin që buron nga aktet e së drejtës ndërkombëtare, përfshirë Konventën e Palermos, në të cilat Shqipëria është palë, ku përmbahen dispozita që kërkojnë dhe orientojnë shtetet anëtare të parashikojnë në ligj tentativën dhe përgjegjësinë penale përkatëse, për veprat penale të trafikimit të mbetura në këtë fazë të veprimit kriminal.



36. Kolegjet e Bashkuara vërejnë se, në zbatim të drejtë të ligjit penal dhe bazuar në jurisprudencën e konsoliduar penale, nisur nga veçantitë e mënyrës së kryerjes së veprës penale të trafikimit të narkotikëve (neni 283/a) dhe duke qenë se kryhet me dashje, sipas rastit, autorët kanë përgjegjësi penale për kryerjen e veprës penale ose për veprën penale të mbetur në tentativë, nëse, krahas shfaqjes së mendimit kriminal dhe përgatitjes eventuale për të ardhmen, ata me dashje, kryejnë veprime e mosveprime konkrete dhe të drejtpërdrejta mbi objektin e krimit, me të cilat synojnë (aty për aty) arritjen e qëllimit kriminal, ardhjen e pasojave të dëshiruara prej tyre, pra kryerjen e veprës.

37. Sikurse është arsyetuar më sipër në këtë vendim, për kualifikimin e veprës penale të trafikimit të narkotikëve (neni 283/a), ka rëndësi thelbësore të vërtetohet kryerja, me dashje, e veprimeve apo mosveprimeve, konkrete, për të realizuar, në mënyrë të kundërligjshme, qëllimin e dëshiruar nga autorët e veprës, pikërisht hyrjen (sjelljen) ose daljen (dërgimin) e paligjshme të narkotikëve nga territori shqiptar ose kalimin e paligjshëm të tyre nëpërmjet territorit shqiptar në atë të shteteve të tjera, kryesisht për të realizuar përfitime të ndryshme për vete ose për të tretë.

38. Prandaj, lidhur me kryerjen e veprës penale apo mbetjes së saj në tentativë, duke pasur parasysh katër mënyrat e kryerjes së veprimit kriminal të trafikimit të narkotikëve, të parashikuara nga neni 283/a i Kodit Penal, Kolegjet e Bashkuara vijjnë në përfundimet unifikuese se:

a) *Vepra penale e trafikimit të narkotikëve (neni 283/a), në mënyrën e importimit, quhet e kryer me vërtetimin e rrethanës se lënda narkotike e ka kaluar kufirin tokësor, ajror a detar të Republikës së Shqipërisë, pavarësisht se ende mund të mos ketë mbërritur apo të ketë kaluar në pikat kufitare e doganore, stacionet, portet dhe aeroportet e vendit përfshirë këtu zonat e tyre të transitit. Po kështu, vepra penale quhet e kryer pavarësisht rrethanës që, lënda narkotike, pas kalimit të kufirit shtetëror apo edhe të kontrollit policor e doganor, ka mbërritur ose jo te personi apo destinacioni i dëshiruar nga autorët e veprës në territorin shqiptar.*

*Nëse lënda narkotike, megjithë veprimet a mosveprimet konkrete të drejtpërdrejta të autorëve të veprës për importimin e saj, nuk e ka kaluar kufirin shtetëror shqiptar, për rrethana që nuk varen nga vullneti i tyre, pavarësisht nga koha e vendi i ndërprerjes së veprimit kriminal, vepra penale kualifikohet si trafikim i narkotikëve në mënyrën e importimit e mbetur në tentativë parashikuar nga neni 283/a dhe 22 të Kodit Penal.*

b) *Vepra penale e trafikimit të narkotikëve (neni 283/a), në mënyrën e eksportimit, quhet e kryer me vërtetimin e rrethanës se lënda narkotike ka kaluar kufirin tokësor, ajror a detar të Republikës së Shqipërisë. Po kështu, vepra penale quhet e kryer pavarësisht rrethanës që, lënda narkotike, pas kalimit të kufirit shtetëror apo edhe të kontrollit policor e doganor, i është nënshtruar apo jo kontrollit policor e doganor të shtetit tjetër, nëse ka mbërritur te personi apo destinacioni i dëshiruar nga autorët e veprës në territorin e atij shteti.*

*Nëse lënda narkotike, megjithë veprimet a mosveprimet konkrete e të drejtpërdrejta të autorëve të veprës për eksportimin e saj, nuk e ka kaluar kufirin shtetëror shqiptar, për rrethana që nuk varen nga vullneti i tyre, pavarësisht nga koha e vendi i ndërprerjes së veprimit kriminal në territorin shqiptar, vepra penale kualifikohet si trafikim i narkotikëve në mënyrën e eksportimit e mbetur në tentativë parashikuar nga neni 283/a dhe 22 të Kodit Penal.*

c) *Vepra penale e trafikimit të narkotikëve, në mënyrën e tregtimit (ndërkombëtar), sipas rastit dhe natyrës konkrete të veprimit a mosveprimit, quhet e kryer me vërtetimin e rrethanës se lënda narkotike ka kaluar, duke hyrë ose dalë nga kufiri tokësor, ajror a detar i Republikës së Shqipërisë, pavarësisht se ende mund të mos ketë mbërritur apo të ketë kaluar në pikat kufitare e doganore, në stacionet, portet dhe aeroportet e vendit përfshirë këtu zonat e tyre të transitit. Po kështu, vepra penale quhet e kryer pavarësisht rrethanës, që lënda narkotike, pas kalimit të kufirit shtetëror apo edhe të kontrollit policor e doganor, ka mbërritur te personi apo destinacioni i*

*dëshiruar nga autorët e veprës në territorin shqiptar apo të shtetit tjetër.*

*Nëse lënda narkotike, megjithë veprimet a mosveprimet konkrete e të drejtpërdrejta të autorëve të veprës për tregtimin ndërkombëtar të saj, sipas rastit, nuk ka hyrë apo nuk e ka kaluar kufirin shtetëror shqiptar, për rrethana që nuk varen nga vullneti i tyre, pavarësisht nga koha e vendi i ndërprerjes së veprimit kriminal brenda a jashtë vendit, vepra penale kualifikohet si trafikim i narkotikëve në mënyrën e tregtimit ndërkombëtar e mbetur në tentativë parashikuar nga nenet 283/a dhe 22 të Kodit Penal.*

*ç) Vepra penale e trafikimit të narkotikëve, në mënyrën e transitimit, quhet e kryer me vërtetimin e rrethanës se lënda narkotike, pas hyrjes në territorin shqiptar dhe qëndrimit apo lëvizjes brenda këtij territori, ka kaluar kufirin tokësor, ajror a detar të Republikës së Shqipërisë drejt një shteti tjetër. Po kështu, vepra penale quhet e kryer pavarësisht rrethanës, që lënda narkotike, pas kalimit të kufirit shtetëror shqiptar në shtetin tjetër, i është nënshtruar apo jo kontrollit policor e doganor të atij shteti, nëse ka mbërritur te personi apo destinacioni i dëshiruar nga autorët e veprës në territorin e atij shteti.*

*Kur lënda narkotike, e cila ka hyrë më parë në territorin shqiptar, megjithë veprimet a mosveprimet e mëtejshme, konkrete e të drejtpërdrejta, të autorëve të veprës për transitimin e saj jashtë këtij territori, nuk e ka kaluar kufirin shtetëror shqiptar, për rrethana që nuk varen nga vullneti i tyre, vepra penale kualifikohet si trafikim i narkotikëve në mënyrën e transitimit e mbetur në tentativë parashikuar nga nenet 283/a dhe 22 të Kodit Penal, pavarësisht nga koha e vendi i ndërprerjes së këtij veprimi kriminal brenda territorit shqiptar.*

39. Kolegjet e Bashkuara vlerësojnë se, mbështetur në analizën mbi zbatimin e ligjit dhe përfundimet unifikuese të lartpërmendura, pretendimet e parashtruara në rekursin e paraqitur nga i gjykuari Shezai Gega, gjenden të bazuara në ligj, vetëm lidhur me kundërshtimin e vendimit të Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda, për sa i përket cilësimit ligjor të veprës penale, pikërisht aty ku pretendohet se ai duhet të deklarohej fajtor për veprën penale të trafikimit të lëndës narkotike të mbetur në tentativë, sipas nenit 283/a/1 e 22 të Kodit Penal. I gjykuari nuk mund të përgjigjet për veprën penale të kryer pasi nuk ka kaluar kufirin shtetëror.

Nga vendimet e dhëna në të dyja shkallët e gjykimit rezulton se gjykatat kanë pranuar si të provuar që në pikën kufitare të Kakavijës, gjatë një kontrolli të ushtruar në mjetin motorik në pronësi të të gjykuarit janë gjetur dhe sekuestruar me cilësinë e provës materiale 131 pako të mbështjella me natriban, në brendësi të të cilave kishte lëndë narkotike të llojit *Cannabis*. Gjithashtu, në përfundim të hetimit gjyqësor, gjykatat kanë pranuar si të provuar se, i gjykuari Shezai Gega, pronar i mjetit motorik, ku u gjend lënda narkotike, është autor i kryerjes së veprës penale të trafikimit të narkotikëve sipas nenit 283/a të Kodit Penal.

40. Kolegjet e Bashkuara vlerësojnë se si gjykata e apelit, ashtu edhe ajo e shkallës së parë për krimet e rënda kanë zbatuar gabim ligjin penal material.

Së pari, ndonëse nuk ndryshon kualifikimin ligjor të veprës dhe, nga pikëpamja e anës objektive, janë mënyra të kryerjes së veprës penale të trafikimit të narkotikëve sipas nenit 283/a i Kodit Penal, gjykatat duhet të kishin konkluduar, në mënyrë të shprehur, mbi vetë provat që kishin marrë dhe çmuar prej tyre, se në cilën nga mënyrat e parashikuara nga paragrafi i parë i këtij neni është kryer vepra penale. Kjo i shërben drejtpërdrejt thelbit të gjykimit penal, përcaktimit konkret dhe vërtetimit të fajësisë së të pandehurit për veprën penale që i atribuohet.

Së dyti, duke konkluduar paraprakisht mbi mënyrën e kryerjes së veprës penale të trafikimit të narkotikëve (neni 283/a paragrafi i parë), bazuar në vetë provat e marra dhe rrethanat e faktit të pranuar prej tyre, rrjedhimisht gjykatat mund dhe duhet të konkludonin edhe nëse, në çështjen në gjykim, ndodhen përpara veprës penale të kryer apo të mbetur në tentativë.

41. Bazuar në provat e marra dhe rrethanat e faktit të pranuar si nga Gjykata e Shkallës së Parë, ashtu edhe ajo e Apelit për Krime të Rënda, në gjykim ka rezultuar e provuar nga veprimet e



mosveprimet e të pandehurit Shezai Gega se, pas sigurimit të lëndës narkotike në vend, ai ka vepruar më tej për arritjen e qëllimit të dërgimit të kësaj lënde narkotike jashtë territorit shqiptar, nëpërmjet pikës kufitare të Kakavijës. Por, duke qenë se lënda narkotike është gjetur e sekuestruar, gjatë një kontrolli të ushtruar në mjetin motorik në pronësi të të gjykuarit në pikën kufitare të Kakavijës, pra pa kaluar përtej kufirit shtetëror shqiptar, atëherë veprimtaria kriminale e tij është ndërprerë, pasojat e dëshiruara prej tij nuk kanë ardhur, për rrethana të pavarura nga vullneti i tij.

Në të tilla rrethana, Kolegjet e Bashkuara, për sa i përket zbatimit të ligjit penal material, çmojnë se vepra penale e kryer nga i pandehuri Shezai Gega duhet të kualifikohet si trafikim i narkotikëve në mënyrën e eksportimit, e mbetur në tentativë, parashikuar nga nenet 283/a, paragrafi i parë dhe 22 të Kodit Penal.

42. Së fundi, Kolegjet e Bashkuara vlerësojnë që shkaqet e tjera të ngritura në rekurs nuk lidhen me zbatimin e ligjit material e procedural penal në gjykimin e çështjes, por kanë të bëjnë vetëm me çmimin e provave nga gjykatat më të ulëta, që është atribut i gjykatave të faktit dhe jo i gjykatës së ligjit, sikurse është Gjykata e Lartë.

#### PËR KËTO ARSYE,

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, në mbështetje të pikës 2 të nenit 141 të Kushtetutës, të nenit 438 dhe të shkronjës “a” e “b” të pikës 1 të nenit 441 të Kodit të Procedurës Penale, si dhe të shkronjës “a” të nenit 17 të ligjit nr.8588, datë 15.3.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës së Lartë të Republikës së Shqipërisë”,

#### VENDOSËN:

1. Ndryshimin e vendimit nr.19, datë 25.3.2009 të Gjykatës së Apelit për Krimet e Rënda Tiranë dhe të vendimit nr.10, datë 11.2.2009 të Gjykatës për Krimet e Rënda Tiranë, në këtë mënyrë:

Deklarimin fajtor të të pandehurit Shezai Gega, për veprën penale të trafikimit të narkotikëve e mbetur në tentativë, parashikuar nga nenet 283/a, paragrafi i parë e neni 22 i Kodit Penal dhe dënimin e tij me 7 (shtatë) vjet e 6 (gjashtë) muaj burgim.

Në zbatim të nenit 406 të Kodit të Procedurës Penale, duke iu zbritur një e treta e dënimit, dënimin e tij përfundimisht me 5 (pesë) vjet burgim.

Lënien në fuqi të vendimit për pjesët e tjera.

2. Unifikimin e praktikës gjyqësore, sikurse përcaktohet në këtë vendim.

3. Dërgimin për botim në Fletoren Zyrtare të këtij vendimi që njëson praktikën gjyqësore.

Anëtarë pro: Shpresa Beçaj (kryesuese) Gani Dizdari, Ardian Dvorani, Ardian Nuni, Fatos Lulo, Besnik Imeraj, Arjana Fullani, Andi Çeliku, Aleksandër Muskaj, Majlinda Andrea, Guxim Zenelaj, Evelina Qirjako, Mirela Fana.

Anëtar kundër: Medi Bici.

## MENDIM PAKICE

Unë, gjyqtari **Medi Bici**, jam kundër vendimit nr.3, datë 24.1.2011 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, për sa i përket ndryshimit të cilësimit juridik të veprës penale nga ajo e “Trafikimit të narkotikëve”, e parashikuar nga neni 283/a i Kodit Penal, në veprën penale të trafikimit të narkotikëve e mbetur në tentativë, parashikuar nga neni 283/a-22 i Kodit Penal (vetëm për pjesën e tentativës), për të cilën është deklaruar fajtor i pandehuri Shezai Gega, prandaj, në përputhje me nenin 112/5 të Kodit të Procedurës Penale, përpiloj këtë procesverbal përmbledhës me motivet e kundërshtimit të vendimit.

Nga shqyrtimi i çështjes, ka rezultuar, si më poshtë:

Me datë 31.1.2008, rreth orës 07:30 në pikën kufitare të Kakavijës është ushtruar kontroll në automjetin tip “Volvo” me targa BR 1852 B, i cili drejtohej nga shtetasi Agron Rrushi.

Nga kontrolli ka rezultuar se në kamion gjendeshin 131 pako të mbështjella me natriban, në të cilat ishin ambalazhuar 160 kg lëndë narkotike e llojit *Cannabis-Sativa*.

Pas kryerjes së hetimeve paraprake, organi i prokurorisë ka pushuar akuzën ndaj shoferit Agron Rrushi dhe ka sjellë për gjykim pronarin e makinës të gjykuar Shezai Gega, i cili akuzohet për veprën penale të trafikimit të narkotikëve e mbetur në fazën e tentativës, parashikuar nga neni 283/a dhe 22 të Kodit Penal.

Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda dhe ajo e Apelit për Krime të Rënda e kanë deklaruar fajtor të gjykuar Shezai Gega për veprën penale të trafikimit të lëndës narkotike (pa tentativën), të parashikuar nga neni 283/a i Kodit Penal.

Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin e datës 27.10.2010, ka vendosur kalimin e çështjes në Kolegjet e Bashkuara, duke shtruar për zgjidhje çështjet e mëposhtme:

*Nëse lënda narkotike e ardhur nga një shtet dhe e destinuar për një shtet tjetër i kapet autorit, brenda territorit të shtetit shqiptar, a do e bëjë veprën të kualifikuar si trafikim të kryer apo të mbetur në fazën e tentativës?*

*Nisur nga përmbajtja e nenit 283/a të Kodit Penal, sipas të cilit format e kryerjes janë: importimi, eksportimi, transitimi dhe tregtimi në kundërshtim me ligjin e substancave narkotike e ....., cila do të jetë faza e tentativës në kryerjen e kësaj vepre penale në rastin e transitimit, ndërkohë që vepra penale konsiderohet e kryer edhe vetëm duke e importuar, eksportuar apo tregtuar?*

Ndryshe nga shumica, pakica vlerëson se vepra penale e “Trafikimit të narkotikëve”, parashikuar nga neni 283/a i Kodit Penal, duke qenë një vepër penale me natyrë ndërkombëtare, nuk njihet kufi, pasi ajo realizohet në territorin e disa shteteve dhe kryhet në katër forma, të cilat janë:

eksportimi, importimi, tregtimi dhe transitimi.

Gjykata e apelit arsyeton se lënda narkotike ishte e destinuar të dërgohej në shtetin e Greqisë, pasi makina që transportonte lëndën narkotike është kapur në pikën doganore të Kavavijës, vend ku ndodhet kufiri shqiptaro-grek.

Kjo provon faktin që i gjykuari Shezai Gega e ka transportuar lëndën narkotike, nga vendi ku e ka siguruar atë, në një pikë të ndërmjetme, e cila nuk është destinacioni i fundit, dhe pikërisht kjo lëvizje e narkotikut në territorin e vendit tonë, për mendimin e pakicës, quhet tranzitim.

Sipas vlerësimit të pakicës termi transitim ka kuptimin e mëposhtëm:

*Transitimi është dërgimi (transportimi) i “mallit” nga një pikë fillestare në një pikë tjetër të ndërmjetme (që nuk është destinacioni i fundit).*

Transportimi i lëndës narkotike nga vendi ku e ka marrë i gjykuari Shezai Gega dhe deri në kufi, mendoj që është transitim, dhe kjo nuk lidhet me faktin që mund të jemi ose jo vend origjine, sepse dalja e narkotikut nga kufijtë shtetërorë quhet eksport dhe nuk do të ishte fare e nevojshme që legjislatori të shtonte një formë tjetër të kryerjes së veprës penale, atë të transitimit, kur mjaftonte



eksportimi i lëndës narkotike, në mënyrë që subjekti i veprës penale të kishte përgjegjësi penale.

Arsyeja e vetme që legjislatori ka parashikuar transitimin, si një nga katër format e kryerjes së veprës penale të trafikimit të narkotikëve, ka qenë fakti se do të mbeteshin pa u ndërshtuar trafikantët që lëviznin lëndën narkotike brenda vendit.

Vlerësimi im është, se mjafton të provohet fakti që lënda narkotike është e destinuar për jashtë shtetit dhe subjekti i veprës penale të transportojë atë nga një vend në një vend tjetër, i cili nuk është destinacioni i fundit, në mënyrë që ai të përgjigjet për formën e transitimit, sepse përndryshe do të ishim përpara veprës penale, të parashikuar nga neni 283 i Kodit Penal (forma e mbajtjes).

Nga mënyra se si është formuluar dispozita ligjore e parashikuar nga neni 283/a të Kodit Penal, kuptohet me lehtësi se ajo është përshtatur me Konventën e Kombeve të Bashkuara kundër krimit të organizuar ndërkombëtar (Konventa e Palermos), e ratifikuar nga Kuvendi ynë me ligjin nr.8920, datë 11.7.2002.

Në nenin 1 të kësaj Konvente thuhet:

*Qëllimi i kësaj Konvente është të nxisë bashkëpunimin, për të parandaluar dhe luftuar efektivisht krimin e organizuar ndërkombëtar.*

Jam i mendimit që vendimi i marrë nga Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë nuk e pasqyron frymën që përçon kjo Konventë të vendet pjesëmarrëse në të, e cila është lufta e përbashkët për të ndaluar dhe luftuar me efektivitet krimin e organizuar ndërkombëtar.

Në vendimin e gjykatës, kjo Konventë përmendet shkarazi vetëm një herë si Konventa e Palermos, pa u bërë asnjë referim në të, çka tregon që, megjithëse po bëhen afro 10 vjet nga ratifikimi i këtij akti ndërkombëtar, akoma praktika gjyqësore ka vështirësi në implementimin e saj, duke mos u kuptuar drejt zinxhiri i lidhjes së krimit të organizuar dhe lufta kundër tij, të cilat nuk mund të realizohen me prerjen e hallkave të veçanta, por me shkatërrimin e gjithë zinxhirit të krimit.

Nëse do të dënohen anëtarët e grupeve të organizuara kriminale për vepra penale të mbetura në tentativë, atëherë si do ta justifikonim lëvizjen e narkotrafikut nga një vend i lindjes së largët drejt vendit tonë, siç është rasti i trafikut të heroinës, ose nga një vend i Amerikës së Jugut drejt vendit tonë, siç është rasti i kokainës.

Është e rëndësishme të theksohet se me ligjin nr.8722, datë 26.12.2000 vendi ynë ka ratifikuar Konventën e Kombeve të Bashkuara kundër trafikut të paligjshëm të drogave narkotike dhe lëndëve psikotrope, e cila në nenin 1 të saj thotë:

*“Shtet transit” nënkupton një shtet nëpër territorin e të cilit kalojnë droga narkotike, lëndë psikotrope dhe lëndë të paligjshme të parashikuara në tabelën I dhe tabelën II, teritori i të cilit nuk është as vendi i origjinës as vendi i destinacionit të tyre.*

Vlerësimi i pakicës është se në rastin trafikimit të heroinës dhe të kokainës territori i vendit tonë nuk është vend origjine, pasi këto lëndë narkotike nuk mund të prodhohen në Shqipëri, prandaj kur vendi ynë nuk është destinacioni i fundit, atëherë kalimi i këtyre drogave nëpër territorin e vendit tonë do të ishte transitim.

Ndryshe qëndron puna në rastin në gjykim, kur lënda narkotike është e llojit *Cannabis Sativa*, ku vendi ynë mund të jetë edhe vend origjine, pasi kjo lëndë narkotike kultivohet në mënyrë të paligjshme në disa pjesë të territorit të Shqipërisë, me gjithë luftën që bëjnë strukturat e posaçme të shtetit për eliminimin e këtij fenomeni.

Duke qenë vend origjine, nuk mund të konsiderohemi shtet transit sipas përcaktimit të Konventës, prandaj lind pyetja se lëvizja e *Cannabis Sativës* nga vendi ku është prodhuar e deri në kufirin ku është kapur, çfarë duhet konsideruar?

Mendimi i pakicës është që kjo lëvizje e lëndës narkotike duhet të konsiderohet transitim, sepse përndryshe kjo formë e veprës penale nuk duhet të ishte parashikuar në ligj, pasi ajo nuk mund të zbatohet asnjëherë dhe veprimtaria kriminale e subjektit të krimit nga momenti i shtënies në dorë të lëndës narkotike dhe dërgimi i saj deri në pikën kufitare, ku është kapur do të mbetet e padënuar, gjë e cila do të ishte e padrejtë.

Pakica ka mendimin se vetëm në dy raste transitimi mbetet në tentativë, të cilat janë:

1. Kur lënda narkotike importohet nga jashtë dhe subjekti i veprës penale, i cili nuk ka marrë pjesë në importim, kapet ose zbulohet në momentin që merr në dorëzim lëndën narkotike, por pa filluar lëvizjen e saj nëpër territorin shqiptar me qëllim dërgimin e saj në një vend tjetër.

2. Kur lënda narkotike është prodhuar në vend (Shqipëria është vendi i origjinës), subjekti i veprës penale kapet ose zbulohet në momentin që merr në dorëzim lëndën narkotike, me qëllim për ta transportuar atë drejt kufirit të shtetit tjetër, por pa marrë pjesë në eksportin e saj.

Dy rastet e përmendura më sipër, kam mendimin se vlejnë vetëm për bashkëpunimin e thjeshtë ose në rastin kur vepra penale kryhet nga një person i vetëm, gjë e cila në praktikë është mjaft e vështirë të ndodhë, pasi këto vepra penale zakonisht kryhen nga organizatat kriminale dhe grupet e strukturuar kriminale, anëtarët e të cilave, në bazë të nenit 28/6 të Kodit Penal, kanë përgjegjësi për të gjitha veprat penale që kryhen organizata ose grupi i strukturuar kriminal, prandaj është shumë e vështirë që të thuhet se veprat penale me natyrë të tillë mbeten në tentativë.

Për të gjitha këto që u thanë më sipër, jam i mendimit që vendimi nr.19, datë 25.3.2009 i Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda është i bazuar në ligj dhe duhet të lihet në fuqi, prandaj vota ime është kundër vendimit nr.3, datë 24.1.2011 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

Anëtar  
Medi Bici

**Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Gjergj Fishta”, mbrapa ish-ekspozitës “Shqipëria Sot”, tel: 04 24 27 007.**

Çmimi i abonimit pranë Postës Shqiptare, për Fletoret Zyrtare 2012, është 16 000 lekë.  
Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

Hyri në shtyp më 26.12.2011  
Doli nga shtypi më 27.12.2011

Tirazhi: 1700 copë	Formati: 61x86/8
--------------------	------------------

Shtypshkronja Mediaprint  
Tiranë, 2011

Çmimi 66 lekë